




Hëna e Re

Viti XXXV | Nr.369 | Qershor 2022 | Dhul Ka'de - Dhul Hixhe 1443 | Çmimi 50 den

*Sivjet me Haxh:
"Të përgjigjem ty, o Allah..."*



AMBIENTI EVROPIAN, TOKA MË PJELLORE PËR VLERAT ISLAME



Nga Shaqir ef. Fetahu

NË TAKIMET E MIA me faktorë të ndryshëm, iu them se ambienti evropian është toka më pjellore e kultivimit të vlerave të Islamit, sepse është ambient i dijes, i ekonomisë, i shkencës, i paqes, i humanizmit, i rregullit, i sistemit - vlera këto të cilat Islami i proklamoi me shekuj dhe i bëri aktuale në çdo vend të botës, si pjesë përbërëse të ngritjes së vetëdijes drejt zhvillimit dhe përparimit në të gjitha sferat e jetës njerëzore.

Jini optimistë dhe veproni për të ardhmen e tij (të Islamit) në skenën e zhvillimeve pozitive në botë.

ABSOLUTI

Zoti është Absoluti! Ekziston pa fillim, pa vend, pa kohë e pa hapësirë. Është i Përhershëm.

Qabeja është kibleja (drejtimi) e fytyrave tona gjatë faljes-namazit. Qielli është kibleja e duarve tona gjatë lutjes. Qabeja është shtëpia e Zotit jo në kuptimin e vendit, apo se Zoti qëndron aty.

Edhe qielli është i krijuar nga Zoti.

Zoti nuk ka shtëpi. Zoti nuk ka vend. Ai jeton para vendit, para kohës dhe para hapësirës. Ai ka ekzistuar para se të krijonte vendin, kohën e hapësirën.

FALNI NJERËZIT, se ata janë qenie të cilat ndonjëherë rrëshqasin nga harresa, mashtrimi, pakujdesia, interesi dhe herë-herë edhe nga padija.

Mos i urreni, por këshilloni kudo që jeni.

Kështu veprojnë të mirët. Të kundërtën e bëjnë ata që janë robër të ndjenjave satanike, të interesit, të xhelozisë e të egoizmit.

Por, edhe të tillët ndihmoni, sepse kanë nevojë të çlirohen nga kjo gjendje. Sa fuqishëm tingëllojnë fjalët e Zotit të Madhërisëm kur i drejtohet Muhamedit (a. s.) - e sot neve - me këto fjalë: "Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë; e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje; andaj, ti falua atyre dhe kërkoi ndjesë për ta (te Zoti) dhe konsultohu me ta në të gjitha çështjet; e kur të vendosësh, atëherë mbështetu tek Allahu, se Allahu i do ata që mbështeten (tek Ai)." (Ali Imran: 159)

Eh! Sa më ka ndihmuar ky ajet në misionin e jetës sime!

KËSHILLONI njerëzit që të flasin gjithmonë fjalë të urta. Mos e zhytni gjuhën në shpifje, sharje, ofendime, nënçmime dhe gjëra të ndyta, sepse ato janë rezultat i mllëfit, i egoizmit, i xhelozisë, të cilat vijnë nga sëmundja e thellë shpirtërore.

Keni edhe një obligim të shenjtë: të tillët mos i urreni, dhe mos ua ktheni të njëjtën, por mundohuni t'i shëroni nga kjo gjendje e shëmtuar. Dhe, nëse nuk e arrini këtë, atëherë fjalët e tyre të shëmtuara shndërrohen në kalitje, në qëndrueshmëri dhe në forcë shpirtërore drejt rrugëtimit të shëndoshë, për arritjen e qëllimit dhe të synimeve fisnike.

Jepni në jetë gjithmonë shpresë dhe energji pozitive dhe kreative. Këtë ua them nga përvoja dhe nga fryma edukuese kuranore.

EH, SA E SHTRËNJTË DHE E SHENJTË ËSHTË KOHA! Mbusheni atë me vepra të mira. Këtë e pret ajo prej nesh. Ik nga rruga e të ndenjurit kot. Bëj diçka të mirë. Përndryshe, shndërrohesh në parazit, që të bën që të shndërrohesh në sindromë të së keqes, të destruktives, të shpifjes, trillimit, sharjes, denigrimit, sepse - nëse nuk angazhohesh në kohë në të mirë, të ndodh e keqja dhe nënçmimi. Andaj, koha le të jetë plot veprime që zhvillojnë të bukurën, të mirën, moralen dhe njerëzoren. Kjo e ndërton rrugën e ardhmërisë së ndritshme të vetvetes, të familjes dhe të popullit tënd. /Fillim qershori 2022/

(Autori është Reis'ul-Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut)

Çdo gjë dhe çdo send është krijuar nga Zoti ekziston nga pafillmësia, në mënyrë absolute, pa dimensione. Nuk i nënshtrohet asnjë dimension. Ekzistenca e Tij i takon Realitetit Absolut.

Sikurse që ekziston pa fillim dhe gjithmonë, ekziston pa vend, pa kohë dhe pa hapësirë.

Është i pavarur dhe nuk ka nevojë për askënd dhe nuk i nënshtrohet asgjëje. Ndërkaq, çdo gjë është e krijuar dhe ka nevojë për Atë. (Ajni Sinani, Prishtinë; në bashkëpunim)

“TË PËRGGJIGJEM TY, O ALLAH...”

Në këto ditë të bekuara të muajit të dymbëdhjetë të kalendarit hixhrij, Dhul-Hixhe, shumë besimtarë, anembanë rruzullit tokësor, marrin rrugën për në Qabe, me qëllim që t'i përgjigjen thirrjes së Allahut (xh. sh.) që thotë: “Thirri njerëzit të vijnë në haxh...” Pra, për ta kryer obligimin e pestë islam – Haxhin.

Pas një ndërprerje dyvjeçare për shkak të pandemisë Covid-19, sivjet për të kryer Haxhin u kërkuan edhe disa kushte të posaçme, siç është moshë e kufizuar ndër gjashtëdhjetepesë vjeç, vaksinimi me dy doza kundër Covid-19, me vaksina që janë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë e Arabisë Saudite dhe Testi PCR negativ, i bërë brenda 72 orëve para hyrjes në Saudi. Kushtet e lartpërmendura nuk i penguan miliona pjesëtarë të Islamit që të marrin rrugën drejt Qabesë. Pjesë e ekspeditës së madhe janë edhe rreth një mijë haxhilerët e vendit tonë, të cilët në organizim të Rijasetit të BFI-së morën rrugën për t'iu përgjigjur thirrjes së Allahut (xh. sh.), respektivisht për të qenë mysafirë të Tij.

Që të gjithë këta mysafirë të Mëshirëplotit përpara Qabesë janë të barabartë, të veshur me uniformë të bardhë - Ihram dhe të gjithë flasin në të njëjtën gjuhë, pavarësisht nga përkatësia e tyre gjinore, racore, etnike apo shtresave të ndryshme shoqërore, e ato janë:

“Lebejke Allahume lebejk, lebejke la sherike leke lebejk, innel-hamde ve niëmete leke vel-mulk la sherike lek.”

(“Të përgjigjem ty, o Allah, të përgjigjem, të përgjigjem ty, nuk ka shok për ty, të përgjigjem. Vërtet falenderimi, begatitë dhe sundimi është për ty, nuk ka shok për ty.”)

Ky është refreni apo zëri i zemrës që shqiptohet përmes gjuhës së atyre që kanë vendosur ta kryejnë kushtin e pestë të fesë islame – Haxhin, të atyre që dëshirojnë të jenë mysafir të Krijuesit të tyre, duke vizituar shtëpinë e Tij, Qabenë, të atyre që kërkojnë përmes këtij ibadeti të pastrojnë bërillokun dhe ndryshkun e grumbulluar ndër vite, gjatë jetës së tyre.

Vlen të përmendim se haxhinjtë e sivjetëm i përcjell edhe një gëzim i papërshkruar, e kjo është përputhja e ditës së Arafatit me ditën e premtë, pra ditën e xhuma. Për këtë shkak, haxhi në kalendarin e kësaj përputhje të ditëve të lartpërmendura quhet Haxh i madh apo Haxhul-ekber. Qëndrimi në Arafat duhet shfrytëzuar në maksimum, sepse Dita e Arafatit tek Allahu është nga ditët më të mira dhe në këtë ditë robërit e Tij i nderon dhe u jep mirësi. Në këtë ditë lutjet pranohen, gabimet falen, gjynahet shlyhen, duart e përlura ngrihen kah Allahu me përlësi dhe shpresë, dhe Allahu mburret me ata që qëndrojnë në Arafat para melaqeve të Tij.

Njëherësh, qëndrimi i haxhilerëve në Arafat na e rikujton tubimin e njerëzve në Ditën e Kiametit, ndërsa veshja e ihramit të bardhë na e rikujton vdekjen dhe qefinin. Allahu për Ditën e Kiametit tha: “Pa dyshim, në këto (ngjarje) ka këshillë për atë që i druhet dënimit të Ditës së Gjykimit. Ajo është Dita në të cilën do të tubohen të gjithë njerëzit; ajo është Ditë e dëshmuar.” (Hud: 103)

Me këtë rast të gjithë haxhilerëve të vendit tonë u dëshirojmë rrugë të mbarë dhe kthim të mirë në shtëpitë dhe familjet e tyre. Po ashtu, të gjithë haxhilerëve u dëshirojmë dhe urojmë haxh të pranuar dhe falje të mëkateve, duke e përkujtuar hadithin e Muhamedit (a. s.): “Kush e kryen haxhin dhe nuk u nënshtrohet më epsheve të shfrenuara, atij i fshihen mëkatet dhe bëhet i pastër si në atë ditë kur e lind nëna e vet.”

Q. Osmani



PARAPËRGATITJET PËR HAXH

Shkruan: Jusuf ef. Zimeri
(Enkas për HeR)

Haxhi - shtylla e pestë e Islamit, në dallim nga katër shtyllat tjera që kanë të bëjnë ose vetëm me segmentin trupor (shpirtëror), ose me segmentin ekonomik, në vete i përfshin që të dy segmentet: edhe atë trupor, edhe atë ekonomik.

Prandaj, Haxhi, si i tillë, nuk është thjesht një udhëtim turistik, por, pra së gjithash, adhurim (ibadet), që ndërli-dhet me çështjen shpirtërore dhe me besimin, por edhe me çështjen trupore dhe atë financiare.

Kjo na jep të kuptojmë se në kryerjen e Haxhit nuk hyjnë, thjesht, vetëm disa veprime që duhet kryer, apo siç shprehen shpeshherë disa njerëz (për) “adetet që duhet kryer”, porse janë veprime që në esencë kanë besimin dhe bindjen, kurse në formë janë veprime të caktuara dhe në kohë të caktuara.

Prandaj, duke i marrë parasysh këto dy segmente - atë esencial dhe atë formal - konstatohet se Haxhi është shumë më i ndërlikuar sesa e paraqesin njerëzit e thjeshtë.

Nisur nga arsyeja e shëndoshë se Haxhi nuk është turizëm, por adhurim (ibadet), me rregulla të caktuara dhe me vlera të mëdha - dhe me qëllim që ata që kanë vendosur të shkojnë në Haxh për të kryer këtë detyrim (farz) islam dhe të kthehen me Haxh të pranuar ishallah, dhe për të mos ngelur Haxhi ynë në nivel ekskursioni - jemi të detyruar të mësojmë rregullat dhe disiplinat, qofshin ato shpirtërore, trupore apo financiare, që ndërli-dhen me këtë ibadet.

Në këtë punim, prandaj, do të theksojmë disa veprime që janë në fazën e parapërgatitjes së kryerjes së këtij farzi islam, të quajtur Haxh (Haxhaxh), e njetliu për Haxh - dhe jo vetëm - t'i më-

sojë dhe t'i aplikojë në përditshmërinë e tij.

Nga këto veprime janë:

HAXHI TË BËHET VETËM HIR TË ALLAHUT TË MADHËRISHËM

Që të arrihet kryerja e obligimit të pestë-Haxhit, dhe të shpërblehet haxhiu për këtë veprim dhe për të shijuar kënaqësinë e Haxhit, njetliu duhet që të jetë i pastër në njetin (qëllimin) e tij. Qëllimi i tij duhet të jetë vetëm kryerja e adhurimit dhe arritja e kënaqësisë së Allahut (xh. sh.) me veprën e tij. Duhet të jetë i vetëdijshëm se bëhet fjalë për adhurim e jo për çështje të tjera autoritative. Allahu (xh. sh.) në Kuranin famëlartë thotë: **“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij...”** (El-Bejine: 5)

Njetliu për në Haxh detyrimisht duhet të zhvishet nga të gjitha tendencat tjera, përveç synimit të adhurimit dhe arritjes së kënaqësisë së Allahut (xh. sh.). Ai duhet të zhvishet nga mendjemadhësia ndaj të tjerëve - për t'u treguar se është i pasur dhe se me këtë akt bëhet aga; të zhvishet nga qëllimi se duhet të fitojë titullin haxhi për shkak të dikujt apo për inat të dikujt; ose të shkojë në Haxh vetëm e vetëm që të tjerët të thonë se filani shkoi në Haxh. Haxhi me këto synime ngel vetëm në nivelin e turizmit të panevojshëm, sepse Pejgamberi (a. s.) në hadithin e tij thotë: **“Vërtet veprat shpërblehen sipas qëllimit...”** Nëse qëllimi është i mirë, edhe vepra vlerësohet e mirë; nëse qëllimi është i zymtë, edhe vepra ngel në llogoret e zymtësisë.

Jo vetëm kaq, por dijetarët islamë kanë vlerësuar se ibadeti (adhurimi) me të cilin nuk synohet kënaqësia e Allahut (xh. sh.), por synohet ndonjë



interes i jetës së kësaj bote, jo që nuk konsiderohet ibadet (adhurim), por konsiderohet mëkat për kryerësin, sepse e ka keqpërdorur adhurimin për interesa të jetës së kësaj bote. Këtë më së mirë na e dëshmon rasti kur sahabiju Ebu Umame el-Bahailiju ka thënë: Erdhi një njeri tek i dërguari i Allahut (s.a.v.s.) dhe i tha: E pe filanin si luftonte? Fitoi shpërblime dhe autoritet! Pejgamberi (a. s.) i tha: **“S’ka asgjë për të.”** Personi në fjalë ia përsëriti këtë tri herë Pejgamberit (a. s.) dhe ai që të tri herët i tha të njëjtën përgjigje. Pastaj tha: **“Vërtet Allahu (xh. sh.) nuk e pranon veprën (punën) e askujt, vetëm nëse është e sinqertë dhe me të synohet kënaqësia e Allahut (xh. sh.)”** (Nisaiju në kapitullin e xhihadit) Prandaj, që haxhiu të mos ngel pa asgjë në Haxhin e tij, duhet që njeteti i tij të jetë i sinqertë dhe vetëm për Allahun (xh. sh.).

TË PËNDOHET ME PENDIM TË SINQERTË, PARA SE TË UDHËTOJË PËR NË HAXH

Njetliu që ka bërë njetet të vizitojë Shtëpinë e Allahut (xh. sh.) - Qabenë dhe të jetë mysafir i Allahut (xh. sh.), obligohet që të pendohet për të gjitha gabimet dhe mëkatet që i ka bërë, me një pendim të sinqertë. Pendimi është detyrim i çdo besimtari në çdo kohë, por në raste të caktuara, siç është rasti i shkuarjes në Haxh, është momenti më i volitshëm të pendohet dhe të largohet nga veprimet e ndaluara. Dijetarët islamë, duke elaboruar argumentet që flasin për çështjen e pendimit, thonë: Nëse njeriu i moshës së rritur dhe psi-

kikisht i shëndoshë shkon në Haxh dhe nuk pendohet për gabimet dhe mëkatet e bëra, është me frikë se edhe Haxhi i tij është i papranuar tek Allahu (xh. sh.) Të flitet për pendimin e sinqertë, është një temë shumë e gjerë, por ajo që duhet ditur haxhiu në këtë rast është fakti se gabimet mes tij dhe Allahut (xh. sh.), pra që janë hak i Allahut (xh. sh.), kërkimi i faljes, bëhet vetëm përmes gjuhës, me bindje dhe sinqeritet, duke kërkuar falje nga Allahu (xh. sh.). E nëse gabimi dhe mëkati janë nga ato veprime që ndërli-dhen me njerëzit, pra që janë hak i njeriut, duhet të kompensohet dëmi dhe të kërkohet falje prej personit që i është bërë padrejtësia (zul-lumi), sepse pendimi në këtë rast varet nga dëshira e tij.

TË PËRKUJDESET QË PASURIA ME TË CILËN E KRYEN HAXHIN TË JETË HALLALL

Nuk ka dilemë se pasuria e haramit ka ndikim dhe sjell pasoja të rënda për besimtarin islam në të gjitha sferat, përfshi këtu edhe adhurimet tjera që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me çështjen ekonomike, siç janë namazi dhe agjërimi, kurse ndikimi i haramit në adhurimet që ndërli-dhen edhe me çështjen ekonomike është edhe më i madh në pranimin dhe mospranimin e adhurimit. Pasuria e haramit ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në mënyrën e jetesës. Pejgamberi (a. s.) në një hadith thotë: **“Kush i blen një palë rroba për dhjetë dërrhem, prej të cilëve vetëm një dërrhem është nga harami, Allahu nuk do t’ia pranohet namazin, derisa ajo rrobë të jetë në trupin e tij.”** (Ahmedi

në Musnedin e tij)

Konsumimi dhe përdorimi i pasurisë së haramit shkakton pasoja të pariparueshme nëse njeriu nuk pastrohet me kohë prej saj. Nga pasojat e pasurisë së haram janë: humbja e bereqetit të pasurisë, shfaqja e hidhërimit të Allahut [Xhel-le Xhelaluhu], shkakton varfërinë shpirtërore dhe zemërore, mospranimi i lutjeve, ndëshkimi në varr, mospranimi i sadakave dhe hyrja në zjarr të xhehenemit. Në hadithin e transmetuar nga Buhariu [Radiall-llahu anhu], Pejgamberi [Alejhis-selam] ka thënë: **“O ju njerëz, vërtet Allahu është i bukur (i mirë) dhe nuk pranon tjetër vetëm se të mirën. Vërtet Allahu i ka urdhëruar besimtarët me atë që i ka urdhëruar pejgamberët dhe ka thënë: ‘O ju të dërguar, hani atë që është e lejuar dhe e mirë dhe bëni vepra të mira, se Unë e di atë që ju veproni.’”** (Suretu el Mu’minun: 51) **Dhe tha: ‘O ju që besuat, hani nga të mirat që ju kemi dhënë dhe falënderoni Allahun, nëse jeni që vetëm Atë e adhuronit.’** (Suretu el-Bekare: 172) **Pastaj përmendi një njeri, i cili për shkak të udhëtimit të gjatë, i rraskapitur dhe i plunosur i kthen duart e tij drejt qiellit dhe thotë: ‘o Zoti im, Zoti im’, mirëpo ushqimi i tij është haram, pija e tij është haram, veshja e tij është haram, është ushqyer me haram dhe, si t’i pranohet atij lutja?!”** (Muslimi)

Fukahatë islamë, duke shqyrtuar të gjitha argumentet autentike që kanë të bëjnë me këtë çështje, kanë konstatuar se në Haxh nuk shkohet me pasuri të haramit. Por, nëse shkon dhe e kryen Haxhin duke i plotësuar ruknet (farzet) dhe kushtet e Haxhit, obligueshmëria e tij bie dhe ky Haxh nuk mund të shpërblehet me shpërblime; pra, nuk klasifikohet në Haxhin që për shpërblim ka Xhenetin.

SHPAKIMI I BORXHIT PARA SE TË SHKOJË NË HAXH

Borxhi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e sistemit ekonomik islam dhe, si i tillë, ka ndikim edhe në çështjen e adhurimeve, dhe veçanërisht në adhurimet që kanë edhe karakter ekonomik, siç është Zeqati dhe Haxhi. Fukahatë islamë zvarritjen e shpagimit të borxhit pa nevojë, ose nga pakujdesia, e trajtuan si veprim të shëmtuar dhe mëkat të madh dhe e in-korporuan në keqpërdorimin e pasurisë

së tjetrit, veprim ky të cilin e ka ndaluar sheriat islam. Disa prej fukahave islamë zvarritësin e borxhit pa nevojë e kanë klasifikuar me dispozitën e Fasi-kut - të njeriut prej të cilit nuk pranohet as dëshmia e tij. Personi që duhet t'i paguhet borxhi ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë dhe gjykatësi si sanksion ka të drejtë shqiptimin e arrestit derisa ta paguajë borxhin.

Pikërisht duke u mbështetur në këto arsye, personi që ka bërë nijet Haxhin, para se të shkojë në Haxh duhet të bëjë përpjekje të shpaguajë borxhin nëse ka borxh. Në të kundërtën, nuk lejohet të shkojë në Haxh, me përjashtim nëse borxhliu i ka dhënë leje që borxhin t'ia paguajë më vonë. Vlerësohet kështu, ngase borxhdhënësi që pret t'i kthehet borxhi, me zvarritjen e tij konsiderohet palë e dëmtuar, për të cilën Pejgamberi (a. s.) na sjell në vëmendje që të kemi

kujdes nga lutjet e tij.

Në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejreja (r. a.) thuhet: Një njeri erdhi te Pejgamberi (a. s.) dhe i tha: O i dërguar i Allahut, unë e kam obligim Haxhin, por kam borxh? Pejgamberi (a. s.) i tha: "Paguaje borxhin tënd."

Në lidhje me këtë çështje transmetohet se kur kishte vdekur njëri prej sahabëve, kishte lënë borxh pas vete dhe nuk kishte lënë pasuri për të shpague borxhin. Kur e mësoi këtë Pejgamberi (a. s.), nuk ia fali namazin e xhenazes. Derisa doli Aliu (r. a.) dhe garantoi se ai do t'ia paguante borxhin. Atëherë Pejgamberi (a. s.) ia fali namazin e xhenazes.

Në hadithin tjetër Pejgamberi (a.s.) thotë: "Shpirti i besimtarit është i lidhur me borxhin e tij, derisa t'i paguhet borxhi." (Tirmidhiu)

TË MËSOJË RREGULLAT E HAXHIT PARA SE TË SHKOJË NË HAXH

Meqenëse Haxhi nuk është adhurim ditor, siç është namazi, por është adhurim me të cilin besimtari islam detyrohet një herë në jetë, është normale që jo secili t'i dijë mirë rregullat e Haxhit. Prandaj, nijetliu për Haxh e ka për obligim që para se të niset për në Haxh, të interesohet dhe të ulet para dijetarëve që të mësojë rregullat e Haxhit, ose të marrë literaturë përkatëse për Haxhin.

TË PËRGATITET SHPIRTËRISHT DHE PSIKIKISHT

Haxhi të bëhet në formë të organizuar dhe të ketë udhëheqës të Haxhit, i cili do t'u prijë haxhinjve në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Haxhin. Kjo ishte praktika e Pejgamberit (a. s.) dhe praktika e *Hulefai rashidinëve*

pas Pejgamberit (a. s.). Prandaj, haxhiu gjatë kryerjes së Haxhit duhet t'u nënshtrohet instruksioneve të udhëheqësit të Haxhit dhe për këtë duhet të jetë i përgatitur shpirtërisht dhe psikikisht. Haxhi nuk është çështje e lehtë, e as e thjeshtë, siç pretendojnë disa: atje paraqiten situata të ndryshme dhe të llojllojshme, prandaj haxhiu detyrimisht duhet të jetë i mobilizuar me durim (sabër) dhe jo ta lëshojë gjuhën e tij dhe të shajë dhe të ofendojë të gjithë ata që gjenden rreth tij. Haxhi nuk mund të kompletohet nëse haxhiu durimin (sabr) nuk e ka në nivelin e duhur.

ME VETE TË MARRË PASURI AQ SA KA NEVOJË

Të marrë pasuri me vete për aq sa ka nevojë për shpenzime, duke mos e tepruar e as duke mos i lënë mangut nevojat e tij gjatë udhëtimit. Nuk është

mirë që haxhiu gjatë kryerjes së Haxhit të tregojë koprracinë e tij dhe të presë që dikush tjetër t'i dhurojë diçka duke kërkuar lëmoshë. Në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet se familjen që e ka lënë në vendlindje e ka pasurinë e mjaftueshme për nevojat ditore, derisa të kthehet nga Haxhi.

SHPËRNDARJA E SADAKASË PARA SHKUARJES NË HAXH

Nijetliu për në Haxh, para se të niset për në Haxh, është e preferuar që t'u japë sadaka të varfërve aq sa ka mundësi. Disa dijetarë kanë thënë "së paku, shtatë të varfërve". Vlerësohet kështu ngase sadakaja e dhënë ia lehtëson rrugën dhe veprimtarinë e mëtutjeshme. Disa nga selefët e ndershëm kanë thënë: 'Jepu sadaka të varfërve dhe nisu për rrugë në cilëndo kohë qoftë.'

FALJA E DY REQATËVE NAMAZ NAFILE

Para se të niset për udhëtim, për në Haxh dhe të dalë nga shtëpia e tij, është e preferuar që të falë dy reqatë namaz nafile të udhëtimit. Në reqatin e parë të këndojë Fatihanë dhe suren Kafirun, kurse në reqatin e dytë suren el-Fatiha dhe suren Ihlas. Disa fukahave kanë thënë se në reqatin e parë këndohet surja el-Jelek dhe në reqatin e dytë surja en-Nas. Pas dhënies së selamit, është e preferuar të këndohet Ajetul-kursija dhe të bëhet lutje.

TË PËRSHËNDETET ME FAMILJEN, TË AFËRMIT DHE FQINJËT

Nijetliu për në Haxh është e preferuar që të përshëndetet me familjen, me vëllezërit e vet, me kushërinjtë dhe fqinjët dhe njëkohësisht të kërkojë prej tyre që të bëjnë lutje për të dhe ai të lutet për ta.

DISPOZITAT MË TË RËNDËSISHME GJATË HAXHIT

1. Kryerja e Haxhit...**farz**; 2. Kryerja e Umres...**sunnet**; 3. Veshja e ihramit dhe nijeti për Haxh ...**farz**; 4. Veshja e ihramit nga Mikati ose para Mikatit...**vaxhib**; 5. Mosveshja e rrobave të qepura gjatë ihramit për meshkujt...**vaxhib**; 6. Mosmbulimi i kokës për burrat gjatë ihramit...**vaxhib**; 7. Mosmbulimi i fytyrës për burrat dhe për gratë...**vaxhib**; 8. Bashkëngjitja e telbijes me ihramin...**vaxhib**; 9. Pastrimi për të hyrë në ihrame...**sunnet**; 10. Parfumosja për të hyrë në ihrame...**sunnet**; 11. Telbija - thënia e telbijes (*lebbejke Allahumme lebbejke*)...**vaxhib**; 12. Tavafi i arritjes (dudum)...**sunnet**; 13. Fillimi i tavafit nga Guri i Zi (*haxherul esved*)... **vaxhib**; 14. Ecja në tavaf për atë që ka mundësi...**vaxhib**; 15. Tri sjelljet e fundit të tavafit... **vaxhib**; 16. Falja e dy reqatëve namaz pas çdo tavafi-qoftë farz, vaxhib apo nafile...**vaxhib**; 17. Sjellja në tavaf të bëhet në të djathtë...**vaxhib**; 18. Saji mes Safasë dhe Mervesë...**vaxhib**; 19. Saji të bëhet pas tavafit...**vaxhib**; 20. Nijeti i sajit...**vaxhib**; 21. Saji të fillojë në Safa dhe të përfundojë në

Merve...**vaxhib**; 22. Ecja më këmbë në saj për atë që ka mundësi...**vaxhib**; 23. Saji të jetë shtatë udhëtime mes Safasë dhe Mervesë...**vaxhib**; 24. Qëndrimi në Arefat...**farz**; 25. Qëndrimi në Arefat Ditën e Arefatit prej zenitit deri pas perëndimit të diellit...**vaxhib**; 26. Largimi dhe dalja nga Arefati në mënyrë të organizuar...**vaxhib**; 27. Bashkimi i namazit të akshamit dhe të jacistë në Muzdelife në kohën e jacistë...**vaxhib**; 28. Qëndrimi në Muzdelife qoftë edhe një moment pas namazit të sabahut...**vaxhib**; 29. Gjuajtja e guralecëve në Mine në Ditën e Bajramit...**vaxhib**; 30. Gjuajtja e guralecëve sipas rendit në ditët e gjuajtjes...**vaxhib**; 31. Qethja e flokëve apo rruajtja e kokës pas Haxhit...**vaxhib**; 32. Radhitja mes këtyre veprimeve: gjuajtja e gurëve, pastaj therja e kurbanit dhe qethja...**vaxhib**; 33. Prerja e kurbanit për haxhinjtë me nijet Kiratn dhe Temetu...**vaxhib**; 34. Tavafi zijaret...**farz**; 35. Tavafi zijaret (farz) të bëhet gjatë tri ditëve të Bajramit...**vaxhib**; 36. Tavafi i lamtumirës për jvendësit...**vaxhib**; 37. Përsëritja sa më shumë e telbijes gjatë ihrameve...**sunnet**;

38. Burrat telbijen ta thonë me zë të lartë...**sunnet**; 39. Sa më shumë të dërgojë salavate mbi Pejgamberin (a. s.) haxhiu...**sunnet**; 40. Shpalimi i shpatullës së djathtë për burrat gjatë tavafit...**sunnet**; 41. Përshëndetja e Gurit të Zi...**sunnet**; 42. Vrapimi i lehtë mes dy shenjave gjatë sajit...**sunnet**; 43. Bujtja në Muzdelife natën e Bajramit...**sunnet**; 44. Gjuajtja e gurëve ditën e parë të bëhet pas lindjes së diellit, deri sa dielli të kalojë në zenit...**sunnet**; 45. Gjuajtja e gurëve ditëve të tjera të bëhet mes zenitit dhe perëndimit të diellit...**sunnet**; 46. Tavafi zijaret të bëhet ditën e parë të Bajramit...**sunnet**; 47. Marrëdhëniet intime bashkëshortore gjatë ihramit...**ndalohen**; 48. Përdorimi i fjalëve të ndyta, sharja, ofendimi etj...**ndalohen**; 49. Mbulimi i fytyrës dhe kokës për meshkujt gjatë ihramit...**ndalohet**; 50. Veshja e rrobave të qepura gjatë ihramit, si: kapuç, xhybe, këpucë etj...**ndalohet**; 51. Shkurtimi i flokëve, rruajtja, prerja e thonjve, shkulja e qimeve nga trupi gjatë ihramit...**ndalohet**; 52. Parfumosja gjatë ihramit me çfarëdo lloj parfumi...**ndalohet**; 53. Gjuetia e tokës, këputja dhe prerja e drurëve...**ndalohet**; 54. Pastrimi

në banjë qoftë nga xhunubllëku, apo pastrimi i thjeshtë ...**lejohe**; 55. Dhënia e gjakut, apo marrja e gjakut nëse ka nevojë, shkulja e dhëmbit, lidhja e fa-

shës...**lejohe**; 56. Pushimi nën hijen e çadrës, të ndërtesës, të pemëve...**lejohe**; 57. Bartja e orës, e anazës...**lejohe**; 58. Mbulimi me batanije apo me çarçaf

gjatë fjetjes, me kusht që mos të mbulohet koka...**lejohe**. (Sqarim: Ky nuk është numri përfundimtar i dispozitave; Jusuf ef. Zimeri)

SHPJEGIM I TERMAVE

Çka është *farz, vaxhib, sunnet, mustehab, mubah, mekruh*? Obligimet, ndalimet e veprave të individëve sipas Islamit, ndahen kështu:

1.**FARZ** është ajo vepër për të cilën Allahu (xh. sh.) urdhëroi rreptësisht që të bëhet dhe dihet saktësisht se është urdhër i Allahut (xh. sh.), siç janë: falja e namazit, dhënia e zeqatit etj. Ai njeri që e refuzon këtë, nuk është mysliman.

Farzi është dy llojesh: **farzi-ajñ** dhe **farzi-kifaje**. -**FARZI-AJN** është obligim për secilin mysliman që ta kryejë individualisht, p.sh. falja e pesë kohëve të namazeve, agjërimi i Ramazanit etj.

-**FARZI-KIFAJE** është obligim për tërë shoqërinë, për bashkësinë myslimane dhe nëse njëri prej tyre e kryen këtë obligim, të tjerët lirohen nga kjo detyrë; por, në qoftë se asnjëri nuk e kryen, atëherë të gjithë janë mëkatarë dhe do të përgjigjen para Zotit të Madhërishtëm (p.sh. falja e namazit të xhenazes).

2.**VAXHIB** është ajo vepër për të cilën Allahu (xh. sh.) urdhëroi që të bëhet, mirëpo nuk jemi gjithaq të sigurt se urdhri i Allahut (xh. sh.) ka të bëjë me të, apo me ndonjë vepër tjetër (p.sh. namazi i vitrit). Mohuesi i vaxhibit nuk del prej imanit, por është mëkatar; do të dënohet.

3.**SUNNET** është çdo gjë që ka punuar Muhamedi (a. s.), që ka porositur ose ka lejuar të punohet. Sunnetet janë dy llojesh: *sunnete muekkede* dhe *sunnete gajri-muekkede*.

-**SUNNETI MUEKKEDE** janë veprat e Pejgamberit (a. s.) të cilat ka bërë vazhdimisht dhe ka urdhëruar që ato të bëhen; jashtë farzeve. P.sh. dy sunnetet e sabahut, falja e namazit me xhematë.

-**SUNNETI GAJRI-MUEKKEDE** janë veprat e Pejgamberit (a. s.) të cilat nuk i ka bërë vazhdimisht, por i ka lënë disa herë (p.sh. sunnetet e iqindisë). Mohuesi i sunnetit nuk dënohet, mirëpo është i larguar nga mëshira e Pejgamberit (a. s.).

4.**MUSTEHAB** janë veprat të cilat janë të lavdërueshme për t'u bërë, që rrjedhin nga Pejgamberi (a. s.), mirëpo ato ai vetë rrallë herë i ka bërë, ose ka folur se është mirë të bëhen (p.sh. të shpejtuarit e iftarit në Ramazan, ose të vonuarit e syfyrit).

5.**MUBAH** janë veprat të cilat nuk janë urdhëruar që të bëhen, por as nuk janë ndaluar që të bëhen; njeriu është i lirë t'i bëjë, ose mos t'i bëjë (p.sh. lloji i ushqimit që preferohet për t'u ngrënë, apo sjelljet e lira, me kusht që mos të pengojmë të tjerët).

6.**HARAM** është çdo vepër të cilën rreptësisht e ndaloi Allahu (xh. sh.) - p.sh. alkooli, ngrënia e mishit të derrit dhe të gjitha veprat e shëmtuara.

7.**MEKRUH** janë ato vepra të cilat nuk është mirë të bëhen, por që nuk janë të ndaluara rreptësisht. Mekruhi ndahet në dy lloje: *mekruh-tahrime* dhe *mekruh-tenzihe*.

-**MEKRUH-TAHRIMEN** janë veprat të cilat janë të ndaluara për t'u bërë, por jo rreptësisht. Këto vepra janë afër harimit. P.sh. veshja e rrobave të mëndafshta dhe vënia e arit për burrat. Duhet ditur se në këtë lloj të mekruh hyn edhe lënia e vaxhibit.

-**MEKRUH-TENZIHEN** janë veprat të cilat nuk janë të pëlqyera për t'u bërë, të cilat nuk janë aq të shëmtuara. P.sh. lënia e sunnetit të iqindisë. Në këtë lloj të mekruh hyn edhe lënia e sunneteve gajri-muekkede.

8.**MUFSID** janë ato vepra të cilat i prishin aktet fetare. Të mos harrojmë: Nga Allahu i Madhërishtëm do të fitojmë shpërblimin (sevapin/thevabin) po qe se i zbatojmë urdhrat dhe obligimet e Tij, si dhe po qe se i vëmë në jetë këshillat dhe porositë e Pejgamberit (a. s.). Për moskryerjen e urdhrave të Allahut (xh. sh.) dhe për bërjen e veprave të shëmtuara (të këqija), do ta meritojmë dënimin e Allahut (xh. sh.) - ikabin. Për kryerjen e veprave që janë mekruh, mund të kemi qortim; ndërsa për disa mekrue mund të marrim edhe dënim të lehtë nga Allahu i Mëshirshëm. Kryerja dhe zbatimi i urdhrave të Allahut (xh. sh.) njerëzimit i sjell dobi dhe harmoni, ndërsa kryerja e veprave të ndaluara njerëzimit i sjell dëme dhe fatkeqësi në këtë jetë dhe në jetën tjetër. (arkiv/bashkëpunim)

NË SHËRBIM TË HAXHINJVE - MYSAFIRË TË ZOTIT

Më 9 qershor, 2022, Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut publikoi Informatën në të cilën thuhet:

Duke u bazuar në numrin e madh të kërkesave nga besimtarët myslimanë, të interesuar që këtë vit të kryejnë shtyllën e pestë të Islamit - Haxhin, Komisioni Qendror pranë Rijasetit të BFI të RMV për Haxhin 2022/1443 me keqardhje njofton se kuota e caktuar për këtë vit, pra numri i vizave të ndara nga Mbretëria e Arabisë Saudite për vendin tonë, është përmbushur para 10 ditëve, edhe atë 905 kandidatë.

Me keqardhje, u kërkojmë ndjesë dhe i lutim për mirëkuptim të gjithë ata të interesuar, në cilëve nuk kemi mundësi t'u inpranojmë kërkesat e tyre për këtë vit,

ndërsa kandidatëve të regjistruar tashmë u dëshirojmë udhëtim të rehatshëm dhe Haxh të pranuar tek Allahu Fuqplotë, sepse: "Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër, përveçse Xhenetin" (Buhariu dhe Muslimi), thuhet në njoftim.

Ekipi paravendosës - udhëheqës në Arabinë Saudite, në përbërje: z. Ismet Ademi, kryetar; z. Irsal Jakupi, dr. Selver Xhemaili dhe Fejsal Kadriu (anëtarë) u kthyen tashmë në vend dhe me suksesin më të madh i ka kryer të gjitha punët në Mekë dhe në Medinë, thuhet në njoftimin e BFI të datës 7 qershor, 2022.

Ata kanë siguruar hotelet në Mekë dhe në Medinë, Arafatin, transportin, Muzdelifen, Minen, kompaninë e aeroplanëve për udhëtim, sistemin e aplikimit dhe shumë obligime të tjera. Numri i kan-

didatëve është plotësuar, 919 kandidatë.

Zotëri Nizam Reshit me suksesin më të madh ka siguruar në Turqi vaksinat e Haxhit dhe ato tashmë janë në Maqedoni të Veriut.

Edhe më tutje kërkojmë syçeltësi nga udhëheqësia dhe përgjegjësi të nivelit të lartë. Zoti ju ndihmoftë në këtë punë të shenjtë. Të jemi në shërbim të haxhinjve. Ata janë mysafirë të Zotit, andaj le të veprojmë të gjithë në lehtësimin e përgatitjes së haxhinjve, sepse me këtë jemi në shërbim të Zotit.

Me keqardhje për numrin e konsiderueshëm të kandidatëve që nuk mund t'i regjistrojmë për shkak të plotësimit të vendeve. Zoti iu dhashtë shëndet, thuhet në njoftimin e BFI të datës 7 qershor, 2022.

MERREN VAKSINAT NGA TURQIA

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 8 qershor, 2022, i bëri një pritje vëllazërore ekipit që solli vaksinat e haxhinjve nga Turqia, angazhimi i të cilëve zgjati gati një javë, thuhet në njoftimin e BFI.

Ky ekip ishte i përbërë nga inspektorët nga Ministria e Shëndetësisë z. Qenan Xhaferi nga Studeniçani (Shkup) dhe Rabi Bajrami nga Dobridolli (Gostivar), bashkë me Përgjeg-

jësin për Lidhje me Turqinë në Rijasetin e BFI të RMV, z. Nizam Reshit.

Që të tre këto personalitete gati 10 vite merren me sigurimin dhe sjelljen e vaksinave për BFI të RMV, që nuk është një punë e lehtë. Andaj, me këtë rast Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu u shprehu falënderime në emër të BFI të RMV për mundin e pashoq në procesin e kësaj pune. Zoti i shpërbleftë, thuhet në njoftimin e BFI.

HOTELET, ME KUSHTE SHUMË TË MIRA

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka nxjerrë më 3 qershor, 2022, fotografitë e dy hoteleve ku do të qëndrojnë haxhinjtë e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë Haxhit 2022, thuhet në njoftimin e BFI.

Hoteli **Snood Al Rayan** الريان سنود فندق, ndër më të bukurit në Mekë, është me kushte shumë të mira dhe në të do të qëndrojnë haxhinjtë e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë Haxhit 2022. Largësia: afër 1 km. Ria Bahsh المكرمة مكة بخش ريع

Al Mehrab Taiba المنورة المدينة طيبة المحراب فندق është ndër hotelet më të bukura në Medinë e Ndritur, me kushte shumë të mira për haxhinjtë e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë Haxhit 2022. Largësia: afër 200 metra prej Xhamisë së Pejgamberit (a. s.), thuhet në njoftimin e BFI.

NJOFTIM PËR HAXHIN 2022/1443 H

Rijaseti i BFI-së, duke u bazuar në nenin 3 pika 17 të Kushtetutës së BFI-së, edhe këtë vit organizon udhëtim për kryerjen e kushtit të pestë islam – Haxhit.

Komisioni Qendror i Haxhit 2022 pranë Rijasetit të BFI të RMV, në bazë të analizave të bëra, faktorëve që ndikojnë në çmimin e arazhmanit të Haxhit, vendosi me sa vijon:

- Çmimi i arazhmanit për kryerjen e Haxhit 1443 H - 2022 është 5.700,00 euro. Paga mund të bëhet edhe në kundërvlerë me valutat tjera, në bazë të kursit të mesëm të Bankës Popullore të RMV në ditën e pagimit.

Në çmim përfshihen:

- Viza dalëse,
- Procedurat administrative për marrjen e vizës së Haxhit,
- Vaksinimi dhe mbrojtja shëndetësore para, gjatë dhe pas udhëtimit, konform ligjeve për mbrojtje shëndetësore,
- Biletat dykahëshe të aeroplanit, si dhe transporti në Arabinë Saudite dhe vendet e shenjta.
- Qëndrimi në hotele në Mekë dhe në Medinë, si dhe qëndrimi në tenda në Arafat dhe në Mina,
- Ushqimi (gjatë qëndrimit në hotele),
- Ihrami dhe kurhani,
- Të gjitha taksat e Haxhit në vend dhe në Arabinë Saudite,
- Nisja planifikohet më 27, 29 dhe 30.06.2022 (Shkup-Xhidde),
- Kthimi planifikohet më 21, 22 dhe 25.07.2022 (Medinë-Shkup).

Ju informojmë se regjistrimi për Haxh 2022 ka përfunduar, ngase është plotësuar kuota e caktuar për Maqedoninë e Veriut nga Ministria e Haxhit e Arabisë Saudite.

Komisioni Qendror i Haxhit pranë Rijasetit të BFI të RMV (3.06.2022)

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Haxhi 2022/1443


5700 €

Lebbejk Allahumme Lebbejk...

- Data e nisjes: 27,29, 30 . 06.2022 (Shkup-Xhidde)
- Data e kthimit: 21, 22, 25. 07.2022 (Medine-Shkup)

Në çmim përfshihen:

- Viza dalëse,
- Prodecurat administrative për marrjen e vizës së Haxhit,
- Vaksinimi dhe mbrojtja shëndetësore para, gjatë dhe pas udhëtimit,
- Biletat dy kahëshe të aeroplanit si dhe transportit në Arabinë Saudite dhe vendet e shenjta.
- Qëndrimi në Hotel në Mekke dhe në Medine si dhe qëndrimi në tendë në Arafat dhe Mina,
- Ushqimi (gjatë qëndrimit në hotel)
- Ihrami dhe Kurhani
- Të gjitha taksat e haxhit në vend dhe në Arabinë Saudite.



PËR ÇMIMIN E HAXHIT

Nga Mustafë Bajrami

Përgjigje miqve që po më pyesin në lidhje me Haxhin, për shkak të çmimit (shumë) të lartë:

1. Haxhin kurrë dhe në asnjë mënyrë askush nuk mund ta ndalojë, përveç në raste shumë specifike, si: lufta, pandemia, rreziku për jetë gjatë shkuarje-ardhjes e të ngjashme.

2. Haxhin e ka obligim ai që ka mundësi materiale të shkojë; natyrisht, pasi paraprakisht t'i plotësojë kushtet juridike shariatike: të jetë mysliman, i shëndoshë (mentalisht dhe fizikisht) e të ngjashme.

3. Çmimi i lartë i Haxhit nuk mund të merret si shkak i ndalimit të shkuarjes në Haxh, përveç në rast krize ekonomike globale për gjërat esenciale të jetesës, si: buka, kripa, uji e të ngjashme. Nëse eventalisht merret ndonjë vendim ndalese i

tillë, institucionet përkatëse shtetërore në këtë rast duhet të konsultohen dhe të koordinohen ngushtë me institucionet përkatëse islame të atij vendi.

4. Nga Shejh Bin Bazi para disa viteve është kërkuar të lëshojë një fetva për ndalimin e organizimit të shkuarjes në Haxh nga institucione apo individë privatë, e të lejojë vetëm institucionet zyrtare. Ai në mënyrë kategorike e ka refuzuar këtë, duke thënë: 'Si është e mundur të kërkohej prej meje të ndaloj diçka që nuk e ka ndaluar Allahu i Madhërishtë?!'

5. Te rasti konkret për ne në Kosovë, miq: Ata që nuk kanë mundësinë ta përballojnë koston (5.700 euro) për të shkuar në Haxh, ata lirohen nga obligimi për të shkuar në Haxh. Prandaj, me gjithë dëshirën e madhe të shkojnë, të tillët nuk duhet të ndjehen keq pse nuk po mund të shkojnë në Haxh.



Allahu a'lem...!

(Autori është studiues i njohur i Islamit dhe analist nga Prishtina. Teksti është shkruar më 3.06.2022, si pjesë e bashkëpunimit me "Hënën e Re")

NUK KA HAXH KOLEKTIV NGA ZVICRA

Nga Irfan Agushi

2022-ta do të shënohet si një vit i dëshpërimit për shumë njerëz, të cilët me gëzim dhe dashuri e prisnin dritën e gjelbër për të realizuar udhëtimin e tyre të jetës - kryerjen e Haxhit në Mekë dhe Medinë.

Këto ëndrra, të thurura me muaj e vite, shumë nijetlive një vendim i autoriteteve saudite, sa u përket haxhinjve nga Evropa, Amerika dhe Australia, ua rrëzoi brenda natës.

Agjencitë e ndryshme evropiane që bënin organizimin e Haxhit në të kalua-

rën këto ditë kanë marrë një shkresë nga autoritetet saudite, në të cilën potencohet se atyre iu merret e drejta e organizimit të Haxhit dhe se prej tani nga Evropa - Zvicra, pa përfshi në këtë rast vendet e Ballkanit si: Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe Shqipërinë, Haxhin do ta menaxhojnë autoritetet saudite, ndërsa personat që duan të shkojnë në Haxh duhet të aplikojnë në ueb-faqen enkas për këtë dhe më pastaj duhet të presin nëse janë pranuar si kandidatë ose jo. Numri i personave që do të udhëtojnë nga Zvicra mund të jetë shumë i vogël, në krahasim me vitet e para pandemisë, për shkak të këtyre risive.

Më e keqja në këtë rast është fakti se ky ndryshim radikal bëhet tani, jo më shumë se një muaj para udhëtimit. Nuk ka asnjë të dhënë rreth fluturimit, akomodimit, kush do t'i drejtojë njerëzit atje etj. Mënyra e re e organizimit e bën të vështirë planifikimin e këtij udhëtimi dhe shumë të pasigurt, për shkak të mungesës së informacioneve.

Organizimi individual i Haxhit mund të duket si diçka e mirë, edhe pse është herët të flitet. Autoritetet e Arabisë Saudite, si duket, duan që gjithçka të kalojë nëpër filtrat e tyre. (St. Gallen, 9.06.2022)

KUSHTET E PRERJES SË KURBANIT



Nga Jusuf ef. Zimeri

Kafsha që duhet prerë kurban duhet të jetë pa të meta. Këto kushte duhen plotësuar që kurbanit të jetë i vlefshëm:

- Kafsha të jetë e shëndoshë (të mos ketë ndonjë sëmundje që e rrezikon apo e dëmton shëndetin e njerëzve) dhe për këtë vendos organi kompetent.

- Të mos jetë e verbër (pra, kafsha që e ka humbur syrin ose të parit nuk vlen për kurban).

- Kafsha që çalon, respektivisht që ecë vetëm me tri këmbë, ose që njërin këmbë e ka të këputur, nuk vlen për kurban. Por, nëse këmbën e katërt e lëshon ngapak në tokë dhe ndihmohet me të sa të ecë deri te vendi ku theret, atëherë ajo vlen për kurban.

-Për kurban nuk vlen kafsha e tërbuar.

- Nuk vlen për kurban kafsha e cila shumicën e veshit e ka të prerë, ose që është e krijuar me të meta pa veshë; e nëse veshi ekziston, por është i vogël, lejohet për kurban.

- Kafsha që e ka të humbur një të tretën e gjuhës. Nëse është dele - lejohet të pritet për kurban, ndërsa nuk lejohet nëse

është nga kafshët e mëdha (lopë, buallicë).

- Për kurban nuk lejohet kafsha që e ka humbur shumicën e dhëmbëve.

- Kafsha që i ka brirët e thyer, nga rrënjët, nuk lejohet për kurban; nëse është e lindur pa brirë, lejohet për kurban.

MOSHA E KURBANIT

Që kurbanit të jetë i vlefshëm, patjetër duhet respektuar edhe moshën e kafshës që do të pritet për kurban. Për kafshët e imëta që priten kurban – pra, delet dhe dhitë - kushtëzohet që të kenë plotësuar një vit të plotë dhe të kenë hyrë në vitin e dytë. Por, dijetarët sqarojnë se nëse delja që ka më shumë se gjashtë muaj, por më pak se një vit, dhe është e rritur dhe e shëndoshë saqë kur të përzihet me kopenë, nuk dallohet nga të tjerat, vlen për kurban. Kafshët e mëdha: lopët dhe buallicat nuk lejohet të priten për kurban nëse nuk e kanë mbushur vitin dhe të kenë hyrë në vitin e tretë, kurse devetë pesë vjet.

BASHKIMI NË NJË KURBAN

Kafshët e mëdha si: lopët, buallicat dhe devetë lejohet që të priten kurban për

më shumë se një njeri, respektivisht deri në shtatë persona. Pra, nëse një i pasur blen një kurban të madh, lejohet për të që në të njëjtin kurban të marrin pjesë edhe gjashtë persona të tjerë, të cilët janë të pasur.

Theksojmë: të pasur, ngase i varfri nuk vlen t'i bashkohet këtij grupi, nga arsyeja se i varfri i ka bërë obligim vetes me përcaktimin për një kafshë për kurban.

Bashkimi për kurban në një kafshë të madhe detyrohet që të gjithë pjesëmarrësit në këtë kurban të kenë për qëllim kurbanin, sepse nëse njëri prej tyre nuk ka për qëllim kurbanin si adhurim, por thjesht vetëm mishin e tij, atëherë kurbanit është i pavlefshëm për të gjithë. Mishi i kurbanit mes pronarëve të tyre duhet të ndahet në mënyrë precize, duke e matur. Në kurbanin e madh lejohet të marrin pjesë edhe më pak se shtatë persona, por nuk lejohet mbi shtatë. /9.06.2022/

(Autori është Drejtor i Sektorit Fetar-Arsimor në Rijasetin e BFI të RMV)

NJOFTIM PËR KURBANET

Komisioni Qendror për Kurbanet 2022 pranë Rijasetit të BFI të RMV i informon besimtarët islamë se Bashkësia Fetare Islame e RMV, si çdoherë, organizon tubimin dhe therjen e kurbaneve, thuhet në njoftimin e BFI (dt. 6.06.2022).

Duke marrë parasysh rritjen e çmimeve në treg, Komisioni, duke i analizuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e çmimit, vendosi që çmimi i kurbanit për këtë vit të jetë 150,00 euro (ose kundërvlera e tyre në valuta të tjera).

Mishi i kurbaneve do të përdoret për nevojat e kuzhinës në Konviktin e Medresesë Isa Beu në Shkup, ndërsa sasia tjetër e mishit të kurbaneve do t'u shpërndahet familjeve në nevojë.

I bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që t'ju pranojë kurbanet dhe t'ju shpërblejë me dhuratat e Tij të pakufishme, përfundon Njoftimi i Komisionit Qendror për Kurbanet 2022 pranë Rijasetit të BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.



BASHKËSIA FETARE ISLAME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kurbanit 2022/1443

Çmimi
€150

Pagesat bëhen në:

- Muftinitë përkatëse
- Medresenë "Isa Beu"
- Rijaset
- Fakultetin e Shkencave Islame

Thuaj: "Namazi im, kurbanit im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjeshtë vetëm për Allahun, Zotin e botëve." (En'am, 162)

KONSULTIM ME MYFTINJTË PARA HAXHIT

Në prag të nisjes së haxhinjve nga RMV për në vendet e shenjta, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 23.06.2022 thirri myftinj të Myftinive të BFI të RMV, me qëllim të konsultimeve dhe parapërgatitjeve finale për organizimin dhe realizimin sa më të mirë të Haxhit 2022, thuhet në njoftimin e BFI.

Përveç myftinjve, në këtë mbledhje ishin edhe Drejtori i Medresesë Isa Beu, Kryetari i Kuvendit të BFI dhe drejtorët e Sektorëve të Rijasetit, të cilët janë të angazhuar në realizimin e Haxhit.

Në këtë mbledhje u diskutua për të



gjitha planifikimet që BFI po i bën, me qëllim që haxhinjve tanë t'u mundësohet një udhëtim sa më i rehatshëm dhe mbresëlënës, thuhet në njoftimin e BFI.

MBLEDHJE ME KOORDINATORËT DHE ME UDHËHEQËSIT



Më 23.06.2022 Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, konvokoi mbledhjen parapërgatitore me Komisionin e Haxhit

2022, së bashku me koordinatorët, imamët dhe udhëheqësit që do t'u shërbejnë haxhinjve nga Maqedonia e Veriut për t'i kryer ritet dhe ibadetet fetare gjatë Haxhit në vendet e shenjta në Mbretërinë e Arabisë Saudite, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë mbledhje u diskutua hollësisht për të gjitha veprimet dhe planifikimet që BFI po i bën, me qëllim që t'u mundësohet haxhinjve tanë një udhëtim sa më i rehatshëm dhe mbresëlënës, ku nëpunësit fetarë të BFI do të jenë në përkujdesje të vazhdueshme të tyre, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM ME EKIPIN E MJEKËVE

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 23.06.2022 u takua me ekipin medicinal që do të kujdeset për shëndetin e haxhinjve nga Maqedonia e Veriut gjatë qëndrimit të tyre në vendet e shenjta në Mbretërinë e Arabisë Saudite, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë takim Reis'ul-Ulemaja hollësisht i njoftoi mjekët për të gjitha veprimet dhe planifikimet që BFI po i bën me qëllim që t'u mundësohet haxhinjve tanë një udhëtim sa më i rehatshëm dhe mbresëlënës, ku pikësepari shëndeti i çdo haxhiu nga Maqedonia e Veriut është primare për BFI e RMV.



Ekipi medicinal, i cili do t'i shoqërojë haxhinjtë tanë, do të jetë në shërbim të tyre 24 orë, çdo ditë, thuhet në njoftimin e BFI.

KËSHILLTARJA AMERIKANE PËR LIRITË FETARE QËNDRON NË BFI

Më 16 maj, 2022, Këshilltarja Politike për Liritë Fetare në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, znj. Rejçell Kollins (Rachel Collins), e shoqëruar nga analisti politik në Ambasadë, z. Adrian Ismaili, patën një takim zyrtar me Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në Rijasetin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Fillimisht, Reis'ul-Ulemaja i dëshiroi mirëseardhje zonjës Rejçell në vizitën e parë të saj në BFI dhe e falënderoi për bashkëpunimin e vazhdueshëm mes BFI-së dhe Ambasadës së SHBA-ve, e cila është një nga qendrat më mbështetëse të institucionit tonë fetare në vend.

Më pas, Kryetari i BFI paraqiti një përshkrim të shkurtër për Bashkësinë Fetare Islame të RMV, funksionimin e saj dhe organizimin e jetës fetare islame në vend, ku gjithashtu shpjegoi edhe sfidat me të cilat përballet BFI gjatë këtyre dy viteve të fundit, ku paralelisht gjatë periudhës së pandemisë së Covid-19 BFI ka luajtur një rol kyç në vetëdijesimin e popullatës dhe parandalimin e kësaj sëmundje dhe realizimin e projekteve dhe



aktiviteteve të ndryshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Theks i veçantë në takim u vu tek akreditimi i Medresesë Isa Beu, që është imperativ i kohës.

Nga ana e saj, zonja Rejçell Kollins çmoi lart veprimtarinë e Reis'ul-Ulemasë, autoritetin e tij që gëzon në popullatë dhe punën e palodhshme në vetëdijesimin e popullatës për pandeminë me Covid-19, vaksinimin, si dhe punën e tij të palodhshme në edukimin dhe shkollimin e gjeneratave të reja. Po ashtu, u vlerësua lart edhe qëndrimi dhe angazhimi i BFI, me në krye Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për dialogun ndërfaqetor në vend.

Në këtë takim Kryetarin e BFI e shoqëronin: z. Agron Vojnika, Udhëheqës i Sektorit për Informim Publik; z. Ismet Ademi, Udhëheqës i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe; dhe z. Mustafa Dauti, Udhëheqës i Sektorit të Punëve të Jashtme, thuhet në njoftimin e BFI.

FALËNDERIME PËR LUTJET PËR PAQE NË UKRAINË



donisë së Veriut 'Lesja Ukrainka', si dhe në emrin tim, para së gjithash dëshiroj t'ju uroj festën e Bajramit të Ramazanit dhe t'ju falënderoj nga zemra për lutjet për paqe në Ukrainë më 1 maj 2022 në xhamitë anembanë vendit.

Të gjithë lutemi që kjo gjakderdhje të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, andaj për ne janë shumë të vlefshme lutjet që pjesëtarët e fesë myslimane në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë bërë për paqe, në kohët më të vështira për ne, dhe në kohën kur të gjithë kemi nevojë më së shumti për paqe. Kjo është arsyeja pse një mbështetje e tillë prej jush është vërtet e paçmueshme për ne.

Mes tjerash, jemi të bindur se me lutje në të njëjtën ditë nga pjesëtarët e bashkësive të ndryshme fetare në mbarë vendin, shteti i Maqedonisë së Veriut dërgoi një mesazh të fortë përkushtimi për një fund të menjëhershëm të luftës në Ukrainë dhe rikthimin e paqes botërore, thotë në letër Kryetari i Shoqatës Oleksandër Urbanoviç.

Fotografi nga xhamitë gjatë lutjeve të bëra për paqe në Ukrainë u shpërndanë nëpër të gjitha mediet botërore dhe rrjetet sociale. Lutjet për paqe ishin vlerësuar edhe nga Presidenti Volodymyr Zelensky, si një mbështetje morale për popullin e stërvuar ukrainas gjatë invazionit rus në këtë vend, thuhet në njoftimin e BFI. (12.05.2022)

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT (10 QERSHOR 1878): PROJEKSION I SHTETIT KOMBËTAR SHQIPTAR

Nga dr. Hasan Bello

Lufta ruso-turke që filloi në prill të vitit 1877 mori fund me disfatën e Perandorisë Osmane në janar të 1878-tës. Kjo shënoi dhe ndërhyrjen e parë "kirurgjikale" të pansllavizmit, i cili me mbështetjen e Fuqive të Mëdha projektoi e zbatoi në terren zgjerimin e shteteve sllave të Ballkanit. Që nga kjo periudhë, ky rajon në mënyrë ciklike u është nënshtruar luftërave, spastrimit etnik të kombeve josllave dhe gjenocidit.

Në traktatin paraprak, që u nënshkrua në Shën Stefan më 3 mars 1878, Rusia dhe aleatët e saj ballkanikë (Bullgaria, Serbia dhe Mali i Zi) nxorën përfitime të mëdha, në pamje të parë, në kurriz të Perandorisë Osmane. Por, në të vërtetë, ato që e pësonin më tepër ishin territoret shqiptare. Mjaft prej tyre do t'u jepeshin shteteve sllave të Ballkanit, të cilat konsideroheshin "klientelë" e influencës politike dhe diplomatike ruse.

Kjo situatë shkaktoi një valë të madhe zemërimi në Shqipëri. Perandoria Osmane dhe sulltan Abdylhamidi II ishin të pafuqishëm për të penguar vendimet e Shën Stefanit. Sulltani sapo kishte ardhur në fron pas një grushti shteti (intrigë oborri), që kishte rrëzuar xhaxhanë, Abdylazizin dhe e kishte zëvendësuar atë me të vëllanë, Muratin V, i cili për shkak të implikimit në grushtin e shtetit kishte pësuar tronditje të rëndë psikologjike, duke e detyruar të dorëhiqej. Për këtë arsye, fillimisht sulltani dhe Porta e Lartë, nën rrogë, do të nxisin elitën politike shqiptare në Stamboll dhe në vilajete të organizoheshin dhe t'i dilnin zot atdheut të tyre. Kjo konfirmohet nga shumë burime, por mbi të gjitha, nuk ishte rastësi që në kryeqytetin e Perandorisë do të krijohet "Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të

Drejta të Kombësisë Shqiptare". Në këtë organizatë të fshehtë nacionaliste shqiptare merrnin pjesë personalitete si Sami Frashëri, Ali Danish Prishtina, Pashko Vasa, Abdyl Frashëri, Jani Vreto, Zija Prishtina etj.

Në maj të vitit 1878 ky Komitet do të lëshojë një thirrje drejtuar bashkatdhetarëve, me të cilën bënte të njohur programin e vet. Kjo thirrje dhe të tjera veprime do t'i nxisë drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të marrin masa për të organizuar një kuvend kombëtar.

Nënkohë, vendimet e Traktatit të Shën Stefanit u kundërshtuan nga Fuqitë e Mëdha, të cilat u shqetësuan nga ekspansioni i ofensivës ruse dhe zgjerimi i mantetutave të saj në Ballkan. Prandaj, për të zvogëluar disi oreksin dhe përfitimet e tyre, u vendos që më 13 qershor 1878 të mbledhej në Berlin një Kongres i posaçëm. Tre ditë përpara këtij forumi ndërkombëtar, në qytetin e Prizrenit u mbajt një kuvend me përfaqësues nga të gjitha krahinat.

Në fjalimin e hapjes, Abdyl Frashëri deklaroi: "...Qëllimi i Kuvendit është që t'ua presim hovin armiqve të pashpirt, duke lidhur besën shqiptare dhe duke u betuar që t'i mbrojmë me gjak trojet që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë...". Një nga vendimet e këtij Kuvendi ishte themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me degë në të gjitha krahinat e Shqipërisë, e cila do të kishte si qëllim kryesor të shpëronte territoret shqiptare nga copëtimi. Një vendim tjetër po aq i rëndësishëm ishte organizimi i një force të armatosur. Programi i LSHP i jepte asaj fizionominë e një qeverie, që kishte marrë përsipër projeksionin dhe krijimin e një shteti kombëtar shqiptar.

Kongresit të Berlinit iu drejtuan nga të gjitha krahinat e Shqipërisë lutje, kër-

kesa dhe memorandume, të cilat shpalosnin shqetësimin e popullsisë shqiptare. Një memorandum i njohur është dhe ai i dërguar nga dega e LSHP në Shkodër drejtuar përfaqësuesit të Britanisë së Madhe në Kongresin e Berlinit, lordit Beaconsfield, ku ndër të tjera, theksohej: "Ashtu sikurse ne nuk jemi dhe as duam të jemi turq, ashtu do të kundërshtojmë me tërë fuqitë tona kundër cilitdo që kërkon të na bëjë sllavë ose austriakë, ose grekë. Ne s' duam të jemi veçse shqiptarë." Ky memorandum ishte firmosur nga 500 përfaqësues nga paria e të gjithë qytetit.

Por, fatkeqsisht, Kongresi i Berlinit nuk i mori parasysh kërkesat e shqiptarëve dhe vendosi që një pjesë e atyre territoreve t'u kalonin shteteve sllave. Kjo bëri që LSHP të hidhej në aksion dhe të artikullonte qartë aspiratat e kombit shqiptar.

Në nëntor të 1878 ajo i drejtoi Portës së Lartë pesë pika, të cilat pasqyronin projeksionin e krijimit të shtetit të ardhshëm kombëtar shqiptar:

1. Bashkimin e vilajeteve shqiptare;
 2. Nënpunësit që do të shërbenin në Shqipëri të dinin gjuhën shqipe;
 3. Arsimit të përhapet në të gjitha anët e vendit. Nëpër shkollat të mësohet edhe gjuha shqipe;
 4. Të zbatohen vendimet e dobishme për Mbretërinë dhe për kombin, të cilat do të përfundohen prej mbledhjes së përgjithshme, e cila do të mbahet katër muaj, çdo vit në qendrën e vilajetit;
 5. Të caktohet një pjesë e mjaftueshme nga të ardhurat e vilajetit që të përdoret për arsim dhe për ndërtime botore.
- Kërkesat e mësipërme do t'i parashtrihen sulltanit në Stamboll nga një delegacion i posaçëm, i cili kryesohej nga kryetari i Lidhjes, Iljaz Pashë Dibra. Por,



Porta e Lartë, e cila gjendej në një pozitë tepër të vështirë brenda dhe jashtë saj, mbajti një qëndrim pasiv. Ajo, as nuk i pranoi, as nuk i refuzoi pretendimet e delegacionit shqiptar. Për të bindur qarqet diplomatike, në emër të Lidhjes, në vitin 1879 Abdyl Frashëri dhe Mehmet Ali Vrioni ndërmorën një mision diplomatik në kryeqytetet e Evropës. Me këtë rast, ata i dorëzuan Anglisë, Francës, Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Italisë një memorandum ku mbronin të drejtat historike të shqiptarëve.

Presioni ndërkombëtar mbi Portën e Lartë do ta detyrojë atë që drejt Shqipërisë të nisë disa ekspedita ushtarake. Sipas Kongresit të Berlinit, krahinat shqiptare të Plavës dhe të Gucisë duhej t'i jepeshin Malit të Zi. Por, rezistenca që bënë shqiptarët i detyroi Fuqitë e Mëdha që në vend të tyre, t'i jepnin atij Hotin dhe Grudën. Edhe kjo përpjekje hasi në rezistencë dhe bëri që Fuqitë t'i jepnin Malit të Zi qytetin e bukur bregdetar të Ulqinit. LSHP e kundërshtoi këtë vendim. Ajo organizoi forca për të luftuar. Kjo bëri që Fuqitë e Mëdha në shtator të 1880 të dërgonin një flotë ndërkombëtare

nga deti, ndërsa nga toka e detyruan Perandorinë Osmane të çonte forca të armatosura. Lufta për mbrojtjen e Ulqinit shkaktoi sensibilitet në shtypin dhe në parlamentin britanik.

Në diskutimet që u zhvilluan në Dhomën e Komunave më 4 shtator 1880 spikat fjalimi i deputetit Joseph Cowen, kur njëri nga kolegët deklaroi se "shqiptarët nuk janë një komb". Ai iu drejtua me fjalët: "Nuk janë një komb, thotë zotëria e tij. Atë fjalë tha dhe princi Bismark në Berlin. Princi Bismark tha se nuk kishte dëgjuar të kishte një komb shqiptar. Por, princi Bismark nuk kishte dëgjuar as për popullsinë e Holandës e të Danimarkës. Një tjetër princ, aq i fuqishëm sa është princi Bismark sot, pretendoi në Kongresin e Vjenës që s'dinte ndonjë komb italian. Sipas mendjes së këtij diplomati, Italia nuk ishte 'veçse një shprehje gjeografike'. Dhe, megjithëkëtë, sot të gjithë e dimë se Italia është një komb i madh dhe i bashkuar. Ajo që u vërtetua në më pak se 50 vjet për popullin e një ane të Adriatikut, mund të vërtetohet me një mënyrë të ndryshuar edhe për anën tjetër, në aq kohë e sipër.

Sipas meje, do të ishte një padrejtësi e madhe të viheshin shqiptarët nën zgjedhjen malazeze, sa sikur të viheshin malazetët nën zgjedhjen e shqiptarëve."

Pas dorëzimit të Ulqinit, konflikti mes LSHP dhe Portës së Lartë kishte shpërthyer hapur. Në dhjetor 1880 megjithëse shqiptarët shpallën autonominë e njëanshme, nuk mund t'i bënin ballë epërsisë ushtarake të Perandorisë. Kjo e fundit pavarësisht masave të ashpra në terren, në krye të Ministrisë së Jashtme emëroi shqiptarin Abedin Pashë Dino. Ky do të ishte dhe kryesues i bisedimeve me palën greke, për caktimin e kufirit me Greqinë. Abedin Pasha ishte vetë nga një familje shqiptare e Çamërisë dhe nga diplomatët e huaj konsiderohej si antigrek e antisllav. Prandaj bisedimet për kufirin me Greqinë do t'i zvarrisë në maksimum. Aq sa, Fuqitë do të kërkojnë largimin e tij si Ministër i Jashtëm.

Pavarësisht se LSHP do të shpërndahej, themelet që ajo hodhi për krijimin e shtetit shqiptar mbetën një kontribut i rëndësishëm në aspektin politik, diplomatik dhe ideologjik, duke shënuar lindjen de jure të nacionalizmit shqiptar.

THEMELIMI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Nga Jusuf Buxhovi

Kuvendi i Lidhjes u hap më 10 qershor 1878 në Prizren, në Medresën e Mehmet Pashës, pranë Bajrak-Xhamisë. Edhe data e mbajtjes nuk ishte e rastësishme, meqë ajo duhej të mbahej para se të fillonte punimet Kongresi i Berlinit, që ishte caktuar të mbahej më 13 qershor.

Nga të dhënat e tanishme, të cilat janë të pakta, meqë është ruajtur vetëm një pjesë e protokolleve të mirëfillta të mbledhjes, merret vesh se në Kuvend kanë marrë pjesë më shumë se njëqind përfaqësues të shumë krahinave shqiptare, por ku mungonin delegatët e Vilajetit të Shkodrës (nisja e të cilëve thuhet se ishte penguar nga intrigat e valiut turk Hysen Pasha, por që arsyet janë pak më të thella), ndërsa nga Vilajeti i Janinës mori pjesë vetëm Abdyl Frashëri.

Megjithatë, nga këta 110 emra që gjenden dhe shumica vijnë nga Vilajeti i Kosovës, kryesisht janë personalitete që kishin marrë pjesë në kryengritjet kundër Tanzimatit, ndër të cilët shquhen Ali bej Gucia, Iljaz pashë Dibra, Hasan pashë Tetova, Ymer Prizreni (kryetar i Komisionit organizativ të Kuvendit), Abdullah pashë Dreni, Ahmet Korenica, Shaban bej Prizreni, Jashar bej Shkupi, Shaban bej Peja, Filip Doda, Sulejman Vokshi, Shuaqip Spahiu, Ali Ibra e të tjerë.

Në kuvend morën pjesë si delegatë disa feudalë boshnjakë dhe sulltanistë nga viset e Bosnjë-Hercegovinës. Aty mori pjesë edhe mytesarifi turk i Prizrenit, Qamil Beu, bashkë me disa përkrahës të linjës sulltaniste, e cila bazuar në raportet e konsujve të pranishëm në Prizren ishte mjaft aktive. Kjo demanton në tërësi pohimet se Lidhja u mbajt "fshehtë" dhe pa dijen e Portës.

Në bazë të dokumenteve me mangësi të shumta, megjithatë, kuptohet se Kryetar i Kuvendit u zgjodh Iljaz pashë Dibra, ndërsa aty foli Abdyl Frashëri, jo në cilësinë e "kryetarit" e as "të kryesuesit" të Lidhjes, siç është shënuar nga një pjesë e mirë e historiografëve shqiptarë, por si përfaqësues i Komitetit të Stambollit.

Ajo që ishte më e rëndësishme, megjithatë kishte të bënte me faktin se Kuvendi ia doli të marrë vendimin për themelimin e një organizate me karakter politik e ushtarak, të një Lidhjeje (Ittifaku), me një qendër të vetme drejtuese dhe me degë të saj në të gjitha krahinat e vendit, e cila do të merrte përsipër detyrën që të mbronte me çdo mjet interesat e vendit.

Sipas traditës, së bashku me formimin e Lidhjes, u shpall edhe një besë e përgjithshme, në bazë të së cilës duhej të pushtonin menjëherë të gjitha veprimet e gjakmarrjes ndërmjet banorëve të krahinave që ishin përfshirë në Kuvendin e Prizrenit.

Kuvendi themeloi organet e larta. Në krye të Lidhjes ishte Këshilli i Përgjithshëm me seli në Prizren, nga i cili do të vareshin degët krahinore. Kryetar i tij u zgjodh Iljaz pashë Dibra. U formua edhe Komiteti Qendror i Lidhjes nga tri komisione: komisioni i punëve të jashtme me përgjegjës Abdyl Frashërin, komisioni i punëve të brendshme i drejtuar nga Haxhi Shabani dhe komisioni i të ardhurave financiare i drejtuar nga Suljeman Vokshi.

Aktet e para të Kuvendit të Përgjithshëm ishin: një peticion për çështjen shqiptare, dërguar Kongresit të Berlinit, dhe një peticion, dërguar Portës së Lartë, Kararnameja (Akti i vendimeve-kanuni) dhe Talimati (Urdhëresa).

Kararnameja (Akti themelor) kishte gjashtëmbëdhjetë pikë, me të cilin mund të thuhej se sanksionohej formimi i Lidhjes si organizatë politike (pika 16) dhe përcaktonte detyrat e saj më të ngutshme. Në pikën 1 theksohej karakteri mbrojtës, ndaj çdo qeverie, përveç asaj të Portës së Lartë, të veproje aktivisht me të gjitha mjetet për të mbrojtur integritetin e vendit.

Në nenin 4, kur thuhet se "me ligjet e lara të shariatit, ne do të mbrojmë jetën, pasurinë dhe nderin e shokëve besnikë të besimit jomysliman, ashtu si për vete", bën të ditur për ruajtjen e karakterit islamik, gjë që si formulim në ato rrethana ishte edhe i pashmangshëm.

Frymën kombëtare nga e cila ishte e

privuar më 10 qershor ditën e hapjes së Kuvendit dhe veçmas nga kërkesat për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një, që ishte një formë e autonomisë, me të cilën sigurohej mbrojtja e vendit nga copëtimet e mëtutjeshme që kërcënonin nga të gjitha anët, Lidhja do të fillojë ta animojë qysh në Kuvendin e Përgjithshëm, i cili u mblodh në Prizren, më 1 korrik 1878. E kompletuar me 96 delegatë nga Kosova dhe me delegatët nga Shkodra (26 sish) e të Vilajetit të Janinës (me 20), pas një diskutimi të gjerë, Kuvendi miratoi një Rezolutë ose Kanun të ri për Lidhjen e Prizrenit, me të cilin u bënë hapat e rëndësishëm në përpunimin e mëtejshëm të programit të Lidhjes. Sepse, Kanuni i ri e shpalli botërisht organizatën e themeluar në Prizren si Lidhje Shqiptare dhe organin i saj qendror e quajti Komiteti Kombëtar.

Statuti i ri ishte pastruar nga ndonjë formulim me karakter fetar islamik dhe nga ideja e besnikërisë ndaj Perandorisë Osmane, që kishte pasur vend në Kararname. Në tekstin e Kanunit thuhet shprehimisht se Lidhja do të luftonte për të drejtat kombëtare shqiptare dhe se veprimtarinë e saj do ta shtrinte vetëm në trojet shqiptare. Ajo i jepte të drejtë Komitetit Kombëtar të formonte nënkomitete të Lidhjes në qendrat e sanxhaqeve të Shqipërisë, të organizonte një ushtri të armatosur për të mbrojtur trojet shqiptare, të shpallte mobilizimin ushtarak të të gjithë burrave të aftë për armë, të vilte, për nevojat e veta buxhetore, një sërë taksash të ndryshme dhe të jepte dënime penale kundër dezertorëve nga Lidhja Shqiptare, me çka mund të thuhet se Lidhja kishte krijuar rrethanat për marrjen mbi vete funksionet e një qeverie.

Kanuni i miratuar më 2 korrik 1878 shënon një fitore të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në gjirin e Lidhjes së Prizrenit. Në të vërtetë, me këto të drejta, që u sanksionuan në Kanunin e 2 korrikut 1878, Lidhja Shqiptare e Prizrenit fitoi bazën ligjore për të ngritur shkallë-shkallë një shtet autonom shqiptar brenda shtetit perandorak osman.

NË XHAMINË BAJRAKLIE...

10 Qershor 1878: Lidhja e Prizrenit.

Ishte një organizim politik i parisë së katër vilajeteve shqiptare në Perandorinë Osmane, themeluar zyrtarisht më 10 qershor 1878 në Xhaminë Bajraklie të Prizrenit, ku deri një vit më parë kishte qenë qendra e Vilajetit të Kosovës. Xhamia e Bajraklisë është ngritur në vitin 1573/74 nga ushtaraku i Perandorisë Osmane Gazi Mehmed Pasha. Më pas kjo xhami u kthye në një kompleks, me hamamin, mejtepin, tyrben (mauzoleun), medresenë dhe dershanen - amfiteatrin e vogël. (Nga AIITC-Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë)

SHKALLA E TË MENDUARIT, LLOJI MË I PËRSOSUR I IBADETIT ISLAM

“Dhe ai është i cili tokën e shtriu dhe në të krijoi kodra e lumenj dhe prej secilit fryt bëri dy lloje (çift), bëri që nata ta mbulojë ditën. Vërtet, në gjithë këtë ka fakte për njerëzit që thellë mendojnë.” (Er Rad: 3)

Shkruan: Taxhudin Hamidi

Misioni më i rëndësishëm i botës së njerëzimit është të menduarit për veten dhe për të gjitha krijesat tjera. Kjo është një dhunti e madhe dhe kryesore në sferën e interpretimit dhe të komentimit. Të menduarit për botën e lashtë dhe klasike. Të menduarit për pejgamberët e dërguar nga Zoti. Të menduarit për tregimet e Kuranit.

Pra, shkalla e të menduarit është shkolla rundimentare dhe më e përsosur, e cila nuk kërkon përgatitje paraprake. Ajo vazhdimisht e jep frytin dhe produktin e saj tek ai që mendon. Pejgamberi islam ka kërkuar që ithtarët e tij të ushtrorin shkallën më të lartë të të menduarit.

Prof. Abas Akadi thotë: “Mendja që mendon dhe arrin të kontribuojë me të menduarit, është kajmaku i idesë dhe interpretimit.”

Kurani i ka përmenduar të gjitha format e të menduarit psikologjik, sociologjik, fizik, shpirtëror dhe të veprimtarisë fetare si një kategori e shfaqur bukur në rrafshin racional dhe të arsyes së shëndoshë. Shkalla e më e lartë në procesin e çdo veprimtarie është mendimi dhe ideja e paraqitur në programet e çdo pune dhe veprimtarie.

TË MENDUARIT URDHËROHET NË TË GJITHA SFERAT

Pa dyshim se të menduarit drejt është një sferë e gjerë dhe e thellë në kontemplacionin dhe interpretimin e Kuranit fisnik. Kurani në shumë vende dhe sure paraqet format e të menduarit si një metodologji të nevojshme pedagogjike dhe kulturore. Ai shkallën e të menduarit e urdhëron në të gjitha sferat e jetës dhe të zhvillimit, duke filluar nga krijesat e Zotit, si: qielli, toka, njeriun dhe të gjitha



gjërat që e mbulojnë dhe e rrethojnë jetën e njeriut.

Kohëve të fundit, duke u trishtuar nga ngjarjet e krizave të ndryshme pandemike dhe luftarake, harruam të mendojmë se kriza më e madhe dhe më kërcënuese paraqitet në veten e çdo njeriu dhe ajo është kriza e të menduarit gabim, ose e të menduarit në mënyrë jo të drejtë. Aftësia për të menduar është kategoria e njerëzve të civilizuar dhe përpamitarë, që menaxhojnë dhe koordinojnë në baza të paqes dhe të lirisë njerëzore. Gjykatësi i njohur i Damaskut në lidhje me shkallën e të menduarit-tekur ka thënë: “Ibadeti më i madh është të menduarit.”

Muhamedi (alejhisselam), duke i ku-

shtuar rëndësi të madhe meditimit dhe mendimit të drejtë në rrugën e Zotit, ka preferuar që të caktohet një vend i posaçëm për të zhvilluar shkallën e të menduarit në të gjitha segmentet e jetës dhe të përpamimit njerëzor. Për shkak se nga mësimet islame kërkohet që besimtari të mendojë për krijesat e Zotit! Besimtari islam në asnjë mënyrë nuk duhet ta harrojë rëndësinë e të menduarit dhe kontemplacionin në rrugë të Zotit. Të menduarit duhet të shkojë deri në atë shkallë sa që të arrijë në pamundësinë e rezultateve, që kjo ta vërtetojë se vetëm Zoti është i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.

Kërkimi, angazhimi dhe përpjekja për të menduarit paraqet shkallën edukative dhe filozofike të fesë për të dëshmuar se

vetëm Zoti është i përsosur-kamil.

Forca mendore është shkalla e të menduarit dhe e kontemplacionit që prodhon dije dhe njohje të reja. Reformat e dijes janë të pamundura të zhvillohen në mungesë të të menduarit. Pra, shkalla më e lartë e procesit mendor e arsyeton njohjen dhe dijen në çdo segment të jetës dhe të zhvillimit njerëzor.

Nga shumë dijetarë islamë mund të dëgjohet dhe të lexohet se saktësia e ibadetit në namaz dhe jashtë namazit është shkalla e të menduarit. Pra, nëse falet ndonjë namaz dhe nuk kemi saktë dijeni se për cilin namaz bëhet fjalë, ky namaz me automatizëm priset dhe nuk llogaritet namaz. Pra, prej kësaj kuptojmë se të menduarit dhe shkalla më e lartë e kontemplacionit është edhe shtylla kryesore e namazit islam. Sepse, vetëm me të menduarit e drejtë dhe religjioz e shkencor, ne vërtetojmë për njerëzillëkun dhe bontonin njerëzor. Përmes të menduarit ne zbulojmë vetveten dhe njerëzit rreth nesh, gjë e cila na mundëson të jetojmë me të tjerët dhe në orbitën e zhvilluar sociale dhe sociologjike.

“A NUK JENI DUKE MENDUAR?!”

Zoti e krijoi mendjen për ta shfrytëzuar dhe për të menduar. Vetëm duke e

angazhuar mendjen, ne do të mundemi të jetojmë në harmoni, në liri dhe në barazi. Zoti në Kuran thotë: “A nuk jeni duke menduar?!” Pra, mungesa e të menduarit shkakton mosbesim. Prandaj edhe Kurani në vazhdimësi e paraqet problemin e periudhave kur njeriu nuk ka menduar për kohën, për gjendjen dhe për veten e vet. Ky luks i ka kushtuar shumë njerëzimit.

Bota ateiste nuk e dëshiron mendimin. Ajo, duke i siguruar disa afinitete natyrore, deklaronte që të mos mendohet. Slogani i njohur komunist ishte i njohur: “Mos mendo; vetëm zbato...” Kundërshtimi i ateizmit ishte dhe mbetet forma e të menduarit në Madhështinë e Zotit dhe në thellësinë e njohurive të krijesave të Tij. Ibadeti në heshtje është një adhurim, të cilin Allahu e do shumë, e pëlqen dhe ai është ibadeti i të menduarit. Thënia e dijetarëve islamë është e njohur: “Të menduarit një moment, është barabar me namazin e natës.”

Pra, edhe namazi pa shkallën e duhur të të menduarit nuk mund edhe të quhet ibadet apo adhurim. Adhurimi kërkon meditim të saktë dhe të kompletuar, me programe voluminoze dhe plane të pandërprera në favor të njerëzimit. Të menduarit rreth nimeve dhe begatitve të

Zotit është një turizëm dhe shikim i peizazhit në horizontet e ndritshme dhe të shkëlqimit. Të menduarit, gjithashtu, paraqet segmentin kryesor të trajnimit të besimtarëve islamë dhe të gjithë atyre që gravitojnë në bregdetin e oqeanit të quajtur mendim, ide, kontemplacion, studim, mësim, arsim dhe njohje të të vërtetës burime nga Kurani fisnik.

Vazhdimësia e të menduarit rezulton ashtu që mendja e njeriut dhe besimi në Zot afrohen dhe vendosin të bashkëpunojnë me rekomandimet dhe këshillat e zemrës. Të menduarit konstant e bën zemrën që vazhdimisht të mbetet e zgjuar dhe e përgatitur për zbatimin e urdhrave të Allahut, më konkretisht: të sharteve të fesë islame.

Të mendosh, është një shans i madh për shfrytëzimin e dekoreve kontemplative dhe racionale.

Gjithashtu, kjo kategori e ibadet që preferon Islami, është largim i njerëzve nga krimi dhe shkelja e ligjit. Sa më shumë që njerëzit mendojnë dhe meditojnë, ata aq më mirë e kuptojnë shkencën juridik, aq më mirë e kuptojnë normat e haramit dhe të ndalesave, që është një imperativ i kërkuar i kohës moderne.

(Autori është Referent i Vakëfit në Myftininë e Tetovës)

TELFIKU-SHKRIRJA E SHUMË MENDIMEVE NË NJË MENDIM

Myslimani nuk e zgjedh telfikun, por ka bindjen se çdo gjë që vjen e vërtetuar nga Pejgamberi (a.s.) është e vërtetë dhe kjo konsiderohet shumëllojshmëri adhurimesh.

Shkruan: Seid Fejzuli (Enkas për HeR)

Telfiku (eklektizmi) si dukuri është paraqitur pas formimit të medh’hebeve islame, edhe atë para shekullit VI hixhri, mirëpo nuk ka qenë e njohur në mesin e myslimanëve. Dijetarët e secilës shkollë u munduan të japin sqarime në lidhje me termin dhe thelbin e telfikut, me ç’rast mendimet e tyre ishin diametralisht të kundërta - disa e lejuan, kurse shumica e tyre e ndaluan.

Çështja e telfikut është një ndër temat e shkencës së usulit, me domethënie juridike, që prek thelbin e adhurimit ndaj Allahut (xh. sh.) dhe thelbin e praktikimeve të ligjeve të tij për të mirën e njerëzve.

Telfik është fjalë arabe, që nënkupton përzgjedhjen e qëndrimeve të caktuara prej medh’hebeve për arsye doktrinare apo interesi. Telfiku shënon bashkimin e mendimeve të shkollave apo të juristëve të ndryshëm në ndërtimin e një dispozite juridike. Kështu, zgjidhjet e reja vendosen në kontekst të ri dhe në tërësi para-

qesin risi në raport me qëndrimin fillestar. Kjo procedurë konsiderohet hap kryesor drejt ixhtihadit të ri.

Kohëve të fundit metoda e telfikut është shfrytëzuar me rastin e transformimit të dispozitave të fikhut në legjislaçionin shtetëror të vendeve të Lindjes së Afërme pas Luftës së Dytë Botërore në fushën e statusit personal, të vakëfit e të ngjashme. Ndër dijetarët e shekullit të kaluar telfikut më së tepërmi iu referuan Muhammed Abduhu dhe Rashid Rida, si një mënyrë për të reformuar ligjin islam.



Ihtilafi, sipas tyre, ishte një pasuri e mirë intelektuale, që duhet të shfrytëzohet për të mirën e bashkësisë.ⁱ

Fjala *telfik* vjen nga rrënja “*l-f-k*” dhe në leksik do të thotë “*të bashkosh dy cepat e një lëkure dhe t’i qepësh*”. Kurse, si term i jurisprudencës dhe metodologjisë islame do të thotë: të bashkosh mendimet e një ose më tepër muxhtehidi në lidhje me një temë.ⁱⁱ Në shariat islam, ndërkaq, telfiku e ka kuptimin e “kryerjes së ndonjë dispozite në atë mënyrë, apo në atë formë, të cilën nuk e lejon asnjëri prej medh’hebeve”. Kjo nënkupton se për një çështje të caktuar të zgjedhësh qëndrimet e dy apo më shumë medh’hebeve, ashtu që të formohet një gjendje e re, e kombinuar prej atyre medh’hebeve, ku asnjëri prej medh’hebeve çështjen e tillë nuk e lejon në atë formë.

Sa për ilustrim, sipas drejtimit hanefit prejka e femrës (përshëndetja me dorë) nuk e prish avdesin. Sipas shafiitëve, dalja e gjakut dhe rrjedhja e tij nga vendi i daljes nuk e prish avdesin. Përballë një situatë të tillë, ku ekziston prejka e dorës së femrës dhe rrjedhja e gjakut dhe përhapja e tij, namazi me një avdes si ky është i pavlefshëm - si të hanefitët, njashu edhe të shafiitët.ⁱⁱⁱ

Në lidhje me çështjen e telfikut dijetarët islamë kanë dy qëndrime:

Shumica e tyre janë të mendimit se telfiku është i ndaluar dhe ky është edhe mendimi më i saktë sipas shumicës së dijetarëve, e në veçanti i dijetarëve bashkë-

kohorë.

Nga ana tjetër, e kemi grupin e dijetarëve që e lejojnë telfikun, por me kushte: 1- që telfiku mos të jetë shkak për lejimin e të ndaluarës (haramin ta bëjë hallall), apo të ndaluarën ta lejojë (hallallin ta bëjë haram); 2- ndjekja e lehtësimeve (ruhsave-çështjeve më të lehta) pa ndonjë nevojë dhe arsyetim legjitim, p.sh: të përgjedh çështje të cilat janë më të lehta të secili medh’heb - kjo është e ndaluar, sepse kjo është shkak për anarki brenda shariatit islam; 3- telfiku mos të jetë shkak për anulimin e ndonjë vendimi sheriatik, apo gjykimi të gjykatës, sepse vendimi dhe gjykimi i tyre ndalon dhe ndërpret çdo kundërthënie mes njerëzve dhe ndalon çdo anarki; 4- telfiku të mos jetë shkak për pezullimin e asaj që ka qenë veprim më parë, duke imituar dikë tjetër, respektivisht nuk lejohet të zbrapsset prej asaj që ka qenë veprim më parë, duke imituar.

Me një fjalë, të gjithë dijetarët që e lejuan telfikun bëjnë të ditur se një telfik i tillë nuk guxon të bëhet në bazë të dëshirave, të pasioneve, të epsheve dhe duke u mbështetur në ato argumente, qëndrime dhe thënie të dobëta që mund të gjenden nëpër medh’hebe.^{iv}

Kur jemi te selektimi i shariatit, duke zgjedhur më të lehtë e medh’hebeve sipas ëndjeve dhe tekave, adhurimi i Allahut (xh. sh.) duke zgjedhur lehtësimet çon në deformimin e fesë dhe shkatërrimin e saj. Kohëve të fundit jemi dëshmi-

tarë të disa pikëpamjeve (medh’hebeve) të reja në qarqe të caktuara në botën islame, ku deformohet Islami nën pretextin e telfikut. Rrjedhimisht, kemi lindjen e medh’hebit të “interesit personal”, të “medh’hebit mbretëror”, të “medh’hebit ‘sipas sunnetit’”, të “medh’hebit ‘egoist’”, të “medh’hebit totalitar”, të “medh’hebit racist” etj. Myslimani nuk e zgjedh *telfikun*, por ka bindjen se çdo gjë që vjen e vërtetuar nga Pejgamberi (a. s.) është e vërtetë dhe kjo konsiderohet shumëllajshëm adhuresh. Nëse fusha e telfikut përqendrohet te çështjet dytësore, që nuk çojnë në haram dhe ka argument për të, atëherë themi se ai mund të zbatohet. Një adhuresh mund të bëhet në disa forma, siç janë disa veprime sunnet të namazit dhe të gjitha këto janë shumëllajshëm adhuresh.^v /Vazhdon/

(Autori ka kryer Fakultetin e Shkencave Islame. Është edukator në Medresenë Isa Beu në Shkup. Jeton në Sllupçan, Kumanovë)

ⁱ Nexhat Ibrahim. *Fjalor enciklopedik islam*, Logos-A, Shkup, 2017, faqe 822.

ⁱⁱ Elton Karaj. *Mehdhebi hanefij, prioritetet dhe sfidat*, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, Shkup, 2017, faqe 44.

ⁱⁱⁱ Taxhedin Bislimi, *Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut*, Shkup, 2018, faqe 142.

^{iv} *Po aty*, faqe 143.

^v Rushit Musallari. *Fikhu praktik*, vëll. 1, Shoqata Kulturore Ardhmëria, Tiranë, 2016, faqe 28.

URIME PËR PRESIDENTIN BAJRAM BEGAJ

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 8 qershor, 2022, i ka dorëzuar Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Shkup letrën e urimit për Presidentin e sapozgjedhur z. Bajram Begaj.

Në urim thuhet:

“I nderuar Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, z. Fatos Reka. Më lejoni që në emrin tim dhe në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV t’ju përcjell

urime të përzemërta për Presidentin e sapozgjedhur të Shqipërisë, z. Bajram Begaj.

Presidentit të ri i dëshirojmë suksese në punën e tij shumë të rëndësishme për vendin dhe rajonin, duke qenë gjithmonë në shërbim të shqiptarëve, sepse vlerësojmë se një Shqipëri e avancuar, me institucione të kompletuara, gjithmonë do të jetë kontribut i stabilitetit dhe zhvillimit në rajon. Me respekt, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu” – thuhet në njoftimin e BFI.



AMBASADORI FLORIM QEHAJA NË BFI



Sot patëm nderin të presim Ambasadorin e posaçmëruar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup, z. Florim Qehaja, i cili shoqërohej nga bashkëpunëtorët në Ambasadë, z. Prindon Sadriu, ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef.

Fetahu, Kryetar i BFI të RMV, në faqen e vet në Facebook me 9 qershor, 2022.

Fillimisht, i uruam detyrën e re, duke i dëshiruar shëndet dhe suksese në detyrë dhe shprehëm gatishmërinë për bashkëpunim reciprok në sfera të ndryshme.

Ambasadorin e njoftuam me BFI dhe organizimin e jetës fetare në RMV, duke shprehur gatishmërinë për një afërsi vëllezërore dhe bashkëpunim të mirëfilltë.

I falënderuam për vizitën, ndoshta ndër të parat, dhe premtuam se së shpejti do ta vizitojmë edhe në rezidencën e tij.

Ambasadori Qehaja shprehu falënderimet e sinqerta për pritjen vëllezërore, që paraqet një takim shumë të rëndësishëm në momentet e para të mandatit të tij si ambasador, duke thënë se është i gatshëm të jetë në shërbim të bashkëpunimit vëllezëror në sfera të ndryshme të aktiviteteve tona.

Në pritje ishin mr. Mustafa Dauti dhe dr. Abdylqerim Iseni.

Falënderojmë Ambasadorin Qehaja dhe shoqëruesin e tij për vizitën, ndërsa Ambasadorit i uruam suksese në angazhimin e ri. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin publik të Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

URIME PËR AMBASADORIN E RI TË KOSOVËS

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka uruar Ambasadorin e ri të Republikës së Kosovës në vendin tonë, Shkëlqesinë e Tij z. Florian Qehaja, duke i dëshiruar mirëseardhje dhe suksese në misionin diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, thuhet në njoftimin e BFI.

Në letrën e urimit shkruan:

“Shkëlqesia Juaj z. Florian Qehaja,

Kam kënaqësinë që në emrin tim dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV përzemërsisht t’ju dëshiroj mirëseardhje në vendin tonë dhe shumë suksese në misionin tuaj diplomatik si Përfaqësues i Republikës së Kosovës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Urojmë që edhe në të ardhmen marrëdhëniet bilaterale mes dy vendeve tona mike me sukses të vazhdojnë rrugëtimin e përbashkët euro-atlantik, për të mirën e përbashkët të qytetarëve në të dy anët e kufirit.

Me respekt, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu”, thuhet në njoftimin e BFI. (8.06.2022)

BFI NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE NË KATAR

Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, prof. dr. Shaban Sulejmani, në datat 23-24 maj, 2022, me autorizim të BFI-së, mori pjesë në Konferencën ndërkombëtare islame në Doha të Katarit, thuhet në njoftimin e BFI.

Konferenca i zhvilloi punimet me temë "Dialogu mes besimeve", me përfaqësues nga e gjithë bota islame. Pjesëmarrësit ishin të angazhuar që të japin kontributin e tyre rreth bazave të Islamit, rreth bashkëpunimit dhe zbulimit të vlerave të njohjes dhe të afrimit të njerëzve pa dallim feje e race etj.

Prof. dr. Shaban Sulejmani, përveç pjesëmarrjes në këtë konferencë, shfrytëzoi rastin që të takohet me personalitete të njohura, me reputacion ndërkombëtar, në sferën e shpjegimit të Islamit, si: prof. dr. Ali Kardagi, Sekretar i Përgjithshëm i Ligës Botërore të Ulemave Myslimanë; prof. dr. Muhamed Duvenji, Zëvendëskancelar i Universitetit të Az'harit (Kajro) dhe prof. dr. Ibrahim Khalife, një nga fituesit e Çmimit të Konferencës për dialog ndërfetar, thuhet në njoftimin e BFI.

Konferenca e 14-të ndërkombëtare për dialog ndërfetar "Digid" mbledhi në



Doha/Katar përfaqësues të komuniteteve të ndryshme fetare: hebrej, të krishterë, myslimanë nga tërë bota dhe në të u diskutua më temë "Shkaqet e gjuhës së ur-

rejtes në fe dhe luftimi i ekstremizmit", ka shkruar teologu i njohur islam nga Shkupi Benjamin Idriz në faqen e vet në Facebook më 25 maj, 2022.

MYFTINIA E SHKUPIT SHËNON REZULTATE



Më 2 qershor, 2022, me ftesë të Myftinisë së BFI-Shkup dhe të Myftiut dr. Qenan ef. Ismaili, i shoqëruar nga Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, mora pjesë në Mbledhjen e rregullt të Myftinisë së Shkupit, ku u analizuan aktivitetet e muajit të Ramazanit, rrjedha e organi-

zimit të Haxhit dhe e prerjes së kurbanëve, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Prezenca ime ishte më tepër për të shprehur mirënjohjet tona për aktivitetet e realizuara gjatë muajit të bekuar të Ra-

mazanit, si dhe rezultatet e larta në grumbullimin e Zeqatit dhe të Saddekatul-Fitrit në Fondin e Medresesë, të FSHI dhe të institucioneve të tjera të BFI, ka thënë ai.

Njëherësh, thuhet më tej në njoftimin publik të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, përshëndeta edhe numrin e madh të kësaj Myftinie të haxhinjve të regjistruar, me mbi 280 kandidatë. Shpreha gatishmërinë e BFI në përkrahjen maksimale në mirëvajtjen e punëve të kësaj Myftinie dhe të Myftinive të tjera në vend. Dr. Qenan ef. Ismaili në emër të Myftinisë shprehu falënderimet e përzemërta për prezencën dhe përkrahjen tonë Myftinisë së Shkupit. Zoti i plotfuqishëm i shpërbleftë me shpërblimet e Tij të pakufishme, përfundon njoftimi i Kryetarit të BFI të RMV.

BFI: PRITJE PËR AMBASADORIN SAUDIT

Më 13 qershor, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset Shkëlqesinë e Tij, Ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Faisal bin Gazi Hifzi, thuhet në njoftimin e BFI.

Bashkësia Fetare Islame e RMV delegacionit nga Arabia Saudite i bëri një pritje të nivelit të lartë dhe vëllazëror.

Gjatë takimit u bisedua për shumë çështje me rëndësi për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me Mbretërinë e Arabisë Saudite, si dhe për zhvillimin e Bashkësisë Fetare Islame në përputhje me rrethanat dhe kohën.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi Ambasadorin Faisal bin Gazi Hifzi për këtë vizitë mjaft domethënëse për BFI dhe popullatën myslimanë të këtij nënqiell.

Nga ana e tij, Ambasadori Saudit falënderoi Reis'ul-Ulemanë për pritjen e ngrohtë dhe vëllazërore, si dhe i dëshiroi suksese në punë në udhëheq-



jen e institucionit fetar islam. Ai po ashtu foli edhe për intensifikimin e marrëdhënieve me institucionet e Arabisë Saudite në sfera të ndryshme, ku tanimë BFI shihet si një partner serioz dhe i mbështetshëm, me të cilin mund të realizohen projekte të ndryshme. Gjithashtu, u bisedua edhe për organizimin sa më të mirë të Haxhit për këtë vit dhe ardhjen në vizitë të Ministrit për Çështje Fetare të Mbretërisë së

Arabisë Saudite në vendin tonë.

Gjatë takimit Reis'ul-Ulemanë e shoqëronin: h. Ismet ef. Ademi, Udhëheqës i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe; dr. Abdylqerim ef. Iseni, Shef i Kabinetit; Rexhep ef. Ziberi, Kryetar i Shoqatës së Ulemave; Fadil ef. Ramadani, Kryetar i OH 'Hilal'; dhe Musanif ef. Rufati, Udhëheqës i Sektorit për Kulturë në Rijasetin e BFI-së, thuhet në njoftimin e BFI.

SOLEMNIZOHET KONTRATA E DHURIMIT TË HURMAVE



Fondacioni i Mbretit Selman bin Abdulaziz Al-Saud solemnizoi më 13 qershor, 2022, në Rijaset, kontratën e dhurimit të 25 tonelatave hurma për Bashkësinë Fetare Islame të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Dhurata është bërë në kuadër të bashkëpunimit të Bashkësisë Fetare Islame dhe Ambasadës së Mbretërisë së Arabisë Saudite. Hurmat janë shpërndarë nëpër

Myftinitë e vendit dhe nëpër organizata të ndryshme që veprojnë në vendin tonë.

Solemnizimi i kontratës u realizua në prezencë të Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, dhe Shkëlqesisë së Tij, Ambasadorit të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Faisal bin Gazi Hifzi, i cili shoqërohej nga z. Hamad Al-Sairi, Përgjegjës për Çështje Fetare.

Përfaqësuesit e Fondacionit Humanitar të Mbretit Selman bin Abdulaziz Al-Saud po ashtu morën pjesë në këtë aktivitet, edhe atë: z. Abdullaj es-Sejfi, i shoqëruar nga z. Usame el-Kahtani dhe z. Ahmed el-Jahja nga Ministria e Financave e Mbretërisë së Arabisë Saudite, të cilët së bashku me Fadil ef. Ramadanin, Kryetarin e Organizatës Humanitare Hilal, e cila funksionon në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, edhe sot realizuan shpërndarjen e organizuar të dhuratave dhe të ndihmave. Në emër të të gjithë myslimanëve të vendit, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi Ambasadorin Faisal bin Gazi Hifzi dhe përfaqësuesit e Fondacionit Humanitar të Mbretit Selman bin Abdulaziz Al-Saud për këtë dhuratë dhe për këtë vizitë vëllazërore, të cilat e forcojnë edhe më tepër bashkëpunimin e ndërsjellë mes BFI dhe institucioneve të Mbretërisë së Arabisë Saudite, thuhet në njoftimin e BFI.

BEZISTANI DHE KAPAN-HANI, DY VAKËFE TË KTHYERA



Më 26 maj, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, me bashkëpunëtorë, nga Drejtoria i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, nga Drejtoria i Sektorit për Arsim dhe Shkencë prof. Jusuf ef. Zimeri, nga Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim ef. Iseni dhe profesorë e profesoresha të Medresesë Isa Beu, pas përfundimit të solemnitetit të përcjelljes së maturanteve të Paraleles së Vajzave – Shkup, i bënë një vizitë të shkurtër Bezistanit dhe Kapan-Hanit në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, tanimë prona-pasuri të denacionalizuara në vitin 2021, të cilat i takojnë Bashkësisë Fetare Islame, përkatësisht Myftinisë së

BFI-Shkup, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këto objekte Reis'ul-Ulema u njoftua me detajisht për këto prona dhe planifikimet për shfrytëzimin e tyre në të ardhmen, për të mirën e BFI dhe të Islamit në vendin tonë.

Delegacioni bëri një ndejë të këndshme në Kapan-Han, ku kishin mundësi të festonin dhe të bisedonin për procedurën që u bë në lidhje me kthimin e këtyre objekteve tashmë prona të BFI-së, si dhe për pronat tjera, të cilat janë në procedurë e sipër dhe të cilat së shpejti, me lejen e Allahut Fuqipotë, pritet t'i kthehen pronarit legjitim, BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

ELHAM MURSELI, HAFËZ KURRA NGA SHKUPI

Myftiu i Myftinisë së KMSH-Librazhd, Ardit Hoxhllaku, në faqen e vet në Facebook ka njoftuar se më 12 qershor, 2022, janë diplomuar më shumë hafëzllarë në Shkollën e Hafëzave Kurra në Stamboll, Republika e Turqisë. Njëri nga të diplomuarit është dhe Elham Murseli nga Shkupi, ka thënë ai dhe ka shtuar: 'Falënderimi i takon Zotit. Allahu ua ndriçoftë rrugën dhe zemrat këtyre bilbilave të Kuranit të shenjtë.'

Hoxhë Ardit Hoxhllaku aty ka dhënë edhe këtë shënim: Fjala hafëz (hafiz) vjen nga arabishtja, që është një mbiemër dhe rrjedh nga rrënja hifz, që do të thotë "të mbrosh, të mësoh përmendsh". Sipas haditheve, njerëzit që dinë të lexojnë në shtatë recitime dhe dhjetë transmetime të dhëna nga mësuesi ynë, Pejgamberi (a. s.), quhen hafëzë kurra. (13.06.2022)

MEDRESEJA ISA BEU PËRCOLLI MATURANTËT



Shkup: Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu përgëzoi nxënëset për suksesin e arritur dhe profesoreshat për mundin që kanë dhënë në edukimin e gjeneratave të reja.

Më 24 maj, 2022, në mënyrë solemne u bë përcjellja e maturanteve të Medresesë Isa Beu - Paralelja e Vajzave në Gostivar, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Ishte një ambient imponant. Prezencë e Myftiut të Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, e Drejtorit prof. Ibrahim ef. Idrizi, e Sekretarit z. Lutfi Nexhipi, e Administratores së Paraleles së Gostivarit prof. Myzeqete Hebibi, e kujdestareve prof. Gjylmsere Jakupi dhe mr. Semire Fetai Halimi, e Administratoreve të Tetovës dhe të Shkupit, e referentëve, prindërve dhe mysafirëve. Të gjithë uruam maturën e tyre dhe u dëshiroam rrugëtim të mbarë. Zoti i bekoftë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

NJËMBËDHJETË GJENERATA NG GOSTIVARI

Në mënyrë solemne u bë përcjellja e gjeneratës XI në hapësirat e Medresesë Isa Beu në Paralelen e Vajzave Gostivar, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Në këtë manifestim të pranishëm ishin: Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Myftiu i Myftinisë së Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli me operativën, Drejtoria i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, Sekretari i Medresesë mr. Lutfi Nexhipi, Administratores e Paraleleve të Medresesë, profesorë dhe profesoresha, prindër, nxënës dhe shumë dashamirë të kësaj vatre edukativo-arsimore fetare.

Manifestimi u përcoll me një program të begatë nga Kori i Medresesë Isa Beu, Paralelja e Shtrirë në Gostivar, me disa ajete kuranore dhe ilahi. Me fjalimet e tyre u paraqitën Administratorja e Paraleles së Shtrirë Gostivar prof. Myzeqete Hebibi, Drejtoria i Medresesë prof. Ibrahim ef. Idrizi, Myftiu i Myftinisë së Gostivarit h. Sabahudin Zendeli, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili përgëzoi nxënëset për suksesin e tyre dhe profesoreshat e Medresesë për mundin e tyre që kanë dhënë në edukimin e gjeneratave të reja.

Të gjitha maturanteve iu shpërndanë mirënjohje. Edhe një përjetim i bukur në ambientet e Medresesë nga nxënëset, familjarët, stafi arsimor dhe gjithë të pranishmit. Medreseja vazhdon rrugëtimin e saj drejt shtigjeve dhe sukseseve të reja. Urime maturanteve! – thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

PËRGËZIME PËR PARALELEN NË TETOVË

Në mënyrë solemne u bë përcjellja e gjeneratës XV në Paralelen e Medresesë në Tetovë, ka shkruar më 25 maj, 2022, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Në këtë manifestim të pranishëm ishin: Myftiu i Myftinisë së Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Drejtoria i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, Drejtoria i Sektorit Fetar-Arsimor Jusuf ef. Zimeri, Sekretari i Medresesë mr. Lutfi Nexhipi,

Administratores e Paraleleve të Medresesë, profesorë dhe profesoresha, prindër, nxënës dhe shumë dashamirë të kësaj vatre edukativo-arsimore fetare.

Programi filloi me ashërë nga prof. Nermin Emiri, ndërsa më pas me fjalimet e tyre u paraqitën Administratorja e Paraleles së Shtrirë Tetovë prof. Barije Shabani, Drejtoria i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, Myftiu i Myftinisë së Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu etj.

Në mënyrë solemne u bë përcjellja e gjeneratës XV, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu. Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu përgëzoi nxënëset për suksesin e arritur dhe profesoreshat e Medresesë për mundin që kanë dhënë në edukimin e gjeneratave të reja. Të gjitha maturantet morën mirënjohjet. Ishte ky edhe një përjetim i bukur në ambientet e Medresesë nga nxënëset, familjarët, stafi arsimor dhe gjithë të pranishmit. Vazhdojmë rrugëtimin tonë, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

SHTIPI ME GJENERATËN XIV TË DJEMVE

Në mënyrë solemne u bë përcjellja e gjeneratës XIV në Shtip, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu (25 maj, 2022).

Në këtë manifestim të pranishëm ishin: Sekretari i Medresesë mr. Lutfi Nexhipi, Myftiu i Myftinisë së Shtipit h. Nasir ef. Rexhepi, Përgjegjësi për Çështje



Një ndejë e këndshme në Kapan-Han (Shkup), tashmë prona e BFI-së, pas përfundimit të solemnitetit të përcjelljes së maturanteve të Paraleles së Vajzave - Shkup, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 26 maj, 2022.

Fetare pranë Ambasadës së Turqisë në Shkup z. Mustafa Mesten, Koordinator i Shkollës Mearif, profesorë, prindër, nxënës dhe shumë dashamirë të kësaj vatre edukativo-arsimore fetare.

Me fjalë përshëndetëse u paraqitën Myftiu i mëparshëm i Shtipit h. Isa ef. Ismaili, ndërsa në emër të Drejtorit të Medresesë prof. Ibrahim Idrizi të pranishmit i përshëndeti Sekretari mr. Lutfi Nexhipi. Fjalë përshëndetëse pati edhe Përgjegjësi për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë në Shkup z. Mustafa Mesten.

Nxënësit e pasuruan programin me ilahi. Një përjetim i bukur në ambientet e Medresesë nga nxënësit, familjarët, stafi arsimor dhe gjithë të pranishmit. Medreseja vazhdon rrugëtimin e saj, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

GJENERATA XIII NË SHKUP, ME SHUMË SUKSESE

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 26 maj, 2022, ka njoftuar: SHMI "Medreseja Isa Beu" përcolli gjeneratën XIII të Paraleles së Vajzave në Shkup.

Në manifestim ishin: Myftiu i Myftinisë së Shkupit dr. Qenan Ismaili, Drejtori i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, Drejtori i Sektorit Fetar-Arsimor prof. Jusuf Zimeri, Sekretari i Medresesë mr. Lutfi Nexhipi, Administratoret e Paraleleve të Medresesë, profesorë dhe profesoresha, prindër, nxënës dhe shumë dashamirë të kësaj vatre edukativo-arsimore fetare.

Programi filloi me ashere. Më pas me

fjalimet e tyre u paraqitën Administratorja e Paraleles së Shtrirë Shkup mr. Nurtene Saqipi, Drejtori i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, Myftiu i Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu etj.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu, përgëzoi nxënësit për suksesin e arritur dhe profesoreshat për mundin që kanë dhënë në edukimin e gjeneratave të reja.

Të gjitha maturanëve iu shpërndanë mirënjohje. Në shenjë respekti u ndanë dhurata për Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për Myftiun e Shkupit, për Drejtorin e Medresesë, për Drejtorin e Sektorit Fetar-Arsimor, për Sekretarin e Medresesë dhe për dy Administratoret e Paraleleve të Shtrira Tetovë dhe Gostivar. Urime maturanëve, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

NJË MBRËMJE E MREKULLUESHME E GJENERATËS SË 35-TË

Në mënyrë solemne u bë përcjellja e gjeneratës XXXV. Kjo tregon se çdo shtëpi e myslimanit po pasurohet me medresantë. Në këtë manifestim të pranishëm ishin: Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Drejtori i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, Zv/Drejtori Zuhejr Rexhepi, profesorë dhe edukatorë, thuhet në njoftimin e BFI (27 maj, 2022).

Programi filloi me ashere, ndërsa më pas me fjalimet e tyre u paraqitën Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili për-

gëzoi nxënësit për suksesin e tyre dhe Këshillin edukativo-arsimor të Medresesë për mundin e dhënë në edukimin e gjeneratave të reja. "Gjatë karrierës sime si nxënës fetar, kënaqësi më të madhe e kam periudhën kur kam qenë në Medrese. Uroj maturanët, me lutje tek Allahu që t'ju prijë e mbara", tha mes tjerash Kryetari i BFI të RMV.

Drejtori i Medresesë Isa Beu, prof. Ibrahim ef. Idrizi, pasi përshëndeti të pranishmit u shpreh i bindur se kjo gjeneratë ka ndërtuar një bazament të fuqishëm në përvetësimin e njohurive të përgjithshme fetare dhe në të njëjtën kohë paraqet, tha, një gur të fortë në kalanë e ndërtuar të dijes, në kultivimin e vlerave të mirëfillta të kulturës islame në vendin tonë. Dëshiroj që ju të jeni një brez intelektual e ideor që do t'i prini ndërtimit të jetës islame, si formë e vetme shoqërore e institucionale, kulturore dhe ekonomike. Në fund: urime për të gjithë. Ju dëshiroj shëndet dhe - drita e të Madhit Allah t'ju shndrit dhe ajo të shpërndahet nëpërmjet rrezeve të dijes dhe të edukatës në familjet tuaja, te shoqëria dhe populli ynë. Zoti ju bekoftë në jetësimin e fjalës së Allahut Fuqiplotë, tha Drejtori i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi.

Edhe një përjetim i bukur në ambientet e Medresesë nga nxënësit, stafi arsimor dhe të gjithë të pranishmit. Medreseja vazhdon rrugëtimin e saj drejt shtigjeve dhe sukseseve të reja. Urime maturanëve! - ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

EKSKURSION TREDITOR NË SHQIPËRI



Në datat 10-12 qershor, 2022, nxënësit e Medresesë Isa Beu ishin në një ekskursion treditor në Shqipëri, thuhet në njoftimin e SHMI, Shkup.

Nxënësit e shkollës së mesme islame (SHMI) udhëhiqeshin nga profesorët dr. Islam Islami, prof. Jasir Osmani, prof. Mervan Muhamedi dhe prof. Avni Neziri.

Të premten, nxënësit bashkë me profesorët e falën namazin e xhumasë në xhaminë me katër minare "Riza Bajrami" në Durrës. Ishim të nderuar nga imami i

Xhamisë, Kadim Rufati, i cili kërkoi nga profesori dr. Islam Islami që në emër të Medresesë të përshëndet xhematin e kësaj xhamie, ndërsa nxënësi hfz. Asip Emrullai me zërin e tij të bukur lexoi disa ajete nga Kurani famëlartë. Në mbremje vizitua Xhaminë Qendrore të Durrësit, ku falën namazin e jacies, thuhet në njoftim.

Më 11 qershor është vizituar qyteti i Vlorës, përkatësisht Shtëpia-muze e Ismail Qemalit, ku është ngritur flamuri

shqiptar.

Ditën tjetër, më 12 qershor, nxënësit dhe profesorët vizituan Muzeun e Skënderbeut në Krujë, ku morën njoftime të hollësishme nga historia e Muzeut dhe e Skënderbeut. Në kthim janë vizituar edhe qyteti i Prizrenit, monumentet historike të tij dhe Xhamia e Sinan Pashës.

Të gjithë nxënësit ngelën të kënaqur nga ky ekskursion treditor, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu. (13.06.2022)

MEDRESANTËT MË TË MIRË PRITEN NË RIJASET

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti në Rijaset nxënësit më të mirë të gjeneratës të Medresesë Isa Beu: Amine Ibrahim (Tetovë), Ezana Osmani (Shkup), Enisa Hebibi (Gostivar)

dhe Armen Akiti (Shtip), thuhet në njoftimin e BFI.

Medreseja Isa Beu gjithmonë ka luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e nivelit edukativo-arsimor e fetar të myslimanëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në rajonin më të gjerë, duke dhënë kontribut të çmueshëm në përgatitjen e kuadrove që profesionalisht angazhohen në prezantimin dhe kultivimin e Islamit burimor në këto troje.

Në përfundim të vitit shkollor Reis'ul-Ulemaja priti dhe dekoroi nxënësit më të mirë të vitit, të cilët shoqëroheshin nga Drejtori i Përgjithshëm i Medresesë, prof. Ibrahim ef. Idrizi, dhe Sekretari i



Medresesë, mr. Lutfi Nexhipi.

Në këtë takim mjaft emotiv, Kryetari i BFI të RMV të gjithëve u ndau mirënjohje dhe nga një libër prej botimeve më të reja të BFI. Ai e falënderoi Drejtorin për organizimin e këtij takimi, për sukseset dhe rezultatet e arritura në Medrese, si dhe u dëshiroi nxënësve shëndet dhe

një ardhmëri të begatë e të ndritur, në të mirë të Islamit dhe të shoqërisë në përgjithësi, thuhet në njoftimin e BFI.

Një takim respekti ndaj nxënësve të gjeneratave të SHMI "Medreseja Isa Beu", ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (17/18.06.2022)

NXËNËS E PROFESORË NGA ANKARAJA VIZITOJNË MEDRESENË

Në kuadër të projektit Erasmus +, SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup mirëpriti më 27 maj, 2022, një grup profesorësh dhe nxënësish nga shkolla e mesme "Özkent Akbilet Fen Lisesi Etimesgut", drejtimi matematikë-informatikë, nga Ankaraja (Republika e Turqisë), thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi për diturinë islame mes nxënësve të dy shkollave, mbi projektin "Shkathtësitë në teknologjinë informative dhe preventivat për t'u mbrojtur nga sulmet kibernetike".

Gjatë qëndrimit të tyre, përveç se për projektin, ata vizituan edhe Medresenë dhe internatin dhe u njohën rreth fesë islame në Maqedoni të Veriut, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.



MINBERI AKSA DERNEĞI NË MEDRESE

Drejtori i Medresesë Isa Beu, prof. Ibrahim Idrizi, më 7 qershor, 2022, priti në Shkup në një vizitë mr. Eduart Thartorin, përgjegjës për Ballkanin dhe Evropën i Minberi Aksa Derneği dhe Ugur Dogançay, përgjegjës për botën turke i Minberi Aksa Derneği (Tiranë-Stamboll), thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Drejtori i Medresesë i njoftoi me zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor, me sfi-dat me të cilat po ballafaqohet Medreseja, si dhe me synimet e saj në të ardhmen. Ai u shpreh falënderues për vizitën.

Po ashtu, edhe nga ana e mysafirëve u njohën me funksionin dhe qëllimin e shoqatës Minberi Aksa.

Të dyja palët u ndanë me shpresë që në të ardhmen të ketë bashkëpunim në sferën e arsimit dhe të edukimit, në organizimin e konferencave dhe të seminareve të ndryshme etj., thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Të njëjtën ditë, në faqen e vet në Facebook, prof. Ibrahim Idrizi kishte shkruar: “Jemi për bashkëpunim me të gjithë vepërmirët dhe arsimdashësit.”



UMAD NË BFI



Më 7 qershor, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti delegacionin e UMAD - Shoqatës ndërkombëtare të ulemave myslimanë nga Turqia, në krye me prof. dr. Abdulvehab Ekinxhi, si dhe nënkryetarin prof. dr. Mustafa Karatash, të cilët qëndrojnë në një vizitë zyrtare në RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Pika të vizitës së tyre dyditore, përveç Rijasetit, janë edhe SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, FSHI, Myftinitë Shkup, Tetovë dhe Gostivar.

Së pari, Kryetari i BFI e informoi delegacionin me ‘letërnjoftimin’ e BFI të RMV, me institucionet e saj, si dhe me planet për të ardhmen.

Kryetari i Shoqatës UMAD falënde-

roi për pritjen vëllazërore dhe shprehu synimet e vizitës së tyre. U bisedua për një bashkëpunim të mirëfilltë mes ulemave të Turqisë dhe të BFI të RMV.

Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, nga ana e tij, i shprehu falënderim prof. dr. Numan Aruç-it për koordinimin e kësaj vizite të rëndësishme. Ishte kënaqësi, thuhet në njoftimin e BFI.

MIRËSIA E VEPRAVE TË MIRA

Dhe, vërtet, Allahu ua jep dynjanë atyre që i do dhe atyre që nuk i do. Por, besimin (el-Iman) nuk ia jep askujt, përveç atyre që i do.

Nga Ibrahim Idrizi

Ibn Abasi (r. a.) thotë: “Vërtet, veprat e mira sjellin nur (dritë) në zemër, hijeshi-bukuri në fytyrë, fuqi dhe mundësi në trup, furnizim – risk të gjerë dhe dashuri në zemrat e krijesave.

Dhe, vërtet veprat e këqija sjellin errësirë në zemër, shëmti në fytyrë, dobësi në trup dhe urrejtje në zemrat e krijesave.”

Allahu i plotëfuqishëm asnjë krijese nuk i ka dhënë dhe dhuruar ndonjë të mirë, apo ndonjë begati, e që të mos e shpërblejë shumëfish dhe këto mirësi dhe begati nuk janë karakteristike vetëm e botës tjetër (ahiretit), por frytet e punëve të mira i korr dhe i fiton edhe në jetën e kësaj bote. Pra, i jep bereqet dhe jetë të mirë, rehati, krenari dhe dinjitet, karakter-moral dhe mirëkuptim me dashuri ndërmjet familjarëve dhe të afërmëve, miqësisë dhe shoqërisë në përgjithësi...

Përcillet nga Abdullah ibn Mes’udi (r. a.) se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: “Me të vërtetë, Allahu në mesin tuaj e ka shpër-



ndarë ahlakun-moralin, njëjtë ashtu siç e ka shpërndarë dhe e ka caktuar riskun-furnizimin në mesin tuaj.

Dhe, vërtet, Allahu ua jep dynjanë atyre që i do dhe atyre që nuk i do. Por, besimin (el-Iman) nuk ia jep askujt, përveç atyre që i do. Dhe, kush bëhet ko-

pprac-dorështërnguar në mall e pasuri dhe nuk e ndanë, kush i frikësohet armikut dhe nuk lufton kundër tij dhe kush nuk i frikësohet luftës natën, le t’i shprehë-le t’i thotë këto fjalë: Subhanallah, Vel-ham-dulillah, Ve la ilahe ila-llah, Vall-llahu ekber. (22.06.2022)

PROFESORË E STUDENTË NGA SOFJA VIZITOJNË BFI-në

Më 10 qershor, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset delegacionin nga Instituti Islamik i Sofjes, në krye me rektorin prof. Kadri Muhamed dhe prorektorët Ajdin Omerov dhe Abdullah Trabzon, bashkë me stafin e Këshillit mësimor-shkencor dhe disa stu-

dentë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në takim Kryetari i BFI i informoi mysafirët me rrjedhën e punëve në BFI, me organizimin e jetës fetare në vend, si dhe me funksionimin e institucioneve edukativo-arsimore.

Vizita e mysafirëve nga Sofja ishte me qëllim të njoftimit me institucionet e ndry-

shme në RMV. Në takim u bisedua edhe për bashkëpunim të ndërsjellë të institucioneve tona, thuhet në njoftimin e BFI.

Sot pata nderin që të pres delegacionin e Institutit Islamik të Sofjes. Falënderuam për vizitën, ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook të njëjtën ditë.



TAKIME NË ITSHKSH

Më 26 maj, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili dhe nga Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim ef. Iseni vizitoi Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, ku u mirëpritën nga drejtori dr. Skender Asani dhe stafi i ITSHKSH, thuhet në njoftimin e BFI.

Kënaqësia e këtij takimi ishte prania e profesoreshës së teologjisë Ines Murzaku nga Universiteti Seton Hill (Seton Hall University) i Nju-Xhersit (SHBA), e cila qëndron në vendin tonë si pjesë e projektit "US Fulbright Program" të SHBA-ve.

ITSHKSH është një institucion shkencor që është mirë i pozicionuar mes institucioneve të tjera dhe njihet për organizimin e një sërë manifestimeve të mëdha vendore dhe ndërkombëtare, të cilat për fokus të interesimit kanë ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve, thuhet në njoftimin e BFI.

Qëllimi i vizitës ishte shprehja e ngushtëllimit në emër të BFI të RMV dhe në emrin tim drejtorit dr. Skender Asani, me rastin e ndërrimit jetë të nënës së tij. I dëshirojam durim të paluhatshtëm, ndërsa të ndjerës - xhenetin e amshueshëm. Drejtori Asani shprehu falënderime të veçanta për këtë përkrahje në momentet e dhimbjes familjare, ka shkruar të njëjtën ditë në faqen e vet në Facebook Reis'ul-



Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. U bisedua për shumë çështje në sferën e bashkëpunimit shkencor, kulturor dhe historik, ka thënë ai më tej.

Drejtori i ITSHKSH, dr. Skender Asani, ndërkaq, ka deklaruar: "Sot kisha kënaqësi që në Institut të pres kreun e Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili erdhi për të më ngushëlluar për humbjen e nënës. Kjo vizitë u bë e frytshme edhe për shkak se përkoji me praninë e profesoreshës së teo-

logjisë Ines Murzaku nga Seton Hall University i Nju-Xhersit (New Jersey), e cila po qëndron në vendin tonë me Programin Fulbright të shtetit amerikan.

Patëm mundësi që bashkërisht të diskutojmë për dialogun ndërfaqet dhe të theksojmë rolin e mirë që po luan Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në promovimin e dashurisë, të paqes, të respektit dhe të tolerancës ndërfaqetare si vlerë autoktone shqiptare, që po merr trajtë institucionale në Shkup. Ju faleminderit të gjithëve."

PROF. INES MURZAKU VIZITOI BFI-në

Më 7 qershor, 2022, në vizitë zyrtare në BFI ishte mysafirja prof. dr. Ines Murzaku nga Universiteti Seton Hill (Seton Hall University) në Nju-Xhersit, SHBA, e cila qëndron në vendin tonë me programin "US Fulbright Program" të SHBA-ve. Është eksperte e studimit të religjioneve komparative dhe kultivon dialogun ndërfaqet, thuhet në njoftimin e BFI.

Me mysafiren nga SHBA Reis'ul-Ulemaja bisedoi për kultivimin e vlerave fetare, për paqen në botë, si dhe për shembullin e multikonfesionalitetit në RMV.

Në këtë takim Kryetarin e BFI e shoqëronte Shefi i Kabinetit, dr. Abdylqerim Iseni.

Prof. Ines Murzaku është shqiptare që jeton dhe vepron në SHBA.



NË MBLEDHJEN E FSHI



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 16 qershor, 2022, përcolli me kujdes mbledhjen e Fakultetit të Shkencave Islame, i shoqëruar nga Drejtori për Çështje Fetare në Rijasetin e BFI të RMV, prof. Jusuf ef. Zimeri dhe Shefi i Kabinetit, dr. Abdylqerim Iseni, thuhet në njoftimin e BFI. Mbledhjen e udhëhoqi Dekani i FSHI, prof. dr. Shaban ef. Su-

lejmani, dhe në të u diskutuan shumë çështje me rëndësi për rrjedhën e punëve në këtë institucion me peshë.

Porosia e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në këtë mbledhje ishte që ky institucion të vazhdojë zhvillimin e vet konform vlerave shkencore, me qëllim të ngritjes së nivelit mësimor e shkencor në këtë vatrë të rëndësishme arsimore në vendin tonë, thuhet në njoftimin e BFI.

FURNIZIMI (RISKU)

Aliu (r. a.) ka thënë se furnizimi (risku) është dy llojesh: njëri që të kërkon ty dhe tjetri, të cilin ti e kërkon.

Ai lloj që të kërkon ty do të vijë edhe krahas dobësisë tënde që ke.

Ndërkaq, ai lloj që ti e kërkon nuk do të vijë, përpos me mund dhe me përpjekje.

Lloji i parë është mirësi nga Allahu, ndërsa lloji i dytë - drejtësi nga ana e Tij.

Qoftë i lartësuar Allahu!

Sa bamirës dhe i drejtë që është!

*Nga arabishtja:
Naser Ramadani*

SHËNOHET 30-VJETORI I MARRËDHËNIEVE ME KROACINË



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 16 qershor, 2022, mori pjesë në shënimin e 30-vjetorit të marrëdhënive diplomatike Shkup-Zagreb, thuhet në njoftimin e BFI.

Ai iu përgjigj ftesës së Ambasadores së Kroacisë në Shkup, znj. Jines Tiganj.

Në manifestimin e organizuar me këtë rast Kryetarin e BFI e shoqëronin mr. Mustafa Dauti dhe dr. Abdylqerim Iseni.

Fjalë rasti mbajtën dy ministrat e Punëve të Jashtme: z. Bujar Osmani dhe z. Gordan Radman, të cilët folën mbi marrëdhëniet e mira mes dy vendeve, si dhe për përkrahjen e ndërsjellë në nivel ndër-

kombëtar.

Enkas për këtë manifestim prezent ishte edhe Ambasadori i RMV në Kroaci, z. Milaim Fetai.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja iu falënderua Ambasadores kroate në RMV për ftesën e bërë, thuhet në njoftimin e BFI.

DELEGACIONI I BFI-së NË UNT



Më 20 qershor, 2022, vizituam universitetin "Nënë Tereza" në Shkup (UNT), ku na priti Rektori, prof. dr. Izet Zeqiri me bashkëpunëtorë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Në këtë takim udhëhoqa delegacionin në përbërje të prof. dr. Shaban Sulejmanit, Dekan i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup; prof. Ibrahim Idrizit, Drejtor i Për-

gjithshëm i SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup; dhe prof. Jusuf Zimerit, Përgjegjës i Sektorit për Arsim në BFI.

Qëllimi i vizitës ishte të urojmë zgjedhjen e prof. dr. Izet Zeqirit në postin e Rektorit të universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, duke i dëshiruar shëndet dhe suksese të reja në udhëheqjen e këtij institucioni të lartë.

Me Rektorin, pasi që na shprehu mirë-

seardhje dhe falënderim për urimin, vazhduam bisedën për shumë çështje rreth arsimit dhe vlerave të tjera në edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja. U bisedua edhe për akreditimin e medresesë "Isa Beu" - Shkup.

U morëm vesh për një bashkëpunim të mirëfilltë në sfera të ndryshme, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

REISI NË 20-VJETORIN E BDI-së



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në jubileun e 20-vjetorit të themelimit të BDI-së, thuhet në njoftimin e BFI.

Me këtë rast, Kryetari i BFI-së i përcolli urime të sinqerta Kryetarit të BDI-

së, z. Ali Ahmeti, dhe bashkëpunëtorëve të tij, për sukseset e deritanishme, duke u dëshiruar një rrugëtim të mirëfilltë, me shumë suksese, në të ardhmen, thuhet në njoftimin e BFI.

"Në jubileun e 20-vjetorit të themelimit të BDI-së. Përcollëm urimet tona

Kryetarit z. Ali Ahmeti dhe bashkëpunëtorëve të tij për sukseset e deritanishme, me dëshirat për rrugëtim të mirëfilltë në të ardhmen", ka shkruar në faqen e vet në Facebook Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (5.06.2022)

NJË TAKIM MES MIQVE

Më 7 qershor, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti Myftiun e Kumanovës h. Abedin ef. Imeri me bashkëfshatarin e tij, njëherësh teolog i mirënjohur, h. Sabahudin ef. Selmani, thuhet në njoftimin e BFI.

Në takim Reis'ul-Ulemanë e shoqëroi h. Ismet ef. Ademi, Drejtor i Marrëdhënieve me Botën Arabe.

Me Myftiun dhe h. Sabahudin efen diun u bisedua për rrjedhat në BFI, për organizimin e Haxhit dhe për nevojat e bashkëpunimit dhe të unitetit të përgjithshëm.

Nga ana e tij, Reis'ul-Ulemaja e falënderoi Myftiun për aktivitetet e shumta gjatë muajit të Ramazanit, për rezultatet e



mira, si dhe për angazhimet e tij rreth denacionalizimit dhe projektet e planifikuara, për numrin e madh të haxhinjve nga Myftinia e Kumanovës etj. Zoti i be-

koftë – thuhet në njoftimin e BFI. "Ishte ky një takim mes miqve", ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu të njëjtën ditë në Facebook.

TAKOHEN LIGJËRUESIT E RADHËS NË TV IKRE

Në kuadër të realizimit të emisioneve fetare, më 8 qershor, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pati një takim me ligjëruesit e radhës në emisionin e njohur fetar TV IKRE: Hafezat ef. Dauti, Qëndrim ef. Zendeli dhe Nehat ef. Aliji. Me ta ishte edhe udhëheqësi i emisionit, Musanif ef. Rufati, thuhet në njoftimin e BFI.

Emisioni fetar TV IKRE është një nga produksionet më të ndjekura fetare në vend dhe transmetohet në rrjetet sociale të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, përfundon njoftimi.



"Ishte kënaqësi të takoj ligjëruesit e radhës të TV IKRE", ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.



Një takim rasti me prof. dr. Sulejman Ahmetin, ligjërues në UT. Biseduam për shumë çështje në sferën shkencore dhe rrjedhat e zhvillimit të përgjithshëm. E falënderova shumë për vizitën dhe qasjen serioze të zhvillimit shkencor, me dëshirë që të ndjekë hapat e babait të tij, prof. dr. Ismail Ahmeti - një kolos i dijes dhe i shkencës, në veçanti në sferën e shkencave orientale, ish-ligjërues në UP, UT dhe FSHI, si dhe anëtar i Këshillit themeltar të Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup dhe autor i shumë veprave në këtë lëmë. Prof. dr. Sulejman Ahmetit i dhuroam botimet më të reja të BFI, në shenjë respekti për kontributin e dhënë në shërbim të vlerave kombëtare dhe fetare. Zoti e bekoftë – ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (17.06.2022)



NUMAN ARUÇ NË BFI

Më 25 maj, 2022, prita në Kabinetin tim prof. dr. Numan Aruç-in, bashkëpunëtor i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të RMV, një personalitet i mirënjohur i dijes, i shkencës dhe i kulturës. Biseduam për shumë çështje që kanë të bëjnë me besimin, me kulturën dhe me zhvillimet shkencore në vend dhe më gjerë, si dhe për projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me sfidat e kohës. E falënderuam shumë për vizitën, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

TREGIM

“O ALLAH, MË BËJ PREJ PAKICËS!”

Njëherë Omeri (r. a.) po ecte në treg dhe takoi një njeri të ulur, i cili lutej: “O Allahu im, më bëj prej pakicës!”

Omeri (r. a.) e pyeti: “Ku e ke mësuar këtë lutje?”

Ai u përgjigj: “O prijës i besimtarëve, Allahu (xh. sh.) në Librin e Tij ka thënë: ‘...E, nga robërit e Mi pak janë mirënjohës...’” (Sebe’ë: 13)

Omeri (r. a.) qau dhe me vete tha: “O Omer, njerëzit dinë më shumë se ti. O Allah, më bëj prej pakicës!”

Ndonjëherë, kur e këshilloni ndokënd që t’i lë mëkatet, ai përgjigjet: “Por, shumica bëjnë mëkate; nuk jam unë i vetmi!...”

Por, në Kuran do të gjeni: “...Por, shumica e njerëzve nuk dinë.” (El-A’rafë: 187); “...Por, shumica e njerëzve nuk janë mirënjohës.” (El-Bekare: 243); “...Shumica prej tyre janë mëkatarë.” (El-Maide: 59); “...Shumica prej tyre janë injorantë.” (El-En’amë: 111); “...Por, shumica e tyre nuk e dinë të vërtetën, andaj e kthejnë kokën.” (El-Enbija: 24)

Ibn Kajjimi ka thënë: “Ec në rru-



gën e të vërtetës dhe mos u ndiej i vetmuar për shkak të numrit të vogël të atyre që janë në këtë rrugë; ruaju nga humbja për shkak të numrit të shumtë në këtë rrugë.”

I bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që të na bëjë prej robërve të pakët (në gjynahe)! Amin!

Përgatiti: Nexhati Spahiu



Një vizitë e këndshme nga tre personalitete të shquara të Universitetit të Tetovës, si: prof. dr. Naser Ademi, prof. dr. Ferat Polisi dhe Sekretari Ali Sadiku, na bëri të ndjehemi të nderuar. Ju dëshirova mirëseardhje dhe zhvilluam një bisedë konstruktive, duke shkëmbyer mendime rreth shumë çështjeve që kanë të bëjnë me BFI-në, në veçanti: me rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe. Njëherësh, biseduam edhe për rëndësinë e madhe të UT-së dhe të universiteteve të tjera në vend në shkollimin dhe profesionalizimin e gjeneratave të reja. Ishte kënaqësi - ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 20.06.2022 (Facebook).

NGUSHËLLIME PËR ISH-PRESIDENTIN BUJAR NISHANI

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në emrin e vet dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV shprehu ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të ish-Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani, thuhet në njoftimin e BFI.

Në faqen personale në Facebook Reis'ul-Ulemaja u përcolli ngushëllime familjes Nishani dhe gjithë shqiptarëve, duke e cilësuar ndarjen nga jeta të ish-Presidentit si një humbje të madhe.

Në vijim të letrës së ngushëllimit thuhet: “Me keqardhje pranuar lajmin e ndërrimit jetë të ish-Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani. Është një dhimbje dhe humbje e madhe për të gjithë shqiptarët, por dhe më gjerë. Ishte personalitet i pathyeshëm në zhvillimin e lirisë dhe të demokracisë në Shqipëri. Kam pasur rastin ta takoj në Tiranë dhe menjëherë fitova përshtypjen time të thellë të një personaliteti burrëror, të urtë, të heshtur dhe të mençur. Dha kontribut të madh në ngritjen e vetëdijes te shqiptarët mbi vlerën e besimit, të kombit, të vatanit dhe të shtetit. Ngushëllime të thella familjes dhe gjithë shqiptarëve, ndërsa të ndjerit Zoti i faltë Xhennetin në botën tjetër”, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Presidenti i mëparshëm i Republikës së Shqipërisë ndërroi jetë më 28 maj, 2022. Më parë, në përfundim të mandatit, z.



Bujar Nishani kishte qenë në umra në Mekë dhe në Medinë.

Presidenti Nishani do të kujtohet si një personalitet me integritet të lartë, i përkushtuar ndaj popullit e atdheut dhe si një burrë shtetas e vizionar i dëshmuar. Jemi mirënjohës për kujdesin, për kontributin dhe angazhimin e tij për çështjen e Kosovës! – ka shkruar Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në letrën e ngushëllimit pas ndërrimit jetë të ish-Presidentit Bujar Nishani.



Sot, i shoqëruar nga z. Fadil Ramadani, Kryetar i OH "Hilal"; z. Qufli Osmani, Përgjegjës i Administratës së BFI-së, bashkë me shoqërues të tjerë, vizituam familjen Abazi, me rastin e ndërrimit jetë të anëtarit të familjes Nusret Abazi. Shprehëm ngushëllime të thella në dhimbjen familjare, me lutje drejtuar Allahut fuqiplotë që familjes t'i dhurojë durimin, ndërsa rahmetliut xhennetin e amshueshëm. Në pritje ish-in familja e afërt, me në krye z. Zeko Abazi - një personalitet i arsimit dhe ish-Zv/drejtor i Komisionit për Çështje Fetare me vëllezërit e tij. Ishin të pranishëm dhe haxhi Ademi - një donator i mirënjohur nga Saraji e më gjerë. Zoti i shpërbleftë - ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (1.06.2022)VEPRAT FLASIN: Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu inspekton punimet në institucionin Arkivi i Bashkësisë Fetare Islame, i cili pritet të fillojë me punë së shpejti. (6.01.2021)

KALON NË AHIRET SHKRIMTARI BEGZAT BEGZATI

Më 28 maj, 2022, me namazin e iqindisë, përcollëm për në botën e përtejme, në Ahiret, haxhi Begzat Begzatin - mësuesin, edukatorin, gazetarin, autorin e shumë veprave të rëndësishme, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Gostivar.

Në këtë ceremoni fetare, që u zhvillua në Xhaminë e Kadrit në Gostivar, mori pjesë vetë Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli.

Pasi imami i Xhamisë, h. Daut ef. Alili, përshëndeti Myftiun dhe sqaroi rregullat fetare, Myftiu mbajti një fjalë rasti, gjatë së cilës, në rend të parë, ngushëlloi familjen Begzati, duke thënë se veprat e mëdha i vlerësojnë njerëzit e mëdhenj. I tillë ishte edhe merhumi, tha ai.

Myftiu në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në emër të Myftinisë dhe të mbarë opinionit falënderoi familjen për bashkëpunimin me revistën "Hëna e Re" në paraqitjen e portretit të Begzat Begzati, si dëshirë e fundit e rahmetliut (teksti u botua në numrin 364, janar 2022-shënim i Red.).

Varrimi i Begzat Begzati u bë në fshatin e lindjes, në Gjonovicë. Allahu e gradoftë me Xhenet, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Shkrimtari Begzat Begzati (1936-2022) ka botuar librat: "Zëri i shpirtit, mrekulli e Zotit", "Sulltana", "Xhemë Hasa - ushtarak demokrat", "Pa konsensus", "Zonja e Tugut", "Një jetë kushtuar të vërtetës", "Gjonovica, kështjellë iliro-shqiptare" etj.

Axha Begzat ishte njeri i mirë, i urtë dhe fisnik; ishte njeri i dijes - si në aspektin arsimor, ashtu dhe në aspektin fetar. Ishim dhe do të mbetemi krenarë me bashkëfshatarin tonë, me axhën Begzat, i cili na udhërrëfëu se nga vijnë dhe si duhet ruajtur kombin dhe fenë dhe kah duhet shkuar. Faleminderit për gjithçka, axha Begzat. Allahu të mëshiroftë e të bëftë nga banorët e Xhenetit. Amin - thuhet në njoftimin e Fondit të Fshatit Gjonovicë.



Në tubimin fetar në Dllapkindoll të Kërçovës, te dr. Ilmi Veliu, për të përkujtuar të birin e tij, hoxhën dhe ish-nxënësin tim Veli Veliu. Leximi i Kuranit, i Mevludit dhe i Kelime-Teuhidit preku thellë shpirtin dhe zemrat tona. Sevapet e fituara, për rahmetliun, Veli ef. Veliu. Allahu ia faltë xhenetin, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 5 qershor, 2022.

PËRCILLET PËR NË BOTËN TJETËR HAXHI NEXHAT ALIJA



Më 8 qershor, 2022, përcollëm për në botën tjetër haxhi Nexhat Alinë, gjyshin e hafëz Mehas ef. Alisë, Kryetar i KMSH në Zvicër dhe baba i imamit dhe muhafidhit të mirënjohur hafëz Ibrahim ef. Alija, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i BFI të RMV.

Rahmetliu, haxhi Nexhati, njihet si besimtar i devotshëm, i cili tërë jetën ia kushtoi Islamit, duke edukuar në këtë frymë gjithë familjen e tij, me dijetarë të fesë e të shkencës.

Pjesëmarrje e shumë besimtarëve nga

vendi dhe Kosova. I bëjmë lutje Allahut fuqiplotë që rahmetliut t'i falë xhenetin, kurse familjes sabrin, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Nexhat Ibrahim Alija (16.05.1933 - 8.06.2022), haxhi-baba ynë, evlijaja ynë, na la dhe e dorëzoi shpirtin e tij me nur, ka shkruar Mehas ef. Alija në faqen e vet në Facebook dhe ka shtuar: I kemi borxh shumë për hizin e Kuranit. Hapat e parë në rrugën e daveitit i nisëm me të.

Nga lozja jote dolën pesë hafëza të Kuranit, të cilët i shkollove dhe na dhe

përkrahjen më të madhe. Ishe punëtor i palodhur, por asnjëherë nuk e lë mangut përkushtimin ndaj Zotit. Të rrallë janë njerëzit që lënë gjurmë në heshtje, pa bërë shumë zhurmë. Ti ishe njëri prej tyre, ka shkruar në rrjetet sociale hafëz Arsim Dauti.

Ashtu siç e deshi fenë dhe njerëzit e fesë, Allahu e takoftë në Xhenetin Firdeus me ta, është shprehur hafëz Ibrahim ef. Alija, i biri i rahmetlisë.

Haxhi Nexhat Alija është varrosur në varrezat e qytetit të Tetovës.



Sot respektoam familjen e prof. Sadri Hasanoviçit, me rastin e ndërrimit jetë të nënës së tij. Pjesëmarrja e jonë bashkë me Myftiun e Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, ishte një përkrahje për vetë profesor Sadriun dhe familjen e tij në këto momente të dhimbjes dhe të humbjes së madhe. Myftiu dr. Qenan efendi priu në namazin e iqindisë, ndërsa unë fala namazin e xhenazes. Në fjalimin tonë ju lutëm të Madhin Zot që familjes t'i japë sabër, ndërsa rahmetlijes t'i falë xhenetin e amshueshëm. Shprehëm falënderimet tona për pritjen dhe organizimin e mirëfilltë të hoxhës Ferit ef. Selimi me bashkëpunëtorin e tij, hafëz në Xhaminë e mirënjohur të Bedrit në Butel të Shkupit. (12.06.2022)



VIZITË NGUSHËLLIMI TE FAMILJA MUSTAFA NË ZHUNICË TË PRESHEVËS: Më 5.06.2022, me rastin e ndërrimit jetë të Selajdin Mustafës. I shoqëruar nga z. Irsal ef. Jakupi, z. Xhelal Bajrami-prokuror, dr. Nexhati Jakupi-drejtor dhe haxhi Saniu-afarist, shprehëm ngushëllime të sinqerta, duke iu dëshiruar durim të pashoq dhe rahmetliut Zoti t'i fal xhenetin e amshueshëm. Rahmetliu njihet si një aktivist, humanist dhe donator i madh, në veçanti si një biznesmen i famshëm, i cili kontribuoi pa masë në investime kapitale, duke qenë dhe kontribues i madh në shërbim të ngjarjeve më të rëndësishme të kombit. Përjetuam pritje vëllazërore dhe shpirtërore nga familja Mustafa, në krye me imamin h. Suad ef. Shabani. Falënderoj prokurorin Xhelal Bajrami për udhëheqjen në këtë vizitë të rëndësishme, si mik i tyre. Zoti i bekoftë. (Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu)



Sot përcollëm për në botën tjetër një mikun tim familjar dhe shumë të respektuar, rahmetli Shadan Ramadanin nga Tetova. Ishte një burrë i aftë, i mençur, i suksesshëm dhe, mbi të gjitha, një kontribues i madh i fesë dhe i popullit. Pata nderin t'i fal namazin e xhenazes, ndërsa duanë e bëri prof. Metin ef. Izeti, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (12.06.2022)

TAKIM ME DREJTORIN E VAKËFIT TË TURQISË



Përfaqësuesit e BFI-së takojnë në Republikën e Turqisë Drejtorin e Vakëfit Turk, z. Burhan Ersoj (Burhan Ersoy), thuhet në njoftimin e BFI.

Takimi është zhvilluar më 20 qershor, 2022.

Të autorizuar nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në delegacion

ishin: Myftiu i Manastirit h. Hamit ef. Rasimi dhe Përgjegjësi për Marrëdhënie me Turqinë, Nizam Reshit.

Me Drejtorin e Përgjithshëm Ersoy dhe bashkëpunëtorët e tij u bisedua për projektin që realizohet në Manastir në kuadër të Myftinisë, përfshi dhe projektet tjera në të ardhmen. Ishte një takim vël-

lazëror.

Drejtori i Përgjithshëm i Vakëfit Turk përfaqësuesve të BFI-së u dorëzoi mirënjohje për kontributin e dhënë në shërbim të jetës fetare e më gjerë.

Me këtë dëshmuam edhe një herë bashkëpunimin e mirëfilltë në mes dy institucioneve, thuhet në njoftimin e BFI.

DUA-HATME NË VJENË

Faleminderit, o Zot! Dua-hatme me nxënësit e Mejtepit. Festë në xhaminë tonë! – thuhet në njoftimin e hoxhës Usam Halimi, Vjenë.

Plot 47 nxënës mbyllën në mënyrë festive vitin shkollor të mejtepit: 22 nxënës të Kuranit, 18 të nivelit të dytë dhe 7 të nivelit të parë. Sot, të përgatitur mirë, treguan njohuritë e tyre rreth leximit të Kuranit, njohurive fetare dhe të moralit islam.

Të punosh me fëmijë është gëzim, është privilegj dhe përgjegjësi. Të gjitha këto i kam ndarë me Mualimen Hfz. Ruhide Dervishi Alimi, Allahu e shpërbleftë për mundin dhe kontributin e dhënë.

Pjesëmarrja e prindërve dhe e familjarëve të tyre e zbukuroi edhe më shumë festën tonë. Prindër të dashur, ju falënderoj për besimin dhe korrektësinë

e treguar gjatë këtij procesi. Jemi të lumtur që Zoti na mundësoi të jemi si një familje dhe fëmijët të ndjehen si në shtëpitë e tyre. Xhamia është shtëpia e tyre, ndërsa ata janë ardhmëria e Xhamisë!

E falënderoj përzemërsisht mikun tim, Zv/Kryetarin e ALKIG-ut, Ylli Buraniqi, për prezencën e tij dhe fjalët motivuese e të miradijshme për nxënësit tanë. Faleminderit gjithë prindërve që me ëmbëlsira tradicionale e ëmbëlsuan takimin tonë. Faleminderit gjithë atyre që teknikisht ndihmuan që kjo festë të realizohet në mënyrën më të mirë. "Veproni, Allahu do ta shohë veprën tuaj; edhe i dërguari i Tij dhe besimtarët..." (Teube: 105) - thuhet në njoftimin e hoxhës Usam Halimi, nga Qendra Kulturore Shqiptare në Vjenë /ALKIG/. (19.06.2022)



TAKOHEN AKTIVISTËT NGA ZVICRA

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti më 7 qershor, 2022, në Rijaset, dy aktivistët e mirënjohur të çështjes fetare dhe kombëtare në Zvicër dhe në vendin tonë: z. Zibo Zendelin nga Debreshi i Gostivarit dhe h. Sami Mustafën nga Kumanova, thuhet në njoftimin e BFI.

Të dy mysafirët janë kontribues të njohur në ndërtimin e Xhamisë së Wil-it në Zvicër, thuhet në njoftim.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook takimin



e ka cilësuar të këndshëm dhe ka shtuar: lënderova për kontributin e dhënë. Zoti "Ua urova shkuarjen në Haxh dhe iu fa- i shpërbleftë."



SIMPOZIUM LIDHUR ME TEOLOGJINË ISLAME NË ZVICËR

Raporton: Rejhan Neziri

Në hapësirat e Akademisë Paulus në Cyrih (Zürcher Forum für Religion, Ethik, Gesellschaft und Politik) më 30 dhe 31 maj, 2022, Qendra Islame për Islam dhe Shoqëri (Schweizerisches Zentrum für Islam und Gesellschaft) me seli në Fribourg të Zvicrës mbajti një simpoziium shkencor lidhur me të ardhmen e teologjisë islame në shtetin helvetik me titull "On the Future of a Young Discipline: Islamic-theological Studies between Systematic and Practical Research" (Lidhur me të ardhmen e një disipline të re: studimet teologjike islame midis hulumtimit sistematik dhe atij praktik).

Simpoziumi u zhvillua në shtatë panele të ndryshme, ku panelistë e ligjërues ishin në radhë të parë doktorantë e të doktoruar tanimë nga po kjo qendër e Fribourgut, gjithnjë të shoqëruar me nga një ligjërues të jashtëm. Simpoziumi u zhvillua në dy gjuhë: gjermanisht dhe anglisht.

Simpoziumin e hapi bashkëdrejtori i Qendrës, prof. dr. Hansjörg Schmid, i cili fillimisht foli për dallimin midis hulumtimit apo kërkimit shkencor sistematik dhe atij praktik kur është në pyetje stu-



dimi i teologjisë islame. Pastaj bëri një rumbullakim të shkurtër të punimeve të doktoratës që janë duke vijuar në këtë qendër, por edhe të atyre që tanimë janë përfunduar, duke vënë theksin te karakteri i këtyre punimeve nga fusha e teologjisë praktike islame, si një disiplinë e re që mëton të etablohet këtu. Nuk kaloi pa u diskutuar bashkë me publikun edhe çështja e emërtimit të këtyre disiplinave dhe përdorimi i koncepteve me origjinë krishtere në fushën e teologjisë islame, si

f.v. teologji praktike, teologji e çlirimit, kujdesi shpirtëror ose baritor etj.

Në panelin e parë me punimet e tyre u prezantuan dr. Baptiste Brodard (i konvertuar në Islam), i doktoruar në këtë qendër dhe për momentin ndodhet për kërkime të mëtejme shkencore në Meksikë, si dhe dr. Haroon Bashir nga Markfield Institute of Higher Education në Angli. Tema e tyre ishte "Nga bamirësia drejt një teologjie islame të çlirimit: bazat fetare të praktikës myslimane të mirëqe-


nies". Ata dhanë përgjigje në pyetjet: Çfarë mund të mësojnë organizatat e punës sociale nga burimet islame? Çfarë kontributi mund të ofrojë një "teologji islame e çlirimit" për zhvillimin e mëtejme të praktikës së mirëqenies? Në cilat qasje hermeneutike mund të mbështeten projektet islame të një teologjie të çlirimit?

Në panelin e dytë me trajtesat e tyre prezantuan Dilek Uçak Ekinci, doktorante pranë kësaj qendre në Fribourg dhe prof. dr. Ingrid Mattson, myslimane e konvertuar me origjinë kanadeze dhe ligjëruese në Universitetin Western Ontario të Kanadasë. Ato trajtuan temën "Kujdesi shpirtëror në fushën e tensionit midis praktikës psiko-sociale, legjitimitetit teologjik islam dhe funksionalitetit institucional". Ato dhanë përgjigje në pyetjet: Cilat interpretime fetare lidhur me vuajtjen, dyshimin ose ngushëllimin mund të inkorporohen në shoqërimin e kujdesit shpirtëror? Çfarë pasojash kanë tensionet e mundshme brenda këtyre interpretimeve për praktikën e këtij kujdesi baritor? Në çfarë forme kujdesi baritor islam merr kuptim në aspektin funksional në kontekstin e institucioneve shekullore?

Në panelin e tretë me punimet e tyre prezantuan shqiptarja nga Maqedonia e Veriut Nadire Mustafi, doktorante pranë kësaj Qendre dhe prof. dr. Jenny Berglund nga Universiteti i Stokholmit, Suedi. Temën që ato trajtuan ishte "Xhamitë si vende të edukimit fetar për rininë myslimane: një reflektim nga aspekti i pedagogjisë së fesë". Ato dhanë përgjigje në pyetjet: Si mund të disenjohet mësimi fetar në xhami, në mënyrë që ai ta plotësojë mësimin shkollor deskriptiv lidhur me Islamit? Çfarë vendesh të tjera mësimi mund të ketë për të gjithë ata që janë të interesuar fetarisht, por që rrinë në distancë kundrejt xhamisë dhe institucioneve fetare dhe të cilët kërkojnë njohuri për traditën e tyre fetare?

Dita e parë e këtij simpoziumi u përmbyll me një trajtesë shkencore nga ana e prof. dr. Reinhold Schulze, nga Forumi Islami dhe Lindja e Afërt (FINO) në Bernë dhe njëkohësisht studiues i rrekur i Islamit, bashkë me prof. dr. Amir Dziri, bashkëdrejtor i Qendrës në Fribourg, në temën "Teologjia islame në një shoqëri plurale".

Pas ligjëratave të tyre, në podium u zhvillua një diskutim publik lidhur me teologjinë islame universitare dhe lidhshmërinë e saj me bashkësitë fetare islame në Zvicër. Në këtë diskutim morën pjesë: Arlinda Amity, shqiptare nga Maqedonia e Veriut, doktorante pranë kësaj



Qendra në Fribourg, Deniz Yüksel, nga Qendra për Integrim e Kantonit të Cyrihut, Rejhan Neziri si imam nga Kreuzlingen dhe dr. Marc Bundi, përfaqësues i Kishës së Reformuar Evangjeliste në Kantonin e Cyrihut. Moderator i kësaj bisede ishte drejtori i akademisë nikoqire "Paulus", Csongor Kozma.

Në ditën e dytë të simpoziuit fjalën hyrëse e pati prof. dr. Amir Dziri, me titull "Kërkimi sistematik në studimet e teologjisë islame".

Më pastaj, në panelin e katërt, me trajtesat e tyre shkencore u paraqitën Arlinda Amity nga Fribourgu dhe prof. dr. Zekirija Sejdi, po ashtu shqiptar nga Maqedonia e Veriut, ligjërues dhe drejtues i Katedrës për pedagogji islame pranë Universitetit të Innsbruckut, Austri. Ata e trajtuan temën "Të kuptuarit e Islamit në bazë të predikimeve të së premtës midis normativitetit dhe kontekstit: shembulli i imamëve shqiptarë në Zvicër". Ata ofruan përgjigje për pyetjet: si ndikojnë çështjet brenda komunitetit dhe strukturave në të kuptuarit e Islamit nga ana e imamëve? Cili është raporti midis burimeve normative dhe kontekstit shoqëror që reflektohet në predikimet e së premtës? Çfarë roli luajnë temat e rëndësishme sociale në këtë plan?

Në panelin e pestë me kumtesat e tyre u paraqitën Alexander Boehmler, i konvertuar në Islam dhe doktorant pranë Qendrës në Fribourg, dhe prof. dr. Mark Sedgwick nga Universiteti Aarhus i Danimarkës. Ata e trajtuan temën "Bashkëjetesa në shoqërinë plurale: vetëreflektimi mysliman dhe kontributi i sufizmit". Ata kërkuan përgjigje në pyetjet: Në çfarë mase mund të kontribuojnë mendimet e sufistëve të hershëm përndimorë si Frithjof Schoun në reflektimin e sotëm islam? Si të veprojmë me faktin se në çdo shoqëri idealet dhe vlerat evoluojnë (zhvillohen) vetvetiu?

Në panelin e gjashtë prezantuan Safia Boudaoui, doktorante pranë Qendrës dhe dr. Ghassan el-Masri nga Universiteti i Berlinit dhe Erlangenit. Ata e trajtuan temën "Evolucioni dhe implementimi praktik: koncepti i zeqatit në Kuran midis kontinuitetit dhe thyerjes". Ata kërkuan përgjigje në pyetjet: Në çfarë mase na lejon analiza filologjike të reflektojmë për diversitetin e kuptimeve teologjike? Në çfarë mase zeqati dhe sadakaja janë relevante për diskutet e tanishme teologjike dhe etike në kontekstet myslimane?

Dhe në panelin e fundit, të shtatë, prezantuan kumtesat e tyre Esmat Arnavutović, doktorante pranë Qendrës dhe prof. dr. David Vishanoff nga Universiteti i Oklahomës. Ata e trajtuan temën "Antropologjia teologjike – një perspektivë e re brenda studimeve të teologjisë islame". Në kumtesat e tyre ata kërkuan përgjigje në pyetjet: Ku është e vendosur antropologjia teologjike dhe si trajtohet ajo brenda studimeve të teologjisë islame? Si mund të ankorohet ajo në epistemologji dhe në metodologji? Cilat qasje antropologjike janë zhvilluar nga ana e teologëve dhe dijetarëve myslimanë? Çfarë i dallon ato dhe çfarë vlere dhe rëndësie kanë këto qasje?

Me këtë përfunduan edhe trajtesat e diskutimit shkencor lidhur me teologjinë islame në Zvicër, duke u bazuar në punimet e doktoratës të punonjësve shkencorë myslimanë, për nga origjina ose të konvertuar - një pjesë prej tyre edhe me prejardhje shqiptare, gjithnjë të shoqëruar nga ekspertë të fushave gjegjëse në universitete të ndryshme të botës.

Punimet e Simpoziuit do të publikohen në përmbledhje të veçantë të Qendrës Zvicereane për Islam dhe Shoqëri me seli në Fribourg të Zvicrës. (Kreuzlingen, 1 qershor 2022)

KREUZLINGEN: LIGJËRATË PËR RRJETET SOCIALE

Më 12 qershor, 2022, në xhaminë "Hëna e Re" në Kreuzlingen u mbajt një ligjëratë për anët e ndritshme dhe të errëta të mediave, sidomos të internetit, thuhet në njoftimin e xhamisë së këtij qyteti të Kantonit Thurgau, Zvicër, ku Imam është Rejhan ef. Neziri.

Ligjëratat u zhvilluan pas namazit të drekës, në gjuhën gjermane, nga ana e ekspertit për media, z. Peter Welti Cavagn. Tema e saj ishte: Anët e ndryshme të mediave - anët pozitive dhe ato negative.

Ligjëratat u drejtohej në radhë të parë prindërve dhe të rriturve, duke potencuar përgjegjësinë që kanë ata lidhur me përdorimin e mediave të ndryshme (veçmas, rrjeteve sociale) nga ana e fëmijëve të tyre dhe në çfarë forme t'i shpëtojnë ata në këtë proces.

Nga ligjëratat rezultoi ky konstatim: jo t'u ndalohen fëmijëve mediat (rrjeteve sociale), por t'u mundësohet përdorimi i arsyeshëm i tyre, me mbikëqyrje të na-



tyrshme nga ana e prindërve dhe e të rriturve, derisa fëmijët ta fitojnë aftësinë dhe pjekurinë e tyre personale në përdorimin e mediave (rrjeteve sociale), thuhet në njoftimin e xhamisë "Hëna e Re", Kreuzlingen.

XHAMIA EL-HIDAJE MBAJTI KUVENDIN

Më 12 qershor, 2022, Xhamia el-Hidaje në St. Gallen (Zvicër) zhvilloi kuvendin informativ dhe zgjedhor, në të cilin u morën vendime të rëndësishme, ku edhe u bë zgjedhja e anëtarëve të rinj të Kryesisë, me në krye kryetarin e ri Sadush Ajrullai, thuhet në njoftimin e Xhamisë el-Hidaje.

E një rëndësie të veçantë për këtë kuvend ishte pëlqimi që u dha nga anëtarët e Xhamisë për blerjen e parcelës në qytetin St. Gallen për xhaminë e re, si dhe u paraqit një projekt ideor nga një zyrë e arkitekturës, me ç'rast përfaqësuesi i zyrës u përgjigj në pyetjet që erdhën nga xhamati dhe të pranishmit.

Kryesisë së kaluar, me në krye Naser Zeka, i urojmë jetë e shëndet dhe i bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që t'i shpërblejë dhe ta marrë në konsideratë kontributin e



tyre dhënë Xhamisë dhe komunitetit tonë në përgjithësi, kurse Kryesisë së re i dëshirojmë punë të mbarë dhe suksese në të ardhmen. Amin!

Në ditët në vijim pritet që të bëhet

edhe konstituimi dhe ndarja e posteve përkatëse të Kryesisë së re. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të gjithë ne! - thuhet në njoftimin e Xhamisë el-Hidaje.

SHËNOHET DITA E REFUGJATËVE NË ZVICËR

Më 18 dhe 19 qershor, 2022, me rastin e Ditës së Refugjatëve (20 Qershor), morëm pjesë në aktivitetin e përbashkët interreligjioz në qytetin St. Gallen, me lutje dhe ceremoni fetare, duke shkruar e kujtuar emrat e të humburve dhe të mbyturve në dete e në male, të cilët nga vende të ndryshme të botës kishin për synim Evropën, thuhet në njoftimin nga Mehas

ef. Alija, Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ/DAIGS).

Me këtë aktivitet nderuam dhe kujtuam ata vëllezër dhe ato motra që kanë ikur ose janë përzënë nga shtëpitë e tyre, por dhe protestuam me mënyrën tonë fetare për moskujdesin që tregojnë shtetet dhe institucionet që kanë mundësi t'i ndalojnë këto fatkeqësi dhe tragjedi njerë-

zore, thuhet në njoftimin e KMSHZ.

Aktivitetet në nderim të Ditës së Refugjatëve (gjermanisht: Flüchtlingsstag) janë organizuar në më shumë vende të botës. Kjo datë është caktuar më 4 dhjetor 2000 nga OKB, me rastin e 50-vjetorit të UNHCR-it (United Nations High Commissioner for Refugees).



SCHAFFHAUSEN: SHKOLLAT FILLORE MËSOJNË ISLAM

Mësimbesimi islam këtë vit edhe në shkollat fillore të Kantonit Schaffhausen, thuhet në njoftimin e hoxhës Nimetulla Veseli.

Me fillimin e vitit të ri shkollor, 2022/23, nxënësit e dy shkollave fillore të Neuhasenit do të kenë edhe një mundësi të re - lëndën e mësimbesimit islam!

Një mundësi shumë e mirë që fëmijët myslimanë përmes rrugëve institucionale, edukative, në këtë rast siç janë shkollat, të kenë qasje dhe rast për ta mësuar fenë e tyre drejt dhe saktë!

Angazhim disavjeçar, që sivjet konkretizohet si pilot-projekt në dy shkollat fillore.

Që në këtë rast, nuk do të kursej fjalënderimet e përzemërta për bashkëpunimin dhe mbështetjen e rezervë të dhënë nga Organizata dhe Pjesëmarrësit për Dialog Ndërfetar dhe Enti për Integrim, në veçanti mikut tim Doc. M.S.



Neuhausen am Rheinfall (foto: Google)

Na qoftë ky fillim i mbarë dhe i bereqetshëm thuhet në njoftimin e hoxhës Nimetulla Veseli/Zvicër.

(19.06.2022)

“JO, NUK ËSHTË ASHTU, PASHA HËNËN!”

Myslimani me këtë siguri, me këtë frymë të re, e fillon jetën e vet. Kështu ai largohet nga negativiteti, bëhet një person pozitiv, jeton me të tashmen, përgatitet për të ardhmen, përfiton nga e kaluara dhe shpëton nga robëria materiale. Ai në këtë mënyrë kujton mirësitë e Zotit, jeton duke ngritur kokën drejt qiellit, pa harruar rolin e tij në tokë. Jeta ka nevojë për besimtarë të vërtetë dhe me dinjitet, që do të kenë ndikim në zhvillimin e vlerave dhe jo vetëm recitues të lutjeve me zemër të boshatisur dhe praktikues të namazit në aspektin formal.

Nga Nehat Ismaili

Në këtë ditë të bukur të xhumasë, me fillimin e agimit të mëngjesit dhe freskinë e saj, me bukurinë e rrallë që shfaqet gjatë lindjes së diellit, po hulumtoja rreth domethënive dhe interpretimit të disa fjalëve nga Kurani fisnik.

Ajo që më tërhoqi vëmendjen ishin fjalët e Zotit Lavdiplotë: “**Jo, nuk është ashtu, pasha hënën! Edhe natën kur tërhiqet! Edhe agimin kur agon!**” (El-Mudethir: 32-35) “**Betohem fuqimisht në yjet që tërhiqen (ditën, e ndriçojnë natën), Që udhëtojnë e fshihen (si dreri në strofkë), Pasha natën kur ajo ia beh me errësirë. Pasha agimin kur ia shkrep! S’ka dyshim se ai (Kurani) është thënie e të dërguarit fisnik (që e pranoi prej Zotit).**” (Et-tekvir: 15-19).

Janë disa vepra kapitale që kanë lënë gjurmë të thella në vetëdijën time, që kanë ndikuar në formim tim intelektual, të cilat kohë pas kohe i lexoj dhe, sa më shumë që thellohem dhe u rikthehem atyre, sërish mësoj shumë gjëra të reja.

Njëra prej atyre veprave që kam lexuar kur isha 20 vjeç ishte vepra e intelektualit të shquar mysliman Sejjid Kutub “Fi Dhilalil Kuran”. Gjatë këtyre viteve asnjëherë nuk jam ndalur së lexuari dhe hulumtuari për çdo ajet, duke iu referuar veprave dhe mufesirëve të shquar siç janë: *Xhamiu Bejan fi tefsiril Kuran* të Imam Taberiu (vdiq 310 hixhrij); *El-Keshshaf* të Zemahsheriut (vdiq 538 H); *Mefatihul Gajb* të Imam Raziut (vdiq 606 H); *El-Xhami’ li-ahkamil Kuran* të Imam Kurtubiut (vdiq 671 H); *Tefsiril Kurani-*



l-adhim të Ibn Kethirit (vdiq 774 H); *Fethul Kadir* të Imam Sheukanit (vdiq 1250 H).

Njeriu asnjëherë nuk duhet të hezitojë të lexojë ndonjë libër që e ka lexuar më parë, pasi çdo periudhë e jetës ka leximin dhe filozofinë e vet të të kupturit. Në të

kaluarën, shumë libra dhe romane që kam lexuar në një fazë të caktuar të jetës i kam shikuar me admirim, por realisht tani, në këtë fazë të jetës, nuk gjej arsye për atë admirim të atyre librave, të asaj faze. Por, edhe e kundërta është e vërtetë - se janë shumë libra të cilëve u jemi larguar pas

leximit të parë dhe ndoshta nuk kanë lënë gjurmë të thella në shpirtin dhe vetëdijen tonë, ndaj kur u kthehem atyre pas një kohe, kuptojmë rëndësinë dhe peshën e tyre - ata rriten në sytë tanë dhe mësojmë shumë nga kuptimet e reja që nuk na janë shfaqur në leximin tonë të parë.

FAKTORËT QË NDIKOJNË TE LEXIMI

Sigurisht që këtu kanë ndikuar shumë faktorë, siç janë: moshë e njeriut, presionet psikologjike, mbajtja e ritmit, ndikimi dhe dominimi i ideve të caktuara ideologjike të shekullit të kaluar që errësuan mendjen dhe zemrën nga pamjet e qarta të gjërave.

“**Jo, nuk është ashtu, pasha hënën! Edhe natën kur tërhiqet! Edhe agimin kur agon!**” (El-Mudethir: 32-35) “**Betohem fuqimisht në yjet që tërhiqen (ditën, e ndriçojnë natën), që udhëtojnë e fshihen (si dreri në strofkë), pasha natën kur ajo ia beh me errësirë, pasha agimin kur ia shkrep! S’ka dyshim se ai (Kurani) është thënie e të dërguarit fisnik (që e pranoi prej Zotit).**” (Et-Tekvir: 15-19)

Sejjid Kutub në tefsirin e tij “Fi Dhilalil Kuran” në mënyrë brilante jep një shprehje rreth domethënive të këtyre ajeteve, duke u shprehur:

“Është e rrallë që një zemër të zgohet me shikimin e hënës kur lind dhe kur perëndon. Pastaj nuk kupton asgjë për hënën, duke i pëshpëritur për sekretet e kësaj ekzistence! Dhe, një pauzë në dritën e hënës ndonjëherë e lan zemrën sikur të ishte duke u larë me dritë!”

Është e rrallë që një zemër të zgohet në skenën e natës kur kthehet, në atë qetësi që i paraprin lindjes së diellit, dhe kur fillon e gjithë kjo ekzistencë, ajo hap sytë dhe zgohet në të dhe në thellësitë e tij shfaqen rreziqe të tejdukshme.

Është e rrallë që një zemër të zgohet në pamjen e mëngjesit kur niset dhe shfaqet, dhe më pas nuk pulson në të me një puls shkëlqimi dhe hapjeje, dhe një kalim emocional nga një gjendje në tjetrën, duke e bërë atë më të përshtatshme për të - merrni dritën që shkëlqen në ndërgjegje me dritën që shkëlqen në sy.”

Bukur dhe me shumë pasion është shprehur Sejjid Kutub: “...Është e rrallë që një zemër të zgohet në pamjen e mëngjesit kur niset dhe shfaqet, dhe më pas nuk pulson në të me një puls shkëlqimi dhe hapjeje...”

Gjithësia i takon madhërimin dhe lavdërimin të Zotit dhe pikërisht për këtë besimtarë mysliman ka më shumë arsye ndërveprimi me gjithësinë dhe duhet të

bashkohet në këtë mision të shenjtë, duke madhëruar dhe lavdëruar emrin e Tij.

Besimtari i vërtetë kur mediton për rrjedhën e jetës në gjithësi, ai e sheh Zotin në univers, ka një ndjenjë të saktë, i shtohet besimi dhe është më i lidhur me Zotin e tij. Universi tregon së pari ekzistencën e Zotit dhe nëpërmjet organizimit të tij të saktë, të universit, tregon për njëshmërinë e Tij; përmes shkëlqimit – saktësinë e sistemit dhe ekuilibritin e tij mahnitës, të gjitha si shkathtësi të fuqisë së Zotit.

Në këtë sistem të mrekullueshëm dhe të saktë ai, njeriu, thotë pa asnjë dyshim: «I lartësuar dhe pa të meta qoftë Zoti madhështor». Këtë e thotë nga thellësia e shpirtit dhe pastaj sërish mediton në ditën tjetër të re, sërish në fillim të agimit, të mëngjesit të ardhshëm, dhe kështu në një cikël prej njëzet e katër orësh, duke falenderuar dhe lavdëruar Zotin e gjithësisë.

Janë transmetuar fjalë të mrekullueshme nga Pejgamberi ynë në formë lutjesh, të cilat duhet lexuar në fillim të ditës dhe në mbarim të saj, në mëngjes dhe në mbrëmje. Ato janë fjalë ndriçuese dhe inspiruese.

Pas leximit të lutjeve të mëngjesit dhe të mbrëmjes myslimani i dorëzohet sërish Zotit, madje e ripërtërin nënshtrimin ndaj Tij. Çdo moment e njeriut në jetë është një ditë të re dhe një mundësi tjetër që i është dhënë nga Zoti, e cila është një dhuratë, një dhuratë që meriton falënderim, madje meriton të qëndrojë para saj gjatë kohë dhe nga këtu besimtari i vetëdijshëm hyn në një pakt me Zotin për besnikëri ndaj Tij, deklaron dashurinë ndaj Islamit me një besim të thellë, duke thënë: “Jam i lumtur me Allahun që është Zoti im, me Islamit si fenë time dhe me Muhamedin, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, si profet dhe i dërguar.”

Kjo deklaratë shënon pikënisjen e një udhëtimit të ri, ripërtëritjen e besëlidhjes ndaj Zotit, me pranim të plotë të urdhrave të Tij në këtë ditë të re, që shënon një rilindje të re për të, një qenie e re njerëzore që nuk lajthitet lehtë nga matrapazët pa dinjitet njerëzor.

KY UNIVERS KA NJË ZOT

Jeta mbart me vete shumë probleme; të gjitha janë sfida e të tjera, veç kësaj. Një numër i madh i njerëzve janë të zhytur në borxhe në formë të kontratave ndërmjet vete, por besimtari i vërtetë e di që ky univers ka një Zot dhe krijues që e kontrollon dhe e menaxhon universin në mënyrë të përkryer dhe pikërisht për këtë

besimtari e fillon ditën e re me këtë lutje të ndritur: “Në emër të Zotit, me emrin e të Cilit asgjë nuk mund të dëmtojë në tokë dhe në qiell; Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.”

Duke iu lutur Zotit me këto lutje që burojnë nga thellësia e shpirtit, ne tregojmë se vetëm Zoti i madhërishtëm mund të na largojë nga sprovat që kemi, të na largojë nga sëmundjet e epokës siç janë depresioni, shqetësimet sociale, ekonomike, familjare etj. E gjithë kjo kërkohet nga besimtari një forcë të brendshme për t’u përballur me to dhe e vetmja për besimtarin është që të lidhet me Zotin e tij. Prej këtu besimtari thotë me bindje: “O Zot, kërkoj mbrojtje te Ti nga ankthi dhe trishtimi dhe kërkoj mbrojtje te Ti nga dobësia dhe përtacia.”

Me lindjen e diellit, me frymën e mëngjesit, me fillimin e një dite të re, me tingujt e bukur të zogjve që mbushin anët e universit, me pritjen e një lindjeje të re që lajmëron fillimin e një dite të re, me frymën e re që ngrihet me këtë ditë, dhe me çdo ditë, madje edhe me çdo orë, dhe në çdo moment besimtari kujton të keqen, kështu që ai shpejton me kërkim falje drejt Zotit dhe ikën te Zoti dhe deklaron se do të ishte i pavlerë dhe askushi pa Zotin. Ai i thotë nga zemra lutjet që nënkuptojnë kërkim mbështetje dhe mbrojtje nga e keqja e vetvetes dhe cymtet e shejtanit të mallkuar, duke shqiptuar fjalët «estagfiruall ue etubu ilejhi-kërkoj falje te Zoti dhe i pendohem Atij».

Jeta është një mundësi dhe vetëm Zoti është ai që e jep këtë mundësi. Kur besimtari e kujton këtë bekim të madh, ai menjëherë i drejtohet Zotit me falënderim, me përkujtim dhe lutje, duke thënë: “subhanallah, el hamdulillah, Allahu ekber”. Kështu jeton myslimani, me këto lutje të gjalla në çdo ditë të re. Në këtë mënyrë ai do të jetë me Zotin në çdo çast, në çdo orë dhe tërë ditën. Lavdia dhe falënderimi i qoftë Zotit.

Myslimani me këtë siguri, me këtë frymë të re, e fillon jetën e vet. Kështu ai largohet nga negativiteti, bëhet një person pozitiv, jeton me të tashmen, përgatitet për të ardhmen, përfiton nga e kaluara dhe shpëton nga robëria materiale. Ai në këtë mënyrë kujton mirësitë e Zotit, jeton duke ngritur kokën drejt qiellit, pa harruar rolin e tij në tokë. Jeta ka nevojë për besimtarë të vërtetë dhe me dinjitet, që do të kenë ndikim në zhvillimin e vlerave dhe jo vetëm recitues të lutjeve me zemër të boshatisur dhe praktikues të namazit në aspektin formal.

(Zvicër, 27.05.2022)

NË MISIR, PËR HERË TË PARË

Të dashurit e mi, në momentet më të vështira të jetës, kur secili prej nesh të mendojë se bota është ngushtuar dhe nuk ka zgjidhje, të jetë i bindur se zgjidhja është te sinqeriteti që ti dhe unë kemi me Allahun (xh. sh.)!

Nga Imam Muhamed B. Sytari

Misir, ndryshe Egjipt, ose: “Nëna e botës”! Në sfond është lumi Nil.

Është hera e parë që shkel në këtë tokë të lashtë; tokë e historisë, e personazheve, e kulturës dhe e traditave, e dijes dhe e edukatorëve; djepi i Ez’heri Sherifit!

I famshmi Nil, që buron nga xheneti, si një shenjë bekimi e mirësie për tokën, për njeriun dhe mbarë njerëzimin! I madhi Nil, të cilin, teksa e shoh, sjell ndër mend atë nënë të shtrenjtë, atë nënë të mirë, nënën e Hz. Musait (a. s.), të cilën Allahu (xh. sh.) e frymëzoi dhe e mësoi që ta vendoste djalin e saj të posalindur, foshnjën e vogël Musa, në një shportë dhe ta linte në rrjedhën e Nilit: **“Ne nënën e Musait e frymëzuan: t’i japë atij gjë, e kur të kesh frikë për të, atëherë atë hidhe në lumë, e mos u frikëso, as mos u pikëllo, se Ne do ta kthejmë atë ty dhe do ta bëjmë atë nga të dërguarit!”**ⁱ

Ai fëmijë që lundronte i qetë dhe i vetëm në rrjedhën e këtij lumi të madh, do të mbërrinte te dera e armikut të tij të përbertuar, Faraonit, edhe pse djali i sapodalë në dritë as që e dinte se çfarë po ndodhte e ku do ta merrnin rrjedhat e lumenjve të kaderit... **“E, atë e gjeti familja e faraonit, ashtu që në fund ai t’u bëhet atyre armik e dëshpërim...”**ⁱⁱ Ai djalë ishte përzgjedhur për të qenë njëri ndër pesë të dërguarit më të shquar të historisë së njerëzimit...

M’u kujtua Hz. Ibrahim (a. s.), të cilin e hodhën në një zjarr të madh për ta shuar, për ta eliminuar, për ta heshtur thirrjen e tij! Ja, si e përshkruan Kurani famëlartë këtë moment: **“Atëherë ata thanë: ‘Digjeni atë (Ibrahimin) dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni t’u ndihmoni.’ Po ne i thamë: ‘O zjarr,**



bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!’ Ata deshën t’i bëjnë atij (Ibrahimit) kurth, po Ne ata i bëmë të dëshpëruarit.”ⁱⁱⁱ

M’u kujtua Hz. Jusufi (a. s.), të cilin vëllezërit e tij e hodhën në një vend të errët, në një pus të thellë, për ta hequr qafe nga xhelozia dhe smira: **“Mbyteni Jusufin, ose hidheni diku larg, në një vend, e babai juaj t’ju dojë juve e pas asaj (pendohuni), bëhuni njerëz të mirë.”**^{iv} Subhanallah!

M’u kujtua e m’u kujtua shumë peygamberë të Allahut (xh. sh.). M’u kujtua Hz. Isa (a. s.), kundër të cilit komplotuan për ta vrarë, për ta ekzekutuar e kryqëzuar, ndërkohë Allahu i madhëri-

shëm e ruajti peygamberin e tij, e lartësoi, e shpëtoi, ndërsa imazhin e tij ia vuri tradhtarit të tij, i cili ishte në mesin e shoqërisë së ngushtë: **“Madje, për shkak të thënies së tyre: ‘Ne e kemi mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut.’ Po ata as e mbytën, as e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau...?’”**^v

M’u kujtua Hz. Muhamedi (a. s.) në shpellën e ditës së emigrimit, ditës së hixhretit, kur Ebu Bekri (r. a.) dridhej nga frika se mos mushrikët do ta kapnin Hz. Muhamedin (a. s.) dhe mund ta vrisnin. Atë ditë mund të ndodhte çdo gjë! Ndërsa Peygamberi, me qetësi dhe i buzëqeshur, i thoshte: **“Mos u pikëllo (frikëso); Allahu është me ne!”**^{vi}

Të dashurit e mi, në momentet më të vështira të jetës, kur secili prej nesh të mendojë se bota është ngushtuar dhe nuk ka zgjidhje, të jetë i bindur se zgjidhja është te sinqeriteti që ti dhe unë kemi me Allahun (xh. sh.)!

Nuk na braktis Allahu (xh. sh.)! Mendoni për pak se te sa e sa peygamberë dhe te sa e sa njerëz të mirë përgjatë historisë, shembujt e të cilëve na janë treguar, në momentet më vendimtare, në çastet më delikate, mes jetës dhe vdekjes, ka ndërhyrë dora e përkujdesjes hyjnore për t’i dhënë triumfin, për t’i dhënë zgjidhjen e për t’i nxjerrë nga vështirësia drejt zgjidhjes.

Prandaj, të mos dëshpërohemi dhe mos të humbim shpresën në mirësinë dhe bekimet e Allahut (xh. sh).

Qofshi mirë!

(Autori është Myfti i Zonës Shkodër, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë)

ⁱ Kuran, El-Kasas: 7.

ⁱⁱ Kuran, El-Kasas: 8.

ⁱⁱⁱ Kuran, El-Enbija: 68-70.

^{iv} Kuran, Jusuf: 9.

^v Kuran, En-Nisa: 157.

^{vi} Kuran, Et-Teube: 40.

MEHDI POLISI, STUDIUESI QË NGADHËNJEU MBI PARAGJYKIMET

Veprimtaria e tij është vëllimore, e shumanshme, e thellë dhe cilësore. Këtë më së miri mund ta dëshmojnë albanologët, orientalistët, turkologët, leksikografët, gjuhëtarët, letrarët, historianët, islamologët etj.

Shkruan: Dr. Zejni Mazllami
(Enkas për HeR)

Profesor Mehdi Polisi është lindur më 27 nëntor 1953 në fshatin Dobovjan të Strugës. Shkollën fillore e ka kryer në Dobovjan dhe Veleshtë të Strugës, kurse të mesmen, Medresenë Alauddin, në Prishtinë në vitin 1973.

Në vitin akademik 1973/74 është regjistruar në Fakultetin Filozofik (tash Filologjik) të Universitetit të Prishtinës, në Degën e Orientalistikës, ku ka diplomuar në vitin 1977.

Ishte student i gjeneratës së parë dhe ndër të parët që ka diplomuar në Degën e Orientalistikës në Prishtinë. Pas diplomimit ka punuar në Arkivin Historik në Ohër (1978/80).

Në vitin 1980 ka filluar punën në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, në Degën e Orientalistikës.

Në vitin 1988 në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë ka mbrojtur punimin e magjistraturës me titull *“Adaptimet fonetike dhe morfologjike të huazimeve orientale në gjuhën shqipe”*. Në të njëjtin institucion në vitin 1997 ka mbrojtur disertacionin e doktoratës me titull *“Turqizmat në të folmën shqipe të Maqedonisë”*.

Ka qenë shef i Degës së Orientalistikës dhe prodekan i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës. Për lëndën *Gjuhë osmane* ka qenë i angazhuar në Universitetin e Tetovës, në



Degën e Historisë dhe në Degën e Filologjisë Orientale, në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup dhe në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Pas një sëmundje të shkurtër, ndërroi jetë më 21 maj 2014.

Veprimtaria e dr. Mehdi Polisit është vëllimore, e shumanshme, e thellë dhe cilësore. Këtë më së miri mund ta dëshmojnë albanologët, orientalistët, turkologët, leksikografët, gjuhëtarët, letrarët, historianët, islamologët etj.

Gjuha dhe gjuhësia janë bërë pjesë të pandashme të jetës së tij; ato e kanë ndjekur atë në çdo hap. Për punën e vazhdueshme të dr. Mehdi Polisit, të nxjerrjes në dritë, si dhe të pasurimit të literaturës shkencore shqiptare, sot flasim veprat e tij autoriale dhe të përkthyer. Falë angazhimit dhe punës së gjatë dhe të mundimshme, mbi njëzetvjeçare, dr. Mehdi Polisi, vlerat madhështore të Orientit i studion si diçka të vetën (ashtu si gjuhëtarit dhe historiani shqiptar që studiojnë gjuhën dhe historinë shqiptare) dhe jo për ndonjë qëllim tjetër politik apo përfitues. Përkthimet nga gjuha osmane në gjuhën

shqipe, zbardhja e personaliteteve tona historike, veçanërisht e atyre të proveniencës islame, transkriptimi i dorëshkrimeve shqipe të shkruara me alfabet arab, studimet letrare - janë kontributi i çmuar dhe shumë i rëndësishëm për kulturën shqiptare. Studimet e dr. Mehdi Polisit hapin horizonte të reja dhe zgjerojnë e thellojnë njohuritë ekzistuese në gjuhësi, letërsi, islamistikë etj.

E BËRI SAMI FRASHËRIN QË TË FLISTE SHQIP

Për jetën e Sami Frashërit dhe veprën e tij janë bërë shumë studime - si nga studiues vendorë, ashtu dhe nga studiues të huaj. Por, me të drejtë profesor Hasan Kaleshi shkruante se *“vepra e Sami Frashërit është studiuar njëanshëm dhe nuk është bërë për të një monografi e plotë dhe gjithëpërfshirëse”*. Lexuesi shqiptar i ngel borxh profesor Mehdi Polisit për ndriçimin që ia bëri veprës së Sami Frashërit në gjuhën shqipe.

Interesimi i profesor Mehdi Polisit për veprën e Samiut filloi që nga viti 1982, kur gjatë një qëndrimi në Turqi për

hulumtime shkencore e gjeti romanin “Dashuria e Talatit me Fitneten”, i cili, sipas historianëve të letërsisë turke është romani i parë në letërsinë moderne turke. Romanin e pëlqeu dhe e përktheu atë vit në gjuhën shqipe. Fillimisht u botuan disa fragmente, kurse i plotë u botua për herë të parë në gjuhën shqipe më 1984, në Prishtinë.

Romani u prit shumë mirë nga lexuesi shqiptar. Kjo ishte një nxitje që në vazhdimësi Mehdi Polisi t’i përkushtohet veprimtarisë së Sami Frashërit, duke studiuar dhe përkthyer edhe vepra të tjera të tij, si: *Personalitetet shqiptare në Kamus al-a’lam*; *Medeniyet-i Islamiyye (Qytetërimi islam)*; *Lisan (Gjuha)*; *Letaif (Anekdota)*.

Në vitin 2004 shtëpia botuese Logos-A në Shkup kishte në projekt botimin e veprës së plotë të Sami Frashërit në gjuhën shqipe. Profesor Mehdi Polisi mori përsipër të zgjedhë disa vepra të Sami Frashërit për t’i përkthyer dhe të cilat do të botoheshin për të parën herë në gjuhën shqipe: *Gök (Qielli)*; *Yer (Toka)*; *Insan (Njeriu)*; *Yine Insan (Përsëri njeriu)*; *Esatir (Mitologjitë)*. Përkthimi dhe botimi i këtyre veprave në gjuhën shqipe pa dyshim paraqet kontributin më të madh të profesor Mehdi Polisit.

Profesor Mehdi Polisi duke analizuar fillimet e Sami Frashërit në gazetari, thekson se gazetaret e kohës Samiu do t’i shfrytëzonte si mjet për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të shoqërisë përgjithësisht dhe të shoqërisë shqiptare në veçanti. Kjo mund të shihet në gazetën *Zëdhënësi i Lindjes (Tercuman-i Shark)*, redaktor i së cilës ishte nga numri 74 deri në numrin 179. Artikujt e botuar në këto numra të kësaj gazete janë dëshmi e mjaftueshme që tregojnë luftën e vazhdueshme që ka zhvilluar Samiu me penën e tij për zgjidhjen e çështjes së pazgjidhur shqiptare.

Sipas profesor Mehdi Polisit, Sami Frashëri është i pari që shkruan për probleme të ndryshme gjuhësore, filologjike në Perandorinë Osmane. Samiu në veprën “*Gjuha*” shkruan: “*Kjo shkencë te ne është ende e panjohur. Përveç disa artikujve sipërfaqësorë dhe të shkurtër, që i kam shkruar para disa vitesh në gjuhën turko-osmane (në revistën Hafta), lidhur me këtë çështje nuk është shkruar asgjë më tepër.*”

Të hysh në një fushë të pashkelur, sidomos në një fushë komplekse siç është gjuhësia, duke trajtuar tema të ndryshme teorike e praktike të saj, duhet pasur në rradhë të parë dy cilësi: guximin intelektual

dhe njohuri të thella - përfundon Mehdi Polisi.

Sipas vlerësimeve të profesor Mehdi Polisit, puna më kolosale ishte pikërisht në periudhën e pjekurisë së tij shkencore, gjatë përgatitjes së Enciklopedisë së përgjithshme të historisë dhe të gjeografisë, të njohur me emrin *Kamus al-a’lam*, në gjashtë vëllime në gjuhën turko-osmane.

Si njohës i mirë i jetës dhe studiues i thellë i veprës së Sami Frashërit, profesor Mehdi Polisi i ka bërë një vlerësim shumë domethënës veprës “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë?*”: “*Nga vetë titulli i saj shihet se kjo vepër nuk është gjë tjetër, veçse një program i qartë kombëtar, ku Samiu do t’i përfaqësojë idetë dhe pikëpamjet e tij rreth problemeve që më së shumti ia kishin zënë frymën gjatë tërë jetës – ardhmëria e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar. Mendimet dhe konceptet e tij lidhur me zgjidhjen e çështjes shqiptare të përfaqësuara në enciklopedinë Kamus al-alam dhe në periodikun e kohës, Samiu do t’i elaborojë në këtë vepër një nga një, në mënyrë shumë të sistemuar, duke punuar në dy rrafsh: në rrafshin shkencor dhe në rrafshin politik. Dhe, mendoj, mu kjo është arsyeja që Samiu do ta ndajë veprën në tri pjesë. Kjo vepër është një manual, të cilin duhet ta ketë në dorë çdo shqiptar.*”

Si përfundim, profesor Mehdi Polisi pa dyshim ishte studiues dhe intelektual i dëshmuar në fushën e gjuhës dhe të kulturës. Njohja e thellë e gjuhëve orientale, kultura e gjerë, përkushtimi në punën shkencore dhe mungesa e paragjykimëve, mundësoi nxjerrjen në dritë të studimeve objektive.

PËRKTHIME TË NDRYSHME

Në vazhdim do të japim disa nga përkthimet e profesor Mehdi Polisit, të botuara si libra, në shtypin ditor dhe në revista kulturore dhe fetare.

Përkthime nga gjuha turke:

Të jap mend, “Rilindja”, 26. 04. 1984.
Mbreti i plehut, “Bota e Re”, 15 qershor 1985 dhe në “Zëri i Rinisë”, 15 mars 1986.

Çizmjja e një pashai pensionist, “Rilindja”, 30.06.1988.

Unë nuk përzihem, “Rilindja”, 17.05.1990.

Përkthime nga gjuha arabe:

Sahihu-l Buhari në gjuhën shqipe 1, Prishtinë, 1995.

Yjt i duan fëmijët, “Flaka e Vëllazërimit”, 14.12.1977, Shkup.

Pse heshti lumi? “Gëzimi”, Shkup, nr. 3, 1978.



I zhgënjyeri, botuar në përmbledhjen “Proza arabe”, Prishtinë, 1983.

Përkthime nga gjuha boshnjake: *Shkaqet e shpalljes së Kuranit*, “Dituria Islame”, nr.29/1991.

Agjërimi, “Dituria Islame”, prill/1991.

Përkthime nga gjuha osmane: Sami Frashëri, *Personalitetet shqiptarë në Kamus al-a’lam të Sami Frashërit*, Logos-A, Shkup, 1994, 2002, 2004 (botimi i tretë).

Sami Frashëri, *Dashuria e Talatit me Fitneten*, Prishtinë, 1984; Tiranë, 1992; Logos-A, Shkup, 2002, 2004 (botimi i katërt).

Sami Frashëri, *Qytetërimi islam*, Prishtinë, 1999; Shkup, 2002, 2004 (botimi i tretë).

Sami Frashëri, *Gjuha*, Prishtinë, 2001, Logos-A, Shkup, 2002, 2004 (botimi i tretë).

Sami Frashëri, *Anekdota*, Logos-A, Shkup, 2003, 2004 (botimi i dytë).

Sami Frashëri, *Qielli*, Logos-A, Shkup, 2004.

Sami Frashëri, *Toka*, Logos-A, Shkup, 2004.

Sami Frashëri, *Njeriu*, Logos-A, Shkup, 2004.

Sami Frashëri, *Përsëri njeriu*, Logos-A, Shkup, 2004.

Sami Frashëri, *Mitologjia*, Logos-A, Shkup, 2004.

Kujtimet e një bukurosheje (përkthim nga osmanishtja, bashkë me shënime për autorin Hajredin Leskoviku, i cili ka jetuar në shek. XIX dhe ka shkruar disa vepra letrare), “Rilindja”, 5.12.1997.

(Autori është profesor në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës)

RREZIKU I GJUHËS



Nga Denis ef. Abdushi

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!

Falënderimet dhe lavdet më të plota i takojnë Zotit të gjithësisë, i Cili na krijoi dhe na veçoi me mirësi dhe dhunti të panumërta, i dhuroi njeriut logjikën e shëndoshë, mendjen e ndritur dhe ia mësoi të folurit e të shprehurit.

Bekimet dhe përshëndetjet më të plota qofshin mbi më të dashurin tonë, Muhamedin (s.a.v.s.), i cili na e mësoi të mirën dhe na e tërhoqi vërejtjen nga çdo ves i ulët.

Vëllezër dhe motra! Allahu i madhërisëm na dhuroi mirësi të shumta, mirësi për të cilat kurrë nuk do të mund ta falënderojmë Allahun për to ashtu siç duhet. Ndër këto mirësi është edhe mirësia e gjuhës, nëpërmjet së cilës ne shprehim atë që kemi në brendësi dhe i kryejmë nevojat tona.

I Lartësuari na e kujton këtë mirësi në Kuran dhe thotë: “**A nuk i kemi dhënë Ne atij (njeriut) dy sy, gjuhë dhe dy buzë?**” (Surja Beled: 8-9)

E, si të mos jetë e tillë kur ne nëpërmjet kësaj gjuhe madhërojmë Zotin tonë, i thurim lavde, lexojmë Kuran dhe e përmendim Krijuesin pandërprerë!

Nëse këtë mirësi nuk e shfrytëzojmë siç duhet, do të pësojmë prej saj dhe do të jetë kundër nesh Ditën e Llogarisë: “**Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë.**” (Surja Nur: 24)

Për këtë shkak Allahu i lartësuar dhe i dërguari i Tij na urdhërojnë të ruajmë gjuhët tona dhe t’i peshojmë fjalët që nxjerrim, ngase, nëse flasim mirë, do të vjelim fryte të këndshme; nëse flasim keq dhe nuk i peshojmë fjalët, do të pendo-hemi atë Ditë kur nuk bën dobi as pasuria e as pushteti: “**O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’ju bekojë veprat tuaja dhe do t’ju falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.**” (Surja Ahzab: 70-71)



Çfarë mendoni për një person, i cili fal pesë kohët e namazit; madje dhe ndoshta fal edhe namaz vullnetar, agjëron Ramazanin, lexon Kuran, jep lëmoshë etj., ndërsa nga ana tjetër fyen njerëzit, shan të tjerët, përgojn dhe bart fjalët dhe prek në nderin e njerëzve? A thua, vallë, si do të jetë halli i tij?

Dëgjoni këtë hadith, të cilin e përcjell Ebu Hurejreja - Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Thotë hadithi: “Një njeri tha: ‘O i dërguar i Allahut! Për filan gruan flitet për namazin dhe për lëmoshën e shumë të saj. Falet natën, agjëron ditën dhe vepron e vepron... por ajo i lëndon fqinjët me gjuhën e saj.’ I dërguari tha: ‘Ajo është në Zjarr.’ Personi tha: ‘O i dërguar i Allahut! Për filan gruan flitet për agjërimin, për lëmoshën dhe namazin e paktë të saj. Fal vetëm se farzet, jep diçka nga ushqimi dhe nuk i lëndon fqinjët me gjuhën e saj.’ I Dërguari tha: ‘Ajo është në Xhenet.’”

A kaq i madh është rreziku i gjuhës?! Gjithsesi, dhe tepër frikësues.

Shoku i të Dërguarit (s.a.v.s.), Muadh ibn Xhebeli, e pyeti Pejgamberin (a. s.) për gjërat të cilat, nëse i kryen, a do ta afrojnë pranë Xhenetit dhe a do ta largojnë nga Zjarri. Pasi Pejgamberi (a. s.) ia tregoi disa gjëra, e pyeti Muadhin: “*A dëshiron të tregoj për atë që e përmbledh të gjitha këto gjëra?*” Muadh u përgjigj: “*Gjithsesi, o Pejgamber i Zotit.*” Atëherë, Pejgamberi (a. s.) mori gjuhën e tij dhe tha: “*Ruaje këtë!*” Muadh i tha: “*O Pejgamber i Zotit, a do të merremi në llogari për atë që flasim?*” I Dërguari tha: “*Të humbtë nëna, o*

Muadh! Vallë, a i hedh njerëzit me fytyrë, apo me hundë në Zjarr diç tjetër, veç të korrave të gjuhës së tyre?!”

Ebu Hurejreja - Allahu qoftë i kënaqur me të - përcjell se i dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë: “*Robi e flet një fjalë pa u qartësuar në të (pra, duke mos e ditur se a është në kënaqësinë e Allahut, apo në hidhërimin e Tij); për shkak të saj hidhet në Zjarr më larg se ndërmjet lindjes dhe perëndimit.*”

I dërguari i Allahut (s.a.v.s.) i pyeti shokët e tij: “*A e dini se kush është i falimentuari?*” Ata thanë: “*I falimentuari në mesin tonë është ai që nuk ka dërrhem (para) dhe pajisje.*” Pejgamberi (a. s.) tha: “*I falimentuari prej ummetit tim do të vijë Ditën e Kiametit me namaz, me agjërim dhe me zeqatë, por që ka fyer njeri, ka shpifur për atë, e ka ngrënë pasurinë e tij, e ka derdhur gjakun e tij dhe e ka rrahur atë. Atij do t’i jepet prej veprave të mira të tij dhe atij tjetrit do t’i jepet prej veprave të mira të tij. Nëse veprat e mira të tij harxhohen para se të shlyhet obligimi i tij, do të merren prej mëkateve të tyre dhe do t’i hidhen atij, pastaj do të hidhet në Zjarr.*”

A e kuptojmë tani rrezikun e gjuhës?! Andaj, le të ruajmë gjuhët tona dhe le t’i peshojmë fjalët që i nxjerrim, ngase ato regjistrohen dhe asgjë nuk humbet: “**Për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).**” (Surja Kehf: 18)

Allahu na udhëzoftë, na drejtoftë nga e mbara dhe na frymëzoftë të mirën dhe të bukurën në fjalë dhe në veprë!

SINQERITETI

Nga Burim ef. Sadria

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të Botëve. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi pejgamberin Muhamed (a. s.), mbi familjen e tij, mbi shokët dhe të gjithë ata që e ndjekin atë me mirësi deri në Ditën e Kiametit.

Thotë Allahu (xh. sh.) në Kuranin fisnik: **“Dhe, nuk ju urdhëruam veçse që të adhuronit Zotin me sinqeritet dhe me përkushtim të plotë.”** (Surja Bejjine: 5) **“Thuaj, unë jam urdhëruar që të adhuroj Zotin, duke plotësuar detyrat e fesë së Tij me sinqeritet.”** (Surja Zumer: 11)

Sinqeriteti është një nga adhurimet të cilat kryhen me zemër. Të jesh i sinqertë me Zotin, do të thotë që çdo vepër që ta bësh, ta kryesh vetëm për hatër të Zotit të lartësuar dhe për të fituar kënaqësinë e Tij.

Ajo që na mungon shumë sot është pikërisht sinqeriteti. Kur ndihmojmë dikë, dëshirojmë që të marrë vesh secili, sepse veprën që e bëjmë nuk e bëjmë për Zotin, por për syfaqësi. E gjitha, që të na shohin njerëzit se jemi nga ata që iu ndih-

mojmë të tjerëve. Ndërsa Allahu garanton se Ai i **“pranon punët vetëm prej të sinqertëve”**. (Surja Maide: 27)

Muhamedi (a. s.) në një rast u tha shokëve të vet: **“Ajo që kam frikë ndaj jush është shirku i vogël.”** Shokët e pyetën: **“Çfarë është shirku i vogël, o i dërguar i Allahut?”** – *Syfaqësia, u përgjigj ai.*

Pejgamberi Muhamedi (a. s.) në një rast tjetër tregon një ngjarje të veçantë për Ditën e Llogarisë. Ai thotë: **“Zjarri i xhehenimit do të ndizet me tre lloje njerëzish: i pari është një njeri që ka rënë shehid. Do të sillet dhe do ta pyet Zoti mbi mirësitë që ia ka dhënë dhe a do t'i pranojë. Zoti do ta pyet përsëri se çfarë ke bërë me këto mirësi? ‘Luftova për hatrin tënd, o Zot, derisa u vrava’ – do të përgjigjet. ‘Gënjen!’ – do t'i thotë Zoti. ‘Luftova që të të thuhet se je trim.’ Më pas do të hiqet zvarrë dhe do të hidhet në zjarr. I dyti është ai njeri që ka marrë dije. Kur ta pyet Zoti se çfarë ke bërë me atë që e mësove, do të përgjigjet: ‘Mora dije dhe ua mësova atë njerëzve të tjerë për hatrin Tënd.’ ‘Gënjen!’ – do t'i thotë Zoti. ‘Mësove që të të thuhet se je i ditur...’ Më pas do të tërhiqet zvarrë dhe do të hidhet në zjarr. I treti është një njeri**



të cilit Zoti i ka dhënë pasuri të shumta dhe ai ka dhënë prej saj lëmoshë për të varfrit. Do të sillet para Zotit e do të pyetet se çfarë ka bërë me pasurinë që i ka dhënë Zoti e ai do të përgjigjet: ‘O Zot! Pasurinë që më ke dhënë unë e shpërndava në rrugën tënde.’ ‘Gënjeve!’ – do t'i thotë Zoti. ‘E shpërndave që të të thuhet se ky qenka bujar.’ Më pas do të hidhet në zjarr.”

Nga kjo nuk duhet të kuptojmë se nuk duhet të kërkojmë të vdesim si shehid, apo mos të na jepet pasuri dhe të mos u japim të varfërve, por që çdo gjë që ta bëjmë, ta bëjmë me sinqeritet dhe jo për të na lavdëruar njerëzit. Mos të harrojmë! Ishte sinqeriteti ai që e shpëtoi Jusufin (a. s.) nga imoraliteti. Allahu thotë: **“Ajo e mësyni atë qëllimisht, e atij do t'i shkonte mendja ndaj saj, sikur të mos i prezantohej argumenti nga Zoti i tij. Ashtu (e bëmë të vendosur) që ta largojmë nga ai të keqen dhe të ndytën. Vërtet, ai ishte nga robtë tanë të zgjedhur.”** (Surja Jusuf: 24)

Omer bin Hattabi (r. a.) e pa njëherë një burrë i cili kur falej, e përkulte qafën, si formë përkushtimi dhe i tha: **“I dashur! Përkushtimi nuk është te qafa, por te zemra.”**

Qofshim prej atyre besimtarëve që kur bëjmë ndonjë vepër, ta bëjmë për hatër të Zotit dhe jo për hatër të njerëzve.



SHKËLQENI ZEMRAT TUAJA ME DHIKËR

Nga Shkëndije Mullarexha

Gjitha fjalët falënderuese dhe lavdëruese i përkasin vetëm Allahut. Atij i takojnë cilësitë më të përsosura dhe emrat më të bukur. Paqja dhe bekimi qofshin mbi vulën e pejgamberisë, Muhamedin (a. s.).

Dhikër quhet përkujtimi i Allahut me gojë dhe me zemër, duke e falënderuar, duke e lavdëruar dhe duke e madhëruar Atë. Allahu na ka urdhëruar ta përmendim Atë gjithmonë dhe kudo. Ai thotë në Kuranin fisnik: **“O ju që keni besuar! Përkujtoheni Allahun sa më shpesh dhe madhërojeni Atë në mëngjes dhe mbrëmje.”** (Surja Ahzab: 41-42)

Në një hadith kudsij Allahu thotë: **“Unë jam tek rob i Im, aq sa ai pret prej Meje. Unë jam me të kur ai më kujton Mua. Nëse ai më kujton me zemrën e tij, Unë e kujtoj tek Vetja Ime dhe nëse ai më kujton Mua në një shoqëri (xhemat), Unë e kujtoj në shoqëri (xhemat) më të madhe se ajo e atij. Nëse ai më afrohet Mua një krah, Unë i afrohem atij një pash. Nëse ai më afrohet Mua duke ecur, Unë rendi drejt tij me një shpejtësi të madhe.”**

Muhamedi (a. s.) ka thënë: **“Të devotshmit (El-Muferidunë) ua kanë kaluar të gjithëve.”** Ata që kanë qenë pranë kanë pyetur: **“Kush janë Muferidunët?”** Pejgamberi (a. s.) është përgjigjur: **“Ata burra dhe ato gra që e përkujtojnë shpesh Allahun.”**

Transmeton Muadhi (r. a.) se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: **“Asnjë veprim tjetër i njeriut nuk është mjet më efektiv për të shpëtuar nga dënimi i Allahut sa përmendja e Tij.”**

Gjithashtu, transmeton Ebu Hurejre (r. a.) se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: **“Ripërtërijeni besimin tuaj duke thënë sa më shpesh: La Ilaha Ilallah.”**



Xhabiri (r. a.), ndërkaq, transmeton se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: **“Dhikri më i mirë është La ilahe ilallah (Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut) dhe lutja më e mirë është fjala Elhamdulillah.”**

Dhikri, ose fjalët më të dashura për Allahun, janë këto si më poshtë:

LA ILAHE ILALLAH (Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut);

SUBHANALLAH (Lëvduar qoftë Allahu);

ELHAMDULILAH (Falënderimi i takon vetëm Allahut);

ALLAHU EKBER (Zoti është më i Madhi);

ESTAGFIRULLAH (Pendohem tek Allahu);

LA HAVLE VE LA KUVETE ILA BIL LAH (Nuk ka fuqi apo pushtet veçse me lejen e Allahut).

Ka thënë pejgamberi Muhamedi (a. s.) se fjalët më të dashura për Allahun janë:

SUBHANE ALLAHI VE BIHAMDIHI, SUBHANE ALLAHIL ADHIM (Të gjitha lavdërimet, madhërimet dhe falënderimet i përkasin vetëm Allahut).

Gjithashtu, Ibn Mesudi (r. a.) transmeton se Muhamedi (a. s.) ka thënë: **“Nëse dikush lexon dy ajetet e fundit të**

sures Bekare, ato do të mjaftojnë për të; ato do ta mbrojnë nga çdo e keqe.” Në një rast tjetër ka porositur të lexojmë suren Ihlas, se ka vlerë të madhe, sa 1/3 e Kuranit fisnik.

Xhuejria (r. a.) tregon se një ditë ka qëndruar gjatë duke bërë dhikër dhe kur është kthyer Muhamedi (a. s.) i ka thënë: **“Unë i thashë këto katër fjalë nga tri herë, që kanë shumë vlerë dhe llogariten sikur me orë të tëra të kem bërë dhikër: SUBHANE ALLAHI VE BIHAMDIHI ADEDE KHALKIHI VE RIDA NEFSIHI VE ZINETE ARSHIHI VE MIDADE KELIMATIHI (I madhëruar është Allahu. Falënderimet i takojnë vetëm Atij, sa numri i gjithë krijesave që ka krijuar; I Madhëruar është Allahu sa është i bukur Arshi i Tij; dhe i madhëruar është Allahu sa ngjyra e pasosur për t'i shkruar fjalët falënderuese për Allahun).**

Për fund, duhet përmendur dhikrin e radhës që ka një vlerë të madhe:

Zoti im! Të gjitha falënderimet të takojnë Ty, po aq sa lavdia dhe lartësia e madhështisë Tënde, të cilat me të drejtë i meriton.

Ta themi deri në takimin me Zotin e lartësuar, që ta meritojmë kënaqësinë dhe dashurinë e Tij.

TEMA NGA MYFTINITË E BFI TË RMV: DIBËR, <https://myftiniadiber.com/>

PËR NJË KËNDIM TË BUKUR TË FJALËS SË ZOTIT

Kjo shkencë trajton leximet e ndryshme të fjalëve të Kuranit duke u bazuar në transmetim. Më saktë, vetëm ato dallime të cilat janë transmetuar të mbështetura në një zinxhir, i cili zgjatet deri tek i dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Kështu që, mund të themi që shtylla e saj kurrizore është pikërisht transmetimi.

Shkruan: Hasime Salihu

Falënderojmë Allahun (xh. sh.), i cili në Kuranin famëlartë ka thënë: “O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani nga Zoti juaj), shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.” (Junus 57)

Muhamedi (a. s.), ndërkaq, ka thënë: “Lexojeni Kuranin, sepse ai do të vijë ndërmjetësues në Ditën e Gjykimit për ata që e kanë lexuar.” (Muslimi)

Kurani, si fjalë hyjnore për myslimanët, ka qenë, është dhe do të mbetet gjithnjë mendim i gjallë, inspirues, i përhershëm dhe fuqinxitës i zhvillimit të mendimit kreativ.

KURANI, NJË MESAZH I PËRKRYER

Kurani, si fjalë e Allahut dhe atribut i Tij i përhershëm, është një mesazh i përkryer, i zhveshur nga çdo kundërtënie dhe kontradiktë. Mu për këto premisa, Kurani mbeti preokupim i përhershëm për dijetarët islamë ndër shekuj e mote, të cilët, duke përfutur nga ëmbëlsia e tij hyjnore, shkruan vepra të tëra me komente rreth tij.

Ibn Arebiu, komentues i Kuranit nga Andaluzia, thotë: “Kurani është kozmosi që flet; kozmosi, ndërkaq, është Kurani që hesht.” Kjo thënie flet shumë. Ajo prek brendinë e gjërave dhe nga kjo duhet nisur kurdo kur dikush pyet lidhur me tematikën e Kuranit, për çfarë i tërhiqet vërejtja njeriut.

Çdo njeri i qaset Kuranit në mënyrën e vet: e përjeton, e studion dhe e zbulon me mundësitë dhe kapacitetin e vet intelektual, ndërsa rezultati i tyre është iden-



titik - të gjithë e pranojmë atë fuqi të çuditshme, mahnitëse, magjepsëse dhe tërheqëse të të folurit të Allahut të madhërishtëm. Besimtarët te Kurani gjejnë ftesën, programin, të ardhmen dhe ushqimin e tyre intelektual dhe shpirtëror, ndërsa jobesimtarët befasinë, magjepsjen, habinë dhe paaftësinë e tyre për ta imituar.

Edhe pse Kurani si fjalë e Allahut (xh. sh.) nuk mund të vihet brenda kornizës së një përkufizimi, dijetarët islamë kanë dhënë përkufizime të shumta për këtë Shpallje Hyjnore. Kështu, Subhi Salihu dhe Musa Shahin Lashini për Kuranin kanë dhënë këtë përkufizim: “Kurani është të folurit e Allahut, është mrekulli e shpallur e Muhamedit (a. s.), i shkruar në mos’hafe, i transmetuar me besnikëri, ndërsa edhe vetëm leximi i tij është iba-

det.”

Ky përcaktim dhe përkufizim i Kuranit ka për qëllim të paraqet disa karakteristika:

- Kurani është fjala e Allahut të madhërishtëm;
- Kurani është i paarritshëm dhe nuk mund të imitohet as në gjuhën arabe, as në ndonjë gjuhë tjetër;
- Kurani iu shpall njeriut, Muhamedit (a. s.), të dërguarit të Allahut;

ç) Kurani është regjistruar dhe është transmetuar besnikërisht nga njëra gjeneratë te tjetra;

d) Leximi dhe recitimi i Kuranit është ibadet dhe vepër e mirë.

Një fushë tepër e vyer është edhe ajo e kirâeteve. Nga një anë - tepër e komplikuar, por, nga ana tjetër, magjepsëse.

Me shpresë që edhe ne të mësojmë diçka e të përforcojmë njohuritë që kemi, hyra në rrugën e analizimit të kësaj teme të diplomës. Kështu, do të mundohem të trajtoj çështjen e kirâeteve, duke nisur nga përkufizimi, historiku i shkurtër dhe praktikimi i shkencës së kirâeteve.

PËRKUFIZIMI I SHKENCËS SË KIRAETIT

Dituria e *Ulum al-Kuran-it*, ose “e shkencave të Kuranit”, merret me njohuritë e atyre shkencave të cilat kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me recitimin, historinë, të kuptuarit dhe të zbatuarit e Kuranit. Kjo është, si pasojë, një fushë e diturisë islame, me rëndësi themelore.

Kështu, për shembull, për sa i përket recitimit, *Ulum al-Kuran* merret me shkencën e shqiptimit (texhvidit), me metodologjitë e ndryshme të recitimit të Kuranit (kira’at), të mirat e recitimit të Kuranit dhe rregullat e recitimit të tij. Për sa i përket historisë së Kuranit, *Ulum al-Kuran* merret me periudhat e shpalljes së Kuranit, me përpilimin e Kuranit, artin dhe historinë e shkrimit të tekstit të Kuranit (rasm al-masahif) dhe ruajtjen e Kuranit. Për sa i përket të kuptuarit dhe zbatimit të tij (të Kuranit), *Ulum al-Kuran* përfshin shkaqet e shpalljes (asbab an-nuzul), njohurinë e shpalljeve mekase dhe medinase, njohurinë e formave të ndryshme (ahruf) në të cilat është shpallur, të kuptuarit e rregullave dhe ajeteve të tij të shfuqizuara (nasih ve al-mansuh), njohurinë e klasifikimeve të ndryshme të ajeteve të tij (muhkam dhe muteshabih, ‘am dhe khas, mutlak dhe mukjad etj.), njohurinë e interpretimit të tij (tefsir), analizën gramatikore të Kuranit (irab al-Kuran) dhe njohurinë e atyre fjalëve përdorimi i të cilave është bërë i rrallë gjatë kohës (garib al-Kuran).

Është thënë se njohuria e *Ulum al-Kuran-it* është, në të vërtetë, njohuria që kërkohet të dijë dikush për të interpretuar siç duhet Kuranin. Prandaj, nëse këtë fushë të diturisë islame e quajmë “Rregullat dhe Metodologjia e Interpretimit” (Ilm Usul at-Tafsir) në vend të *Ulum al-Kuran*, nuk do të kishte shumë dallim nga e vërteta. Megjithatë, *Ulum al-Kuran* gjithashtu përfshin tema që kanë shumë pak lidhje ose aspak të tefsir-it, si përmbledhja e Kuranit, dhe përmirësimi i shkrimit të Kuranit. Prandaj, njohuria e *Ulum al-Kuran-it* është më e përgjithshme se e *Ilm Usul al-Tafsir*.

Sa i përket shkencës së kiraetit, mendohet mënyrat e ndryshme të leximit të Kuranit famëlartë.

Fjala **kiraet** është shumë e fjalës **kiraet**, që në leksik do të thotë “lexim, shqiptim” dhe është sinonim i fjalës Kuran. **Kiraet** është *masdari* i foljes “kara-e” (lexoj). Kurse në terminologji, me fjalën el-Kiraetu emërtohen dallimet mes fjalëve, ose shkronjave të Kuranit dhe shqiptimit të tyre si *med, kasër, idgam, imale* etj., të bazuara në transmetimet përkatëse.

Imam Ibn el-Xhezeri Kiraetin e përkufizon kështu: “Kiraeti është shkenca që përshkruan tiparet e leximit të shkronjave të Kuranit dhe ndryshimet e leximit të tyre në bazë të transmetimeve.”

Ndërkohë që me fjalën **kiraet** emërtohet edhe leximi përkatës i çdo transmetuesi.

P.sh.: *kiraetu Asimin* (leximi i Imam Asimit).

Pra, kjo shkencë trajton leximet e ndryshme të fjalëve të Kuranit duke u bazuar në transmetim. Më saktë, vetëm ato dallime të cilat janë transmetuar të mbështetura në një zinxhir, i cili zgjatet deri tek i dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Kështu që, mund të themi që shtylla e saj kurrizore është pikërisht transmetimi. Por, për shkak se shkenca e kirâeteve është shumë e zhvilluar dhe sistematike, ato nuk do t'i gjejnë në formën klasike të transmetimeve që ndodhen në librat e haditheve.

Personat më të dalluar në këtë fushë janë të kufizuar dhe gjithashtu shumë të njohur. Për këtë arsye besueshmëria në informacion rritet.

Parashtrohet pyetja: prej nga lindën kiraetet? Transmetohet se Muhamedi (a. s.) në një hadith ka thënë se Kurani është shpallur në shtatë harfe; Muhamedi (a. s.) në disa mënyra e ka lexuar Kuranin. H. Uthmani ka urdhëruar të përshkruhen shumë ekzemplarë të Kuranit dhe të dërgohen në krahinat e ndryshme islame që të shërbejnë si bazë për përshkrimin dhe këndimin e Kuranit. Ato mus’hafe që i ka dërguar h. Uthmani kanë qenë të shkruara sikur edhe alfabeti tjetër i atëhershëm arab - pa zanore dhe pa shenja të pikësimi. Në krahinat në të cilat qenë dërguar ato mus’hafe kanë jetuar mjaft shokë të Muhamedit (alejhis-selam), si dhe shumë njerëz të tjerë të cilët me transmetime e kanë mësuar leximin e Kuranit. Atëherë çdo krahinë ka lexuar ashtu si e ka dërguar nga shokët e Muhamedit (alejhis-selam), duke pasur parasysh gjatë kësaj edhe vetë alfabetin e mus’hafit që ua kish dërguar h. Uthmani. Kështu kanë lindur kiraetet e ndryshme. Sipas kësaj, kiraetet kryesisht janë një pjesë prej shtatë harfeve.

LLOJET E KIRAETEVE

Kurani fisnik Muhamedit (alejhis-selam) i është shpallur për afër 23 vjet me radhë, duke i zbritur nga një pjesë të ajetit, një ajet, më shumë ajete, një pjesë të sures apo tërë surja e kështu me radhë. Muhamedi (alejhis-selam) nuk dinte shkrim-lexim, Kuranin fisnik e pranonte në mënyrë mekanike, pra përmendsh dhe vetëm gojarisht. Shpesh nga frika që të mos harrojë ndonjë pjesë që në moment ia shpallte atij Xhibrili (alejhis-selam), ai ngutej që ta përsëriste e t’i mësonte përmendsh ato sa më mirë, derisa Allahu shpalli pjesën e ajetit 16 të sures Kijame, duke i thënë: “**Mos nxito me gjuhën tënde, sepse Ne (kujdesemi) për tubimin dhe leximin e tij (Kuranit).**”

Meqë Pejgamberi (alejhis-selam) nuk dinte shkrim-lexim, ai gjithnjë kujdesej që të mos harronte, mirëpo në suren A’la, ajeti 6, përsëri i erdhi edhe një vërejtje, duke i thënë: “**Ne do të ta lexojmë dhe nuk do të harrosh.**”

Nëse kjo ishte situata e Pejgamberit (alejhis-selam), që kujdesej kaq shumë për ruajtjen e Kuranit përmendsh, atëherë pra edhe gjendja e Sahabëve (radjallahanum), nuk ka qenë më e vogël se ajo e Pejgamberit (alejhis-selam). Ata, sa herë që Muhamedit (alejhis-selam) i shpallje ndonjë pjesë nga Kurani, e mësonin përmendsh dhe e shkruanin në mjete që kishin në dispozicion. Pastaj, çdo Ramazan Xhibrili (alejhis-selam) Muhamedit (alejhis-selam) ia lexonte në tërësi të gjitha ajetet e shpallura, e që në Ramazanin e fundit të jetës së ndershme të tij t’ia lexojë të gjithë Kuranin, në tërësi, dhe të radhë në mënyrën që e kemi sot në duar. Ndërsa Sahabët (radjallahanum) gjithnjë e dëgjonin me vigjilencë dhe e mësonin, duke dëgjuar edhe lexime në mënyra të ndryshme nga herët e para që i dëgjonin. Pejgamberi (alejhis-selam) më vonë ua tha hadithin e tij të njohur për llojet e leximeve të Kuranit, se “Kurani është zbritur në shtatë harfe (lloje leximesh, dialektesh, kiraetesh).” Mirëpo, meqë sahabët ishin nga fise të ndryshme arabe, ata kishin edhe dialektet e tyre me të cilat dalloheshin nga fiset tjera - si në zgjatje të fjalëve, në anim, në hemze e tjera, me të cilat veçohet edhe vetë gjuha arabe.

Kështu, pra, edhe sahabët kur e lexonin Kuranin, e lexonin në dialektin e tyre, të cilin lexim ua dëgjonte edhe vetë Muhamedi (alejhis-selam), por e pranonte, meqë urdhrin dhe tolerancën nga Allahu mëshirëplotë e kishte për “shtatë

harfe” (lloje leximesh, dialektesh).

Për këto shkaqe në mesin e sahabëve lindi “ihtilafi” (ndrysheshmëria) në leximin e Kuranit fisnik dhe ajetet apo tërësinë e ajeteve ua mësonin atyre që prezantonin edhe atyre që nuk prezantonin, kurse e gjithë kjo ndodhte me urdhër dhe udhëzime të Muhamedit (alejhis-selam). Ata, pra sahabët, që të gjithë e mësonin Kuranin fisnik përmendsh - një numër i tyre, që në kohën e Muhamedit (alejhis-selam), si: Aliu radijallahu-anhu (v. 40 h.), Othmani radijallahu-anhu (v. 35 h.), Zejd ibn Thabiti radijallahu-anhu (v. 45 h.), Ubej ibn Ka’bi radijallahu-anhu (v. 32 h.), Abdullah b. Mes’udi radijallahu-anhu (v. 32 h.), Ebu Musa el Esh’ariju radijallahu-anhu (v. 44 h.) dhe Ebu Darda Urejmir b. Zejdi radijallahu-anhu (v. 32 h.). Këta hafëzë të Kuranit pas vdekjes së Muhamedit (alejhis-selam) bënë që të jenë mësuesit më themeltarë për mësimin e Kuranit fisnik dhe **kurratë** (lexuesit) më të njohur të kohës që jetonin.

Kjo periudhë ka vazhduar deri në gjysmën e parë të shekullit të parë hixhri, kur edhe në v. 45 h. vdiq Zejd bin Thabiti, radijallahu anhu, sahabiu i fundit nga këta.

Përpara se të kalojmë tek llojet e kirâteve, duhet të përmendim kriteret mbi të cilat bazohet kjo shkencë. Si çdo informacion tjetër i transmetuar, edhe kirâetet kanë kushtet e kriteret e tyre për të qenë lexime të pranuar. Ato janë si më poshtë:

1 – Zinxhir i saktë i transmetimit, sepse kirâetet janë sunnet i pasueshëm. Ato nuk mund të ndryshojnë sipas logjikës së njeriut, por lexohen e transmetohen ashtu siç janë shkruar e përcaktuar më parë.

Në lidhje me këtë Zejd b. Thâbiti shprehet kështu: “Kirâetet janë sunnet.” El-Bejhâki e zgjeron këtë shprehje, duke i shtuar edhe fjalën: “i pasueshëm” dhe jep sqarimet e duhura në lidhje me çështjen.

2 – Përputhje me shkri-min e njërës prej mus’hafeve të shumëzuara nga Hz. Osman (r. a.). Këtu duhet pasur parasysh që pikat, **haretë** (zanoret) dhe shkronjat zgjatëse, të cilat ne i shohim

në Kuranet e sotme, atëherë nuk shkruheshin.

3 – Përputhje, qoftë edhe në një këndvështrim me rregullat e gjuhës arabe.

Ibn el-Xhezeri thotë që çdo kirâet që përputhet me gjuhën arabe, me një nga mus’hafet e Osmanit (radijallahu-anh) dhe që ka një transmetim të shëndoshë, është kirâet i saktë dhe nuk lejohet refuzimi apo përgënjeshtrimi i tij. Ai është prej shtatë shkronjave me të cilat zbriti Kurani dhe ummeti e ka për detyrë ta pranojë atë - qoftë ose jo prej shtatë ose dhjetë imamëve të pranuar. Nëse njëri prej këtyre kriterëve nuk plotësohet, atëherë kirâeti është i papranueshëm. Ai quhet *daif* (i dobët), *shâdh* (i pasaktë) ose *bâtil* (i pavlefshëm), qoftë edhe prej shtatë imamëve të pranuar apo të ndonjë imami më të madh.

Në bazë të këtyre kriterëve është bërë edhe klasifikimi i kirâteve dhe dijetarët i kanë klasifikuar kirâetet në gjashtë lloje:

1. Muteuâtir: Quhet kirâeti i transmetuar prej një grupi personash, të cilët

e kanë të pamundur të unifikohen në gënjeshtëri. Shumica e kirâteve janë kështu.

2. Mesh’hûr: Kirâeti me transmetim të saktë, por që nuk arrin gradën e muteuâtirit, përputhet me gjuhën arabe dhe me njërin prej mus’hafeve të Osmanit (radijallahu –anh), është i njohur mes dijetarëve të kirâetit dhe nuk ka asnjë tipar fals apo jokorrekt.

3. Âhâd: Kirâeti me transmetim të saktë, por që nuk përputhet me gjuhën arabe ose me njërin prej mus’hafeve të Osmanit (radijallahu-anh), ose nuk është i njohur ashtu si kirâeti mesh’hûr.

4. Shâdh: Kirâeti me transmetim të pasaktë.

5. Meudû: Kirâeti pa një origjinë.

6. Mudraxh: Quhen fjalët e shtuara prej sahabëve në tekstin e Kuranit, me qëllim shpjegimi e tefsiri. P.sh., në mus’hafin e Ibn Abbâsit (radijallahu-anh), ajeti i 198 i sures Bekara është i shënuar kështu: Në këtë ajet pjesa e nënvizuar normalisht nuk përfshihet në tekstin e Kuranit, por Ibn Abbâsi (radijallahu-anh) e ka shtuar në formë shpjegimi.

Katër llojet e fundit të kirâteve nuk përdoren në leximin e Kuranit, qoftë në namaz apo jashtë tij.

Mirëpo, sot dijetarët islamë akoma i ruajnë dhe i mësojnë të dhjetë kirâetet e më shumë, kështu që ato kirâete akoma jetojnë në qarqet shkencore.

Në bazë të kësaj që thamë deri më tani, sot myslimanët e rëndomtë nuk i dinë këto kirâete se janë *mutevatir*, prandaj mund të gabojnë njëri ndaj tjetrit duke u akuzuar gabimisht nga injoranca me qufër apo diçka tjetër. Një gabim i këtillë ka ndodhur në kohën e Othmanit (radijallahu-anhu), në betejën e Armenisë dhe Azerbajxhanit, kur myslimanët nuk gjenin mus’haf të lehtë për ta lexuar dhe për ta kuptuar.

Kurse libra për kirâete kemi mjaft, nga të cilat ndër më të njohur janë: “Es Seb’atu fil Kiraati” i Ebu Bekr b. Muxhahidit, “En Neshru fil Kiraatil ashri” i Ibnul Xhezeri-ut, “It’hafu fudalâil beshar bil Kiraatil arbeati asher” i Benna ed Dimjati-ut etj. Meqë këto vepra gjenden rrallë dhe vetëm nëpër qarqet shkencore, myslimanët e rëndomtë nuk i gjejnë lehtë.

(Fusnotat, hequr nga Redaksia)

(Vazhdon)

DISPOZITA E VEPRIMIT ME HADITH TË DOBËT (1)

Shkruan: Melek Bislimi



HYRJE

Përkufizimi i hadithit daif

Hadith daif (i dobët) do të thotë: hadithi, i cili nuk i plotëson kriteret e hadithit që është i pranuar siç është hadithi sahih¹ dhe hadithi hasen². Hadithi daif apo i dobët, i cili refuzohet, kryesisht ndahen në dy lloje:

1. Hadithi i dobët për shkak të këputjes transparente të senedit, përkatësisht të këputjes së fshehtë të senedit.

2. Hadithi i dobët për shkak faktorëve të tjerë që ndikojnë negativisht në brendi të hadithit.³


Në këtë punim do të flitet rreth disa çështjeve që kanë të bëjnë me hadithin

daif, pastaj do të flitet rreth qëndrimit, respektivisht konstatimeve të dijetarëve në lidhje me të vepruarit me hadithin daif.

DOBËSIA (DA’FI) NDRYSHON PREJ NJËRIT HADITH TË DOBËT NË TJETRIN

Nga ajo që shënuam më parë, kur përkufizuam hadithet daif, kuptohet se hadithet daif nuk janë të një rangu, respektivisht ato janë disa lloje. Ka prej haditheve që janë shumë të dobëta, siç është hadithi metruk (metruh), ndërsa disa hadithe të tjera janë më të larta se ato, që nënkupton se ato janë më të mira dhe më të forta se hadithi metruk.

Dobësia në hadithet daif është sipas dobësisë së transmetuesit - nëse transmetuesi është tepër i dobët, atëherë edhe hadithi është shumë i dobët, nëse transmetuesi është më pak i dobët, atëherë edhe hadithi është më pak i dobët, kështu që ndonjë hadith është më i dobët sesa hadithi tjetër. Kjo është ngjashëm sikur në hadithin sahih (të saktë), sepse ekziston hadith sahih (i saktë), por ka hadith esah (më të saktë). Po ashtu dijetarët, ashtu siç kanë folur në lidhje me zinxhirët më të saktë (esah esanid), ata kanë folur edhe për zinxhirët më të dobët (evha-ed’af esanid). Kurse dobia e ndarjes së zinxhirëve (senedeve) në sened të saktë dhe në sened të dobët është që disa



senedeve t'u jepet përparësi ndaj senedeve të tjera, të bëhet e qartë dhe të dihet se cilin sened duhet pranuar dhe cilin nuk duhet pranuar.⁴

DISPOZITA E TË VEPRUARIT ME HADITHIN DAIF

Dijetarët në lidhje me të vepruarit me hadithin daif kanë tre qëndrime, respektivisht tre medhhebe.

Mendimi i parë

Dijetarët e medhhebit të parë janë të mendimit se lejohet të vepruarit me hadithin daif në mënyrë absolute, pa ndonjë kushtëzim. Ky mendim u përshkruhet Ebu Davudit dhe Imam Ahmedit dhe se ata janë të mendimit se hadithi daif është më i fuqishëm dhe më i fort sesa mendimi i burrave (dijetarëve).⁵

Transmetohet se Ebu Davudi ka thënë: “Nga Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi vesel-lem) i kam shkruar pesëqind mijë hadithe, prej të cilëve në brendinë e këtij libri i kam zgjedhur 4.800. Kam tubuar në të hadithe të vërteta (sahiha), të ngjashëm me to dhe që iu afrohen atyre. Nuk kam theksuar (nuk kam përmendur) në këtë libër timin ndonjë hadith për të cilin dijetarët islamë kanë thënë se duhet hequr dorë nga ai. Nëse hadithi ka ndonjë dobësi, e kam sqaruar atë; gjithashtu, kam theksuar senedin (zinxhirin) e atij hadithi që nuk vlen; e nëse nuk kam thënë asgjë, atëherë hadithi është i vlefshëm (sahih-i saktë), pra sahih; disa hadithe janë më të vërtetë se disa të tjerë.”⁶

Mendimi i dytë

Dijetarët e këtij medhhebi janë të mendimit se me hadithin daif veprohet në veprat e mira (ar. fedailul e'amali), këshilla (ar. vaidh) dhe ngjashëm me to, nëse këto hadithe i plotësojnë disa kushte. Kushtet që duhet t'i plotësojë hadithi daif për të vepruar me të, për disa nga ato kushte dijetarët janë unanimë, por për disa ata kanë kundërtënie. Në vazhdim do t'i shënojmë këto kushte:⁷

Hadithi daif të ndërlihet me veprat e mira (ar. fedailul e'mali) الفضائل في كونه. Për këtë kusht të gjithë dijetarët janë në ujdi, sepse tolerohet të veprohet me hadithin daif në veprat e mira. Kurse me këto hadithe nuk veprohet në akide dhe në çështjet e hallallit dhe të haramit. Sa u përket çështjeve të hallallit dhe të haramit, dijetarët janë të mendimit se me këtë është për qëllim vetëm farzi (vaxhibi) dhe harami (mekruh tehrimen), ndërsa sunneti, mekruhi tenzihen dhe mubahu (lejimi) nuk përfshihen me këto shprehje (hallall dhe haram), sepse sunneti, mekruhi dhe mubahu janë prej veprave gojore apo

praktike të mira. Mu për këtë Imam Neveviu në fillim të veprës së tij “El-edhkar” thotë: “Sa u përket dispozitave siç janë hallalli dhe harami, shitblerja, kurorëzimi (nikahi), shkurore zimi dhe ngjashëm me këto, në dispozitat e tilla nuk veprohet përveçse me hadith sahih (të sakët), apo hadith hasen, përveç nëse hadithi i tillë është si masë preventive dhe rezervë (ar. ihtjat), si për shembull nëse transmetohet ndonjë hadith daif, i cili bën të urreyer disa shitblerje apo disa kurorëzime (nikahe).”⁸

Mos të jetë hadith mevdu أن لا يكون موضوعاً. Edhe për këtë kusht të gjithë dijetarët janë njëzërit.

Dobësia (da'fi) të mos jetë e madhe dhe e fortë لا يشتد ضعفه. Për këtë kusht dijetarët mes tyre kanë kundërtënie: disa e kushtëzojnë këtë, madje dijetarët thonë se ky është qëndrim unanim i të gjithë dijetarëve. Në këtë grup bien ata që vetëm një transmetues e transmeton atë hadith dhe janë të akuzuar (ar. muttehem), apo njihet se ai bën gabime të mëdha (të rënda, ar. men fehisha gallatuhu).⁹

Mirëpo, disa dijetarë janë të mendimit se për këtë kusht të gjithë dijetarët nuk janë të një mendimi, sepse ekzistojnë raste praktike kur disa dijetarë kanë vepruar me këtë lloj të haditheve.¹⁰ Muhamed Avvame në veprën e tij *Hukmul ameli bil hadithid daifi* 80-104, sjell emrat e dyzet (40) dijetarëve, të cilët në veprat e tyre kanë shënuar hadithe të këtij lloji. Në këtë punim modest do të shënojmë emrat e disa prej tyre.

- Imam Abdulla ibni Mubarek, në veprën e tij “Ez-zuhd verr-rekaik “ dhe “El-birru ves siletu البر الوصل”.

- Imam Ahmed ibni Hanbel, i cili vepron me hadithin daif në mënyrë absolute, pa ndonjë kushtëzim (siç kemi shënuar pak më parë). Imam ibni Tejmijje në “Mexhmu el fetave” 18/72 ka thënë: “Libri Ez-zuhd الزهد” i Imam Ahmedit nuk përfshin në vetvete hadithe dhe tregime të trilluara (mevdu, të sajuara), ai nuk përmend (nuk shënon) në veprat (musafnefatet) e tij nga ata që janë të njohur me trillimin dhe sajimin (ar. medu). Por, mund të gjendet në veprat e tij ndonjë (hadith) për shkak të keqmbajtjes mend (ar. su-ul hidhi, i dobët në mbajtjen mend të hadithit) të transmetuesit të hadithit. Po ashtu, gjenden (hadithe) merfua, në të cilat nuk dihet se me këto hadithe (transmetuesit) kanë pasur për qëllim të gënjejnë në hadithet e tilla. Një gjë e tillë nuk gjendet edhe në musnedin e tij; në të gjendet (hadith daif), por nuk dihet se ai ka gabuar (Imam Ahmedit), por në

atë kanë gabuar transmetuesit e tij (të hadithit).”

-Imam Buhariu në veprën e tij “El-edebul mufred المفرد” në fund të kapitullit “Birrul validejni” ka transmetuar një hadith nga Ebu Idam Sulejman ibni Zejd Muharibi, nga Abdulla ibni Ebu Evfa, i cili është hadith merfu “إن الرحمة لا تنزل على قوم فيهم” قاطع رحم Vërtet mëshira (e Allahut) nuk zbret mbi një popull derisa në mesin e tyre gjendet ndonjë që e ka ndërpre afërsinë (afërmitetin).”

Në lidhje me Ebu Idamin (transmetuesin e hadithit), Ibnii Meini ka thënë: Nuk është i besueshëm (ليس) (كذاب), është gënjeshtar (كذاب), hadithi i tij nuk vlen asnjë sa një fels (den, cent). Kurse Nisai për këtë transmetues ka thënë: “Nuk është i besueshëm”. Ngjashëm me këta janë shprehur edhe disa dijetarë të tjerë.

-Imam Ebu Abdulla ibni Maxheh, autori i “Es-sunen”, i njohur si Suneni i Ibni Maxhes, ku ai ka shënuar hadithe të këtij lloji; ndër ato hadithe janë edhe hadithi nr 1173-1174, të cilët tregojnë për namazin “Evvabin”, i cili falet mes akshamit dhe jacisë. Në lidhje me këtë Hafidh ibni Haxher në “Tehdhib tehhib” ka thënë: “Libri i tij (Ibni Maxhes) në lidhje me sunnetin është përmbledhës i mirë, në të ka shumë kapituj dhe çudira, në të ka hadithe shumë të dobëta.”¹¹

-Imam Muhamed ibni Nasr Meruzi, i cili është njëri nga dijetarët e kritikës (së shkencës së hadithit, ar. nakd, nakid), autor i disa veprave, ndër ato “Kijamullejl الليل قيام” dhe “Es-sunne السنة” dhe “قدر الصلاة تعظيم” قدر الصلاة تعظيم, për këto vepra Muhamed Avvame thotë se, në këto vepra kam gjetur hadithe që janë shumë të dobëta, 176 hadithe që i ka transmetuar Isa ibni Ebu Isa Hannat, 181 hadithe i ka transmetuar Eban ibni Ebu Ajjash, 220 hadithe i ka transmetuar Jezid ibni Ebu Zijad Kureshi dhe tre hadithe metruk.¹²

-Imam Ebu Amr Bezzar, i cili transmeton një hadith nga Aisheja, nga babai i saj Ebu Bekr (r. a.) nga El-Hakem ibni Abdulla el-Ejlj, hadith ky që ka të bëjë me larjen e borxhit. Në lidhje me këtë hadith Bezzari thotë: “El-Hakem është shumë i dobët, porse ne e kemi shënuar këtë hadith, sepse ne nuk kemi mësuar për këtë nga ndonjë tjetër (transmetues), por këtë hadith njerëzit e kanë folur (transmetuar) ashtu siç është.” Ibni Haxheri në veprën e tij “Lisanul mizan”, kur shënon biografinë e El-Hakemit, shënon se ai nga shumë dijetarë është cilësuar si gënjeshtar. Kurse tek Imam Buhariu është metrik.¹³



-Imam Ebu Bekr ibni Huzejme, i cili ka shënuar disa hadithe shumë të dobëta, sa për ilustrim do të shënojmë disa nga ato.¹⁴

Në kapitullin se është e urreyer të përdoret ujë i tepërt gjatë marrjes së avdesit dhe është mustehab që të merret avdes me aq ujë sa ka nevojë, ai shënon hadithin nr. 122 nga Harixhete ibni Mus'ab, nga Junus, nga Hasen, nga Utbijji ibni Damrete, nga Ubej ibni Ka'b (r. a.), i cili është hadith merfu. Kurse Harixhete ibni Mus'ab është metruk (i lënë, i braktisur), megjithatë ai (Ibni Huzejme) me hadithet e tij (Harixhete) shënoi tre kapituj në lidhje me edukatën (etikën) e marrjes së avdesit. Ndërsa ai për këto hadithe nuk tregoi as në mënyrë direkte dhe të qartë e as me ndonjë shenjë se janë hadithe të dobëta. Këtë si duket ai nuk e kishte bërë, sepse ai mendon se këto hadithe kanë të bëjnë me eduket (etikë).

Në kapitullin përmendja (shënimi) e argumentit se **Bismil-lahirrrahmanirrahim** është pjesë (ajet) prej sures El-Fatiha, ai shënon hadithin nr. 493, të cilin e transmeton Ummi Selmete (r. a.), se Pejgamberi (a. s.) **Bismil-lah**-in e kishte lexuar në namaz, kështu që ai e kishte konsideruar ajet (të sures El-Fatiha). Ndërsa në zinxhirin e këtij hadithi gjendet Omer ibni Harun Belhij, ndërsa ky është metruk (i lënë, i braktisur), por edhe pse ky transmetues është metruk, Ibni Huzejme nuk e kishte përmendur se ai është metruk - as në mënyrë direkte, as me ndonjë shenjë.

Në kapitullin vlerat e muajt të Ramazanit, në lidhje me vlerat e këtij muaji të bekuar ai shënon hadithin nr.

1887, të cilin e transmeton Selman Farisiji, në të cilin thotë se ditën e fundit të muajit Shaban neve Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi vesel-lem) na mbajti një fjalim, në të cilin mes tjerash tha: أيها الناس قد أظلمكم شهر عظيم O ju njerëz, vërtet juve ju ka mbuluar (ka ardhur, ka prezantuar) një muaj i madh...” Në zinxhirin (senedin) e këtij hadithi gjenden Jusuf ibni Zijad dhe Ali ibni Xhud'an; Jusufi është shumë i dobët, ndërsa Ibni Xhud'ani afër këtij.

Kurse Imam Mundhiriu në veprën e tij “Et-tergib vet-terhib” vetëm Ali ibni Xhud'anin e konsideron si të dobët.¹⁵

-Imam Ebu Kasim Taberaniju. Autor i shumë veprave. Nuk i përshkruhet se ai në veprat e tij është bazuar në hadithe të dobëta, e lëre me në hadithe shumë të dobëta, përveç në librat e tij “الدعاء-Lutja”.

Recensenti i kësaj vepre, dr. Muhamed Seid Buhariu, thekson se në këtë vepër gjenden 378 hadithe të dobëta, 166 hadithe shumë të dobëta. Dhe në veprën “مكارم الاخلاق-Sjelljet e bukura”, në të cilën gjenden hadithe të dobëta dhe shumë të dobëta, sa për ilustrim hadithet nr. 1, 10, 26, 27, 28, 41, 140, 248, 249 dhe 250.¹⁶

-Imam Ebu Bekr ibni Sunnij, në veprën e tij të njohur “اليوم والليلة عمل - Të vepruarit gjatë një dite dhe një nate”, shënon hadithe sahiha (të sakta), por edhe jo sahiha dhe shumë të dobët. Si për shembull, hadithi nr. 310, të cilin e transmeton Husejn ibni Alvan, hadithin nr. 313 të cilin e transmeton Is'hak ibni Jahja ibni Talha Temimi, hadithin nr. 315 të cilin e transmeton Jahja ibni Ubejdil-lah ibni Abdulla ibni Mevheb

dhe shumë të tjerë, të cilët janë metruk (të lënë).¹⁷

-Imam Bejhakiju - Edhe në veprat e këtij imami gjenden hadithe të dobëta. Ndër veprat e tij që përfshijnë hadithe të dobëta janë këto vepra; “شعب الإيمان Pjesët e Imanit”, “فضائل الاوقات Vlerat e kohëve” dhe “المدخل إلى دلائل النبوة-Hyrje në shenjat e pejgamberllëkut”.¹⁸

-Imam Abduladhim ibni Abdulkavij Mundhiriju, në veprën e tij të njohur “الترغيب والترهيب”.

-Imam Neveviu, i cili në hyrje të veprës së tij të njohur “الانكار -Përmendjet (dhikret)”, thekson qartë se lejohet të vepruarit dhe është mustehab të veprohet me hadithin daif, derisa nuk është hadith mevdu.¹⁹

-Imam Ibni Tejmijje në veprën e tij “الكلم الطيب - Fjalët e bukura”. Këtë vepër, pasi që e kishte korrigjuar Nasiruddin Albani dhe kishte dhënë vlerësimin e tij mbi hadithet që i përfshin kjo vepër e Ibnii Tejmijes, Albani kishte konstatuar se në këtë vepër gjenden 5 hadithe mevdu, 8 hadithe shumë të dobëta dhe 41 hadithe të dobëta. Pastaj Albani këto hadithe i kishte fshirë dhe hequr nga kjo vepër dhe e kishte emëruar “صحيح الكلم الطيب”.²⁰

-Imam Ibni Dekikul-idi në veprën e tij “إحكام الأحكام -Përforcimin e dispozitave”, në të cilën gjenden hadithe të dobëta (daif), por jo hadith mevdu.²¹

-Imam Ibni Kethir, gjatë komentimit të ajetit të tridhjetë (30) të sures En-Nur, ku ajeti flet për të ulurit të shikimit (mosshikimi, largimi i shikimit) ndaj femrave. Në lidhje me mosshikimin ndaj femrave të huaja, Ibni Kethiri ka

shënuar disa hadithe, nga Umamate, Ibni Omeri, Hudhejfeja dhe nga Aisheja (r. a.) dhe pastaj ai thotë se “në senedet (zinxhirët) e tyre ka dobësi (da’f), porse kjo ka të bëjë me ngjallje dëshire (ar. tergib, joshje) dhe në gjëra të tilla tolerohet”.²²

(Punimi, që do të jepet në disa vazhdimë, është temë diplome e autore në FSHI. Për botim është redaktuar nga Jusuf Zimeri.)

¹ Sahih quhet hadithi që ka senedin e pandërprerë, që e ka deri në fund vargun e transmetuesve të pandërprerë, që është i transmetuar nga transmetuesi i drejtë dhe i përpiktë, po ashtu ky duhet ta ketë transmetuar hadithin nga transmetuesi i drejtë dhe i përpiktë, me kusht që hadithi të mos ishte i vetmuar në transmetim dhe të mos kishte ndonjë mangësi.

² Hasen quhet hadithi që ka senedin e ngjitur (të pakëputur), që është i transmetuar nga transmetuesit e drejtë, por jo edhe aq të përpiktë, i pastër nga të metat dhe dobësitë.

³ Faredin Ebibi, *Terminologjia e shkencës së hadithit*, Shkup, 2015 / 1436, fq. 192. Bejadin Ameti, Ndarja e Hadithit, Shkup, 2013 / 2014, fq. 54. Hamza Hasani, *Ulumul Hadith për vitin e tretë*, Shkup, 2014, fq. 69. Muhamed Uxhaxh, el-Hatib, El-Vexhiz *fi ulumil-l-hadithi ve nususihi*, Matbaatul xhedide, Damask, 1401-1402 / 1981-1982, fq. 311. Ibnii Salah, *mukaddimetu Ibni salah, fi ulumi-l- hadithi*, (harrexh nusuhah ve al-laka alejhi, Mustafa Dib Buga), mektebetul farabi, Damask, 1404h - 1984m, fq. 25. Qazim Qazimi, *Shkenca e hadithit dhe terminologjia e saj*, Prishtinë,

1993, fq. 91. Rushit Musallari, *Njohuri themelore të shkencës së hadithit*, Ardhmëria, Shoqatë Kulturore, fq. 83.

⁴ Muhamed Axhxhaxh Hatib, El-vexhiz *fi ulumil hadith*, matbaa xhedide, Damask, 1981-1982, fq. 323. Es-sujuti, Hafidh Xhelaluddin Abdurrahman, *tedriburr-ravi fi sherhi tekribun nevani*, mektebetu darut turathi, Kajro, 1973, fq. 106.

⁵ Muhamed Axhxhaxh Hatib, El-vexhiz *fi ulumil hadith*, matbaatul xhedide, Damask, 1401-1402 / 1981-1982, fq. 325. Es-sujuti, Hafidh Xhelaluddin Abdurrahman, *tedriburr-ravi fi sherhi tekribun nevani*, mektebetu darut turathi, Kajro, 1973, fq. 1196. Taberani, El-hafidh Ebi Kasim Sulejman ibni Ahmed Ibni Ejub Lahmij, *El-mu'xhemus sagir litaberanijji*, pjesa e dytë. Bashkëngjitur veprës Risaletu gun'jetul elmeiji, të autorit El-Hafidh Ebi Tajjib Shemsulhakkiladhimu Abadi, Darul kutubul ilmijje, Bejrut, fq. 188-189.

⁶ Sunen Ebu Davud, përkthyer nga arabishtja Irfan Abazi, Taxhedin Bislimi, Farudin Ebibi, Jusuf Zimeri, botues Furkan ISM, Shkup, 1/09.

⁷ Muhamed Axhxhaxh Hatib, El-vexhiz *fi ulumil hadith*, matbaatul xhedide, Damask, 1401-1402 / 1981-1982, fq. 325. Es-sujuti, Hafidh Xhelaluddin Abdurrahman, *tedriburr-ravi fi sherhi tekribun nevani*, mektebetu darut turathi, Kajro, 1973, fq. 196. Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h-2017 m, fq. 77.

⁸ Imam Nevevi, Muhjiddin Ebi Zekerija Jahja ibni Sherf, El-edhkar, mektebetul mutenebi, Kajro, 07.

⁹ Muhamed Axhxhaxh Hatib, El-vexhiz *fi ulumil hadith*, matbaatul xhedide, Damask,

1401-1402 / 1981-1982, fq. 325. Es-sujuti, Hafidh Xhelaluddin Abdurrahman, *tedriburr-ravi fi sherhi tekribun nevani*, mektebetu darut turathi, Kajro, 1973, fq. 196. Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h-2017 m, fq. 80.

¹⁰ Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h-2017 m, fq. 80-104.

¹¹ Ibni Haxher, Shihabuddin Ebu Fadl Ahmed Ibni Ali, *Tehdhibut tehdhib, nashir*, darul kitab islami, Kajro, fq. 9/531.

¹² Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h-2017 m, fq. 86.

¹³ Po aty, 86.

¹⁴ Po aty, 87.

¹⁵ Imam Mundhirijju, Imam Hafidh Zekijuddin Abduladhim Ibni Abdulkavij, *Et-tergib vet-terhib minel hadithi sherif*, daru ihjaut turathil arabij, Bejrut, 1388 h-1968 m, 2/96.

¹⁶ Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h-2017 m, fq. 89.

¹⁷ Po aty, 90.

¹⁸ Po aty, 91.

¹⁹ Imam Nevevi, el-edhkar, 07.

²⁰ Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daif*, i bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h-2017 m, fq. 95.

²¹ Po aty, 95.

²² Po aty, 56.



MUHAMED HÛSREV/AYDINLI (1884-1953)



Dijetar islam i periudhës së vonshme

Muhammed Hüsrev (Aydnlar) është lindur në fshatin Labënisht (Labunisht) të Strugës, në Maqedoninë e sotme. Ai i përket një familjeje me origjinë shqiptare dhe babai i tij është Nûman efendi.

Pasi kreu arsimin fillor në fshatin e tij, studioi në Ohër dhe Tiranë për një vit e gjysmë.

Ai shkoi në Stamboll në vitin 1910 dhe hyri në Medresenë Üçbaş, në Karagüm-rük. Mori mësim nga mësues si Rebi Molla, Ahmed Efendi nga Kastamonu, Hafiz Hasan nga Tavas dhe İsmail Hakkı nga Izmiri. Pastaj u regjistrua në Medresenë Süleymaniye, ku u diplomua në degën e tefsirit dhe të hadithit në vitin 1919. Më vonë u emërua si ligjërues dhe si mësues i gjuhës arabe në Medresenë İbtida-i Hâric.

Hüsrev Hoxha vazhdoi shërbimet e tij me nder pas mbylljes së medreseve dhe heqjes së profesionit të mësuesit pas Republikës. Mirëpo, me pretekstin e kthimit në vendlindje, doli jashtë shtetit dhe u vendos në Medinë (1936); por, një vit më vonë u kthye në Stamboll për shkak të gjendjes shëndetësore të familjes.

Ai vazhdoi të jepte mësim aty, me gjithë presionet që kishte. Për Hüsrev Hoxhën, i cili herë pas here mbante predikime në Xhamitë Hocaşaşa dhe Camialti, rrëfehen legjenda rreth këmbënguljes dhe vendosmërisë së tij për të vazhduar edukimin e vet fetar dhe për të thënë atë që mendon se është e drejtë. Ai dha lëndë profesionale për dy vjet, që nga hapja e shkollës Imam-Hatip të Stambollit.

Vdiq më 23 prill 1953 në Stamboll. Varri i tij ndodhet në varrezat Edirnekapi Sakızağacı.

Hüsrev Hoxha, i cili u kishte dhënë më shumë se tridhjetë vjet mësim studentëve



në të gjitha nivelet në Xhaminë Fatih dhe në shtëpi, edukimin e studentëve e ka konsideruar si një formë adhurimi. Sipas njërit prej nxënësve të tij, Yaşar Tunagür, kur iu ofrua pushimi për shkak të ecurisë së sëmundjes dhe shikimi i tij ishte shumë i ulët, ai shprehu justifikimin e tij se nuk e lë klasën me dëshirën e vet dhe kërkoi falje nga Allahu, ndërsa tri ditë më vonë vdiq.

Veçanërisht në vitet 1940-1950, gjatë periudhës së represionit të ashpër ndaj jetës fetare dhe edukimit fetar, ai u përpoq ta mbante gjallë jetën fetare, duke dhënë mësim me guxim. Nga ana tjetër, i dha mbështetje të madhe edukimit fetar dhe përgatiti nxënës të vlefshëm. Salih Şeref, Abdülhalim Akkul, imami dhe predikuesi Hüseyin Karagözoğlu, Mahmut Bayram, një nga nënkryetarët e Presidencës së Çe-

shtjeve Fetare Yaşar Tunagür, një nga ish-myftinjët e Akdağmadeni Sadık Fidancı dhe inxhinieri i diplomuar H. İsmail Turan janë disa nga studentët e tij.

Hüsrev Hoxha luftoi vetëm për hir të besimit të tij. Nuk priste asnjë kompensim material për shërbimet që mori dhe nuk ndoqi famën.

Në hyrje të veprës së tij Risâletü'l-me-vâhibi'l-ilâhiyye, ai përmend se librin e ka shkruar në kohë të vështira. Shkrimtari i veprës dhe nxënësi i mësuesit, Erzurumlu Mustafa Necati Efendi, vëren se derisa po shkruante librin e tij, gruaja e Hüsrev Efendiut ndërroi jetë, shtëpia e tij u dogj me librat e tij dhe u dëgjjuan të shtënat e armikut që po i afrohej Stambollit.

Me gjithë këto halle dhe pamundësi, ai gjatë gjithë jetës jetoi një jetë të pavarur, gjë që tregon karakterin e tij të lartë dhe



Me shokun dhe ish-medresantin e Alaiddinit, aktualisht afarist i mirënjohur në Çarshinë e Shkupit, z. Fatmir Imeri, udhëheqës i restorantit "Pçella". Prof. Fatmir Imeri është nga fshati Pirok (Tetovë) dhe me të kemi qenë bashkë në Prishtinë. Ka punuar shumë vite si mësimdhënës në shkollat e mesme në Gostivar. Mbete i kënaqur me sukseset e tij në biznesin që po zhvillon. Biseduam për shumë çështje. Përkujtuam jetën e Medresës në Prishtinë, edhe pse ai ishte dy gjenerata para meje. E falënderova për pritjen vëllazërore-ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në Facebook. (6.06.2022)

karakterin solid. Ai u përpoq të siguronte bukën e gojës duke shitur perimet që i kultivonte në kopshtin e shtëpisë së vet. Paratë e nevojshme për shpenzimet e varimit nuk u gjetën as në familjen e tij dhe as te studentët e tij. Një punonjës policie nga komuniteti i tij i mbuloi shpenzimet me bonusin e pensionit që mori atë ditë dhe më pas nuk i pranoi paratë e dhëna nga studentët e tij dhe i dha për familjen e Hüsrev Hoxhës.

Vepra e vetme e Hüsrev Hoxhës është në arabisht dhe mban emrin Risâletü'l-mevâhibi'l-ilâhiyye (Biblioteka private Bekir Topaloğlu, nr. 86). Në hyrje të veprës autori thekson se profesorët e Medresetu'l-muh-tehassisin-it i kërkuan që të bënte një studim për provën e shpirtit dhe për këtë arsye ai i kërkoi të merrte ajetin e 21-të të kaptinës El-Bekare dhe atë ta interpretojë së bashku me lidhjet e saj usul, furu dhe hadith.

Vepra përbëhet nga dy pjesë kryesore, pas një hyrjeje që jep të dhëna për tefsirin dhe te'vilin. Kapitulli i parë është ndarë në tre pjesë dhe në kapitullin e parë janë përfshirë hadithet për pozitën superiore të Kuranit në fenë islame dhe virtytin e leximit, të mësimin dhe të mësimdhënies kuranore.

Kapitulli i dytë u kushtohet disa transmetimeve të cilat i kritikojnë ata që përpiqen të interpretojnë Kurandin pa e ditur atë dhe e harrojnë atë pasi e kanë mësuar përmendsh. Kapitulli i tretë, ndërkaq, i kushtohet koleksionit të Kuranit, renditjes së tij dhe shtatë shkronjave të tij.

Pjesa e dytë e veprës fillon me shpjegimin e rëndësisë dhe metodës së njohjes së ajeteve mekki dhe medani. Pastaj, fjalët e sures El-Bekare: "O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i cili ju krijoi ju dhe ata para jush. Shpresojmë që të jeni të mbrojtur në këtë mënyrë", dhe kalohet tefsiri i ajetit 21. Në këtë pjesë, e cila është 100 faqe, fillimisht është tentuar të shpjegohet ajeti me metodën e mprehtësisë, pastaj ajeti është shpjeguar me metodën e transmetimit, pastaj sahabët dhe tabiinët, të cilët ishin të famshëm në fushën e tefsirit, dhe janë përmendur ata që kanë shkruar tefsir përmes transmetimit. Ndërkohë, interpretimi mistik i ajetit u bë duke prekur kufijtë legjitimë të interpretimit të Kuranit me metodën mistike.

Në pjesën tjetër të librit përmendet nevoja e interpretimit të Kuranit dhe e shkencave të nevojshme për dijetarët që do ta bëjnë këtë punë, pastaj hadithet që kanë të bëjnë me parimin e teuhidit, të shprehur në këtë ajet, vlerësimi i isnadit të tyre në aspektin cerh dhe ta'dil, ndërkaq diskutohet se disa nga (lexime) cerh dhe ta'dil janë prekur rregullat.

Në faqen e fundit të veprës (fq. 152) data e të drejtës së autorit është 8 Cemâziyelevvel 1337 (9 shkurt 1919) dhe data e kopjimit është 1359 (1940). Është raportuar se Risaletü'l-mavâhibi'l-ilâhiyye tregon njohuritë e autorit të tij në gjuhën arabe dhe njohuritë e tij në letërsinë tefsir.

Fakti që suksesi i Hüsrev Hoxhës në fushën e të drejtës së autorit në fillimet e jetës së tij shkencore nuk vazhdoi edhe në vitet në vijim duhet të ketë qenë për shkak të mungesës së kushteve të qeta dhe të qëndrueshme të jetës dhe theksimit të tij në arsim dhe trajnim.

Burimi: Enciklopedia Islame e Dijanetit, Bekir Topaloğlu, Biblioteka private.

Përktheu nga turqishtja: Musanif Rufati

SHKAQET E THELLA TË FETARËSISË IMORALE



Stili i saj: duke bërë një Umre, apo një Haxh ekstra dhe ultra-luksoz, mund "t'i falësh të gjitha mëkatet" (apo rrezillëqet).

Nga Prof. dr. Mustafa Çağrıci

Që nga fundi i shekullit II Hixhri, kur filluan të formoheshin shkencat islame, ulemaja 'moralin/etikën' e përfshinte në mesin e shkencave. Në fillim, dijetarët jo vetëm që shkruanin libra të pavarur mbi moralin, të përbërë kryesisht nga hadithet e Pejgamberit (a. s.), por gjithashtu ata mblodhën shumë transmetime rreth moralit, të cilët i radhitën nën titujt si "Kitabu hu-

sni'l-hulk", "Kitabu'l-edeb", "Kitabu'l-birr", në koleksionet e mëdha të haditheve që ata përpiluan.


Nën ndikimin e përkthimeve të literaturës mbi moralin, të bëra nga kultura filozofike greke në arabisht, edhe mendimtarët myslimanë shkruan libra mbi moralin, duke e trajtuar atë në aspektin filozofik. Nga kjo literaturë përfutuan dijetarët e shekujve 11-12, si Mawerdi, Ibn Hazmi, Ragib el-Isfahani, Gazaliu etj., të cilët e prezantuan moralin teorik në formë

islame, duke i ruajtur disa elemente themelore filozofike dhe duke i harmonizuar ato me burime islame si: raporti moral-virtyt, "fezail-i Erbaa" (katër virtyte thelbësore), "mesi i artë", "pedagogjia morale" etj. Në këtë mënyrë, me veprat e dijetarëve si: Nasiruddin et-Tusi, Xhelaleddin ed-Dewani, Adududdin el-Ixhi, u formua një shkencë etike që e ruante karakterin tradicional të "moralit të virtytshëm". Kështu që, studiuesi osman i shekullit të 17-të Katip Çelebi në librin e tij të famshëm Keshfu'z-Zunun, "shkencën e moralit" e përkufizon si "njohuri e virtyteve njerëzore".

Megjithatë, në proceset që rodhen më tej, kjo linjë morale dinamike nuk mund të mbahej gjallë në baza intelektuale, pedagogjike dhe praktike. Sipas bindjes sonë, njëra nga arsyet kryesore për këtë çështje është se, përdërisa në fillim nuk kishte një ndarje të këtyre gjatë procesit të formimit të shkencës së fikhut, duke u bërë një dallim i rreptë ndërmjet farzit e virtytit apo vaxhibet e mendubit, farzet/vaxhibet u kufizuan në disa adhurime formale dhe si të tilla u ngrinë. Më në fund, çështja arriti deri në atë pikë, sa që pas librit të njohur "Ahlak-ë Alai" të studiuesit osman Kënalëzade Ali, shkruar në vitin 1564, në botën sunnite nuk u shkrua ndonjë libër i rëndësishëm mbi moralin që trajton temën në aspektin filozofiko-sistematik deri në kohët moderne, kur u bënë përkthime nga Perëndimi. Një arsye e rëndësishme për këtë stagnim janë efektet, ndikimet e kundërshtimit të pandërrerë të shumicës së ulemave ndaj filozofisë në fushën e arsimit dhe në shoqëritë myslimane. Kundërshtimi i ulemave ndaj filozofisë, duke e konsideruar filozofinë si një disiplinë që gjithnjë e ka lodhur trurin që nga kohët antike, edhe çështjet morale kanë përjetuar një përjashtim nga interesimi i thellë; mungesa e interesimit për moralin e prodhuar nga këto qëndrime ka vazhduar pothuajse deri në ditët e sotme.

Nga ana tjetër, çështja e Meqasid-it (qëllimet kryesore të synuara nga Ligjvënësi), edhe pse ishte harruar për një kohë të gjatë, nëpërmjet Xhuvėjniut (v. 1085) dhe nxënësit të tij Gazaliut përsëri u rikthye në agjendën e dijetarëve, mirëpo edhe në këtë aspekt çështjes së moralit nuk iu kushtua ndonjë rëndësi e veçantë dhe ndoshta për këtë arsye diskutimet në lidhje me Meqasidet asnjëherë në jetën shoqërore nuk prodhuan rezultate. Madje, edhe studiuesi andaluzian që ka jetuar 300 vjet pas Xhuvėjniut, Shatibiu, për të cilin thuhet se e ka përpiluar librin Meqasid në një metodologji të pavarur, vazhdoi indiferencën e tij ndaj diskutimit mbi çështjet e moralit. Shatibiu, duke ndjekur vijën tradicionale, qëllimet e përgjithshme të fesë sipas rëndësisë i ndan në tre grupe, si: Darurijjat (mbrojtja e fesë, e jetës, e mendjes, e gjenezës dhe e pronës), Haxhijjat (nevojat), Tahsinijjat (zbukuruesit), me ç'rast tahsinijjat i konsideron si plotësues të dy të tjerëve (tekmile). Sipas Shatibiut, virtytet morale (mekarimu'l-ahlak), për shembull - veshja e mirë apo parfumosja, përfshihen në të njëjtën kategori, pra janë nga tahsinijjatet (el-Muvafaqat, bot. A. Diraz, Bejrut,

ts., IV, 31).



të gjatë, nëpërmjet Xhuvėjniut (v. 1085) dhe nxënësit të tij Gazaliut përsëri u rikthye në agjendën e dijetarëve, mirëpo edhe në këtë aspekt çështjes së moralit nuk iu kushtua ndonjë rëndësi e veçantë dhe ndoshta për këtë arsye diskutimet në lidhje me Meqasidet asnjëherë në jetën shoqërore nuk prodhuan rezultate. Madje, edhe studiuesi andaluzian që ka jetuar 300 vjet pas Xhuvėjniut, Shatibiu, për të cilin thuhet se e ka përpiluar librin Meqasid në një metodologji të pavarur, vazhdoi indiferencën e tij ndaj diskutimit mbi çështjet e moralit. Shatibiu, duke ndjekur vijën tradicionale, qëllimet e përgjithshme të fesë sipas rëndësisë i ndan në tre grupe, si: Darurijjat (mbrojtja e fesë, e jetës, e mendjes, e gjenezës dhe e pronës), Haxhijjat (nevojat), Tahsinijjat (zbukuruesit), me ç'rast tahsinijjat i konsideron si plotësues të dy të tjerëve (tekmile). Sipas Shatibiut, virtytet morale (mekarimu'l-ahlak), për shembull - veshja e mirë apo parfumosja, përfshihen në të njëjtën kategori, pra janë nga tahsinijjatet (el-Muvafaqat, bot. A. Diraz, Bejrut,

ts., IV, 31).

Përfundimi që del nga kjo, që u tha deri këtu, është si vijon: Meqenëse "Makarim-i Ahlak" (virtytet morale) nuk konsiderohen nga kategoria e darurijjateve dhe haxhijjateve, ato nuk janë as të domosdoshme dhe as të nevojshme. Ato janë nga "tahsinijjatet"; kështu që nëse zbatohen, do të ishte "bukur". Arsyeja pse është e bukur, nuk është për shkak të vetvetes, por sepse plotëson pesë gjërat thelbësore që përbëjnë domosdoshmëritë. Por, edhe nëse nuk zbatohen, nuk e dëmtojnë fenë dhe besimin. Në qoftë se do të përmendim shembullin që thekson Shatibiu (po aty, IV, 32), nëse burri sillet mirë me gruan e tij, ai bën një veprim të "bukur". Por sipas sistematikës së "meqasidëve" që u theksua më lart, që burri të sillet mirë me gruan e tij nuk është as "e domosdoshme", as "e nevojshme"; është thjesht një veprim "i bukur". Ky është mendimi i pothuajse të gjithë ulemave të mëhershëm. Sidomos tek ulematë sunnitë

ky mendim është absolutisht dominues. Edukimi në medrese ka qenë po në këtë drejtim.

Sipas asaj që u tha më lart, një mentalitet i ulemave që nuk e konsideronte moralin as "të domosdoshëm" (daruri) dhe as "të nevojshëm" (Ihtijaxhi), por vetëm si zbukurues (tahsini), në asnjë mënyrë nuk kishte mundësi të prodhonte shoqëri të virtytshme. Natyrisht që shoqëritë e kaluara myslimane kishin tipare të mira. Por, këto veçori u formuan nga bereqeti i mesazheve morale që buronin nga Kurani dhe hadithet; por, ky moral, meqë nuk ishte i strukturuar teorikisht dhe i mbështetur nga sistemet edukativorsimore të rregullta, gjithmonë prirej të avullohej; në fakt, ashtu edhe ka ndodhur.

Me pak fjalë, mendoj se prej këtu buron botëkuptimi i sotëm i "fetarësisë imorale", i stilit se duke bërë një Umre, apo një Haxh ekstra dhe ultra-luksoz, mund "t'i falësh të gjitha mëkatet" (apo rrezillëqet).

(Përktheu nga turqishtja: dr. Selver Xhemaili)

RËNDËSIA E BAMIRËSISË

Bamirësia është urdhëruar në të gjithë gjërat - nga gjërat më të imëta, deri tek ato më të mëdha. A thua njeriu duhet të jetë i përkryer mirë edhe kur pret kurban? Po, sepse ai që është i përkryer në këtë punë, do të jetë i përkryer edhe në sferat tjera të jetës.

Nga Amer Halid

Bamirësi do të thotë plotësi. Mbase befasohesh se bamirësia është veti morale. Po, plotësia është thelbi i Islamit, plotësia në realizimin e veprave, në realizimin e marrëdhënieve, në të folur - të gjitha këto janë esenca e Islamit. I dërguari i Allahut (a. s.) ka thënë: *“Allahu dëshiron që kur të punoni diçka, që atë ta plotësoni në mënyrën më të përkryer dhe më profesionale.”* (Taberani)

Dëshiron që Allahu të të dojë? Në qoftë se do, atëherë plotësoji sjelljet tua dhe kryej ato në mënyrën më të bukur. Atëherë Allahu do të të dojë.

Ja disa ajete që flasin për bamirësinë: **“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, kurse ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”** (Nahl: 90)

Shiko me kujdes shprehjet në ajet, e në veçanti shprehjen **“urdhëron”**.

Ajetet tjera: **“Të cilët japin kur janë lirshëm dhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit.”** (Al Imran: 134) **“S’ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë atyre të mirëve.”** (A’raf: 56) **“S’ka dyshim se Allahu është me ata që janë të devotshëm (që ruhen prej të këqijave) dhe me ata që janë bamirës.”** (Nahl: 128)

Mendo për këto ajete edhe një herë. Me cilin është dhe cilin mëshiron Allahu? Pa dyshim, me bamirësit!

Bamirësia është urdhëruar në të gjithë gjërat - nga gjërat më të imëta, deri tek ato më të mëdha. Pse e themi këtë? A thua njeriu duhet të jetë i përkryer mirë edhe kur pret kurban? Po, sepse ai që është i përkryer në këtë punë, do të jetë i përkryer edhe në sferat tjera të jetës.

Subhanallah!

Ky është një shembull i bukur i ba-



mirësisë. Pasi i dërguari i Zotit na ka kërkuar bamirësinë edhe në prerjen e kurbanit, atëherë sa e fuqishme mund të jetë kërkesa e tij për bamirësi në sferat tjera të jetës?

Kjo veti përfshin gjithë fenë!

Lidhur me këtë Ibn Kajimi ka thënë: *“Bamirësia është thelbi dhe esenca e fesë; e sikur t’i grumbullonim të gjitha vlerat e normave islame, ato do të ishin të përfshira në këtë veti.”*

I Dërguari (a. s.) ka thënë: *“Mos u bëni hipokritë kur flisni: Në qoftë se të tjerët janë të mirë ndaj nesh, edhe ne do të jemi të mirë ndaj tyre. Mirëpo, ju silluni mirë me të tjerët, qoftë nëse janë të mirë ndaj jush, qoftë nëse janë të këqij ndaj jush.”* (Tirmidhiu)

Ky hadith është përgjigje për gjithë ata që thonë: Si kërkoni nga unë që të mos i hedh letrat në rrugë, kur këtë e bëjnë të gjithë? Gjithmonë duhet të jesh i vetëdijshëm që je mysliman. Edhe sikur askush në këtë botë mos të jetë i mirë, ti bëhu i mirë. Mos u ligështoj duke i thënë vetes: “Po të gjithë janë të këqij... A vetëm unë...?!” Në qoftë se nuk e ke kuptuar, atëherë ç’dobi ke nga namazi, nga agjërimi, nga leximi i Kuranit!?

Unë nuk dëshiroj që kjo të keqkuptohet dhe të fillohet zbatimi në imtësitë më të vogla i të gjithave atyre që i thamë deri tash, nga shkaku që e gjithë kjo të mos ftohet shpejt dhe të bëhet e mundimshme. Pra, nuk ka as teprim, as shkurtim. Patjetër duhet ta gjejmë dhe ta marrim mesataren, e cila, në të gjitha çështjet, është e këshillueshme.

Ruaju, sepse je pasqyrë e Islamit! Mos turpëro as Islamin dhe as myslimanët me sjellje të këqija. Stolisni me bamirësi dhe kujtoje se Allahu (xh. sh.) e ka normuar bamirësinë në të gjitha gjërat dhe në ibadete, ndaj prindërve, ndaj bashkëshortëve, ndaj fëmijëve, në përsëndetje, në debate, në të folur, në zgjedhjen e banesës...

Dhe, dije se **“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, përderisa ata nuk e ndryshojnë veten e tyre”**. (Rrad: 11)

(Marrë nga libri “Morali i besimtarit”, botuar nga “Sira”, Prishtinë, 2016, faqe 55-56/76-77, përkthyer nga Ismail Rexhepi. Për botim e solli Musa Biba, referent në Myftininë e Strugës)

“BOTIMET ISLAME NË GJUHËN SHQIPE DERI MË 2020”

Doli nga shtypi vepra “Botimet islame në gjuhën shqipe deri më 2020” e autorit Shaban Ramani, botim i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Libri ka mbi nëntëqind faqe dhe është fryt i një pune ambicioze disavjeçare të autorit. Në veprën bibliografike ai ka regjistruar të gjitha botimet me tematikë islame në gjuhën shqipe që nga viti 1936 deri në vitin 2020, nga botues të ndryshëm të vendit dhe të rajonit, respektivisht të botuara në trevat shqiptare e më gjerë.

Vepra është tepër e rëndësishme për studuesit e shkencave islame, për të cilët do të jetë referencë dhe burim i literaturës islame, sepse autori, përpos shënimeve bibliografike, për secilin botim, disa fjalë shkruan edhe për tematikën e tyre.

Me rëndësi është edhe ajo se autori nuk kufizohet vetëm në botimet islame në Maqedoninë e Veriut, por i përbledh edhe ato të botuara në Republikën e Kosovës, në Republikën e Shqipërisë e gjetiu. Nisur nga kjo, vepra, besojmë, do të jetë mjaft e kërkuar nga hulumtuesit shqiptarë të trojeve shqiptare e më gjerë. S’ka dyshim se vepra do t’u shërbejë edhe nëpunësve fetarë, të cilët merren me interpretimin e mësimave islame, nxënësvetë të medreseve dhe studentëve të shkencave islame, për të gjetur burimet e mësimave islame në të gjitha fushat.



Duke marrë parasysh këtë që u potencua më lart, si dhe rëndësinë e madhe historike që ka kjo veperë në fushën e bibliografisë së literaturës islame, të botuar në fund të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI, Rijaseti i BFI-së e merr përsipër botimin e saj, botim i cili në një farë mënyre është ribotim i të gjithë edicionit islam të regjistruar në të. Them i kështu, sepse jemi të bindur se kjo veperë do të ruajë dhe do të zhvillojë fjalën e shkruar islame në gjuhën shqipe jo vetëm te ne, por edhe më gjerë, në rajon e gjetiu, thuhet në njoftimin e BFI. (17.06.2022)

NJË LAJM I MIRË

Para disa ditësh arriti konfirmimi i miratimit të kërkesë - projektit të katërt të BFI të RMV, botimi i Fjalorit ARABISHT – SHQIP, i autorit prof. Mahir Hasani. Është fjalor voluminoz me mbi 170.000 fjalë dhe do botohet me mbi 1700 faqe. Botues do të jetë Instituti i Trashëgimisë i Sharikas së EBA (Ma’hed Esh- Sharakah lit - turath), nën udhëheqjen e Kryetarit të Institutit dr. Abdulaziz Musel-lem.

Duhet theksuar se prof. Mahir Hasani e ka merituar një lajm të këtille, sepse tërë jetën ia kushtoi Islamit dhe SHMI “Medreseja Isa Beu” në Shkup, si ligjëruar i gjuhës arabe me mbi 30 vjet, si dhe autor i shumë veprave të tjera në lëmin e Islamit.

Vizitat e BFI dhe bashkëpunimi me Emiratet e Bashkuara ngadalë po i jep rezultatat e veta.

Shprehim mirënjohje Kryetarit të Institutit të Trashëgimisë në Sharika për këtë vendim, si dhe angazhimin e madh

të Ambasadorit të RMV në Abu Dhabi të EBA, z. Abdulkadër Mehmedit. Allahu t’i shpërblejë me shpërblimet e Tij të pakufishme.

Botimi i kësaj vepre voluminoze është nder për BFI të RMV, për SHMI “Medreseja Isa Beu”, institucionet e ndryshme shkencore, si dhe afirmimin e myslimanëve të vendit, të letërsisë shqiptare dhe të kombit tonë në përgjithësi.

Edhe një herë theksojmë se deri më tani janë miratuar 4 projekte: 1. Ndarja e bursave për studentë; 2. Projekti i dhënies së ndihmave për jetimë; 3. Nënshkrimi i Memorandumit për investime në sfera të ndryshme infrastrukturale dhe më gjerë; dhe 4. Projekti i botimit të Fjalorit arabisht-shqip nga autori prof. Mahir Hasani.

Mbesim me shpresë se lëvizjet e BFI jashtë vendit do japin rezultate edhe më të mëdha, siç janë duke dhënë edhe në vendin tonë, thuhet në njoftimin e BFI. (23.06.2022)



HAXHI 2022: Pjesë e ekspeditës së madhe janë edhe rreth një mijë haxhilerët nga Republika e Maqedonisë së Veriut, të cilët në organizim të Rijasetit të BFI-së më 27 qershor, 2022, e më tej, morën rrugën për t`iu përgjigjur thirrjes së Allahut (xh. sh.), respektivisht për të qenë mysafirë të Tij. (q. o.)

